

1 E mërkurë, 26 mars 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.08

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
6 paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
8 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
10 Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërejmë për
12 procesverbal të katër të akuzuarit janë të pranishëm në sallën
13 e gjyqit sot.

14 Përpara se të vijë dëshmitari, janë disa aspekte
15 paraprake që duhet t'i trajtojmë.

16 Së pari, më 24 mars 2025 Mbrojtja bëri kërkesë ku
17 kërkonte pranimin e deklaratës së një dëshmitari, përkatësisht
18 Dëshmitari 02172. Dokumenti ka numër F03054.

19 Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja më herët kishte bërë me
20 dije se nuk do ta kundërshtonte pranimin e deklaratës nëse
21 Mbrojtja dëshironte që të pranohej si provë gjyqësore. Dhe
22 tani po i referohem dokumentit F02782, paragrafi 53(i) dhe
23 dokumenti F02888, paragrafi 4.

24 Rrjedhimisht, me qëllim përshpejtimin e zgjidhjes së
25 këtij mocioni, Trupi Gjykses dëshiron të dijë tani prej palëve

1 nëse ka ndonjë përgjigje apo kundërpërgjigje nëse është e
2 nevojshme, kuptohet, pra keni përgjigje apo kundërpërgjigje
3 për dokumentin F03054, dhe mund ta bëni ose sot ose nesër.

4 Z. Prokuror, keni kundërshtime për pranimin e dokumentit?

5 Z. PACE: [Përkthim] Do më duhet ta verifikoj me kolegët
6 dhe do ju informoj unë sa më shpejt.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
8 bëjeni këtë para se të fillojmë pushimin e radhës. Ose pas
9 pushimit, më saktë.

10 Trupi Gjykses po ashtu vëren që dëshmitari aktual 04403 i
11 ka komunikuar Zyrës Administrative që nuk ka mundësi të japë
12 dëshmi javën tjetër. Kështu që duhet të përfundojmë patjetër
13 sot me të ose edhe nesër paradite, edhe të fillojmë me
14 dëshmitarin tjetër nesër.

15 Gjithashtu, do i japim ekipit të Mbrojtjes së Thaçit siç
16 e kërkuat dhe përmes emailit, për pranimin e dokumenteve
17 lidhur me Dëshmitarin 03724.

18 Duhet ta bëjmë në seancë private këtë, z. Misetic?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Por më jepni një çast sa të
20 nxjerr numrat përkatës.

21 Jam gati.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vazhdoni.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne duam që të pranohen dy
24 dokumente që ishin në listën tonë të materialeve për pyetjet
25 që janë bërë më 14 shtator 2023, përkatësisht janë të

1 reflektuara në transkript në faqen 8181. Kërkojmë pranimin e
2 materialit DHT02008 deri në DHT02010 dhe DHT02011 deri në
3 DHT02011. Dhe kemi marrë leje nga ofruesi i materialit për
4 dorëzimin e këtij materiali.

5 Z. PACE: [Përkthim] E kundërshtojmë pranimin e këtij
6 materiali. Fakti që ka qenë në listën e tyre të materialeve
7 nuk ndryshon asgjë sepse këto materiale nuk i janë paraqitur
8 dëshmitarit dhe mënyra se si kërkon Mbrojtja të pranohet kjo
9 s'është e përshtatshme. Ata duhet ta kërkojnë këtë të pranohen
10 përmes dëshmitarit. Ose, kur të kenë dëshmitarët e vet të
11 sjellin dëshmitarin dhe të kërkojnë pranimin e materialit.

12 Edhe një herë, pra, e theksoj. Materiali nuk iu tregua
13 dëshmitarit përkatës, dëshmitari s'ka komentuar për
14 përmbajtjen, edhe po ashtu as ne nuk na lejuat ta përdornim
15 këtë material me dëshmitarin. Kjo del jashtë fushëveprimit të
16 pranimin të provave, edhe do bëhej një precedent i rrezikshëm
17 nëse lejohet një praktikë e tillë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt besoj se ne kemi bërë disa
19 pyetje bazuar në dokumente, ne vërtet s'ia paraqitëm
20 dokumentin dëshmitarit, ama disa pyetje ne i kishim bazuar në
21 këtë dokument. Unë s'e di çfarë precedenti të rrezikshëm po
22 krijojmë ne. Është material relevant, dhe ka pasur lidhje me
23 dëshminë e dëshmitarit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 [Përkthim] Po japim numër provizor atëherë për momentin,

1 do ta diskutojmë edhe do të marrim vendim brenda ditës së
2 sotme lidhur me këtë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë, materiali
5 DHT02008 deri në DHT02010 do të marrë numrin provizor dhe
6 numri është 1D00258. Dhe klasifikimi është konfidencial,
7 aktualisht.

8 Dokumenti tjetër DHT02011 deri në DHT02011, do të
9 shënohet po ashtu me numër provizor dhe numri provizor është
10 1D00259. Po ashtu klasifikimi konfidencial.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam diçka tjetër për të trajtuar.
12 Mund ta trajtojmë dhe pas pushimit. Sa i takon argumentit për
13 cenimin që i është shkaktuar atyre. Këto janë dokumente
14 pothuajse identike me dokumentet që Prokuroria i ka në
15 posedimin e vet. Format i është pak a shumë i ndryshëm. Por
16 përmbajtja është thuajse identike.

17 Unë mund t'jua jap edhe numrat përkatës, ama asnjë dëm
18 nuk i shkaktohet Prokurorisë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Asgjë nuk ndryshon. Dokumenti nuk u
20 përdor me dëshmitarin dhe ky nuk është argument shtesë që të
21 justifikojë ai pranimin e këtij dokumenti në prova gjyqësore.
22 Nuk ka ndryshim nga Prokuroria sa i takon qëndrimin që kemi
23 ne.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, iu përgjigja argumentit të
25 Prokurorit kur tha që na shkaktohet dëm apo cenohemi ne.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

2 Z. PACE: [Përkthim] Kam dhe diçka tjetër për të thënë. Po
3 më thonë se më herët kemi thënë që nuk do të kundërshtonim
4 pranimin e deklaratës së Dëshmitarit 2172 nëse Mbrojtja
5 dëshironte që të pranohej kjo deklaratë. E ritheksoj që nuk
6 kemi kundërshtime për pranimin e kësaj deklarate.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
8 deklarata e Dëshmitarit 02172, që ka numër të protokolluar
9 F03054, pranohet.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Do t'i japim
11 numrin përkatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Kam dhe diçka tjetër. Për shkak të problemit që kemi me
14 këta dy Dëshmitarët e fundit, do bëjmë vetëm një orë pushim
15 sot dreke. Fillojmë në orën 14.00 në mënyrë që të shfrytëzojmë
16 sa më shumë kohën që kemi. Nuk po ju detyroj të kufizoni
17 kundërpyetjet apo pyetjet plotësuese, por është shumë e
18 rëndësishme. Përpiqemi që ta shfrytëzojmë kohën sa më shumë që
19 kemi mundësi dhe besojmë se të gjithë do ta bëni këtë gjë.

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë kisha kërkuar tre orë,
21 por ka të ngjarë që do më përdoret shumë më pak, mbase gjysma
22 e kohës që kisha kërkuar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësoj
24 këtë gjë.

25 Në rregull tani, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

1 Ju kërkoj ndjesë për vonesën sot paradite. Me sa kuptuam
2 kishte një problem me transportin, prandaj na u desh të
3 fillonim pak më vonë.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
6 z. Maloku --

7 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] -- e morëm
9 njoftimin që nuk jeni i disponueshëm javën tjetër. E kuptojmë
10 që s'mund të vini javën tjetër, dhe e kuptojmë dhe arsyen pse.
11 Ne do përpiqemi që të përfundojmë sot. Po nuk përfunduar sot,
12 mbase do bëjmë dhe pak nesër, sepse kemi dëshmitar tjetër
13 nesër në fakt të planifikuar.

14 DËSHMITARI: S'ka problem.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por të gjithë
16 do përpiqen që të përfundojnë me dëshminë tuaj sot.

17 DËSHMITARI: Z. Gjykatës, unë kam ardh me qenë në
18 dispozicion të drejtësisë. As nuk kam ardh akuzues, as
19 mbrojtës. Kam ardh me ju përgjigj pyetjeve të gjithë [Folës që
20 flasin njëkohësisht] këtu.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 z. Maloku. Faleminderit dhe një herë. Do fillojmë tani.

23 Ju lutem, përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse
24 nuk e kuptoni një pyetje, kërkonit që pyetja të përsëritet ose
25 thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta sqarojmë. Gjithashtu,

1 mos na thoni [Sipas përkthimit] bazën e njohurive, fakteve dhe
2 rrethanave për të cilat do t'ju bëjmë pyetje.

3 Jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën sikurse vetë
4 e lexuat përmes betimit solemn.

5 Flisni pranë mikrofonit dhe bëni një pauzë të shkurtër
6 përpara se të përgjigjeni, dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

7 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na informoni dhe
8 do bëjmë organizimin përkatës.

9 Tani pyetjet do t'i bëjë z. Dixon, që është avokati i z.
10 Veseli.

11 DËSHMITARI: NAIM MALOKU [Vijon]

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

13 Z. DIXON: [Përkthim]

14 PY. Mirëmëngjesi. Mirëmëngjesi, z. Maloku. Quhem Rodney
15 Dixon. Do t'ju bëj disa pyetje në emër të klientit tim, z.
16 Kadri Veseli.

17 PË. Mirëmëngjes. Faleminderit, z. Avokat.

18 PY. Kam disa tema që dua të mbuloj me ju, dhe uroj që t'i kem
19 pyetjet të thjeshta dhe të marrim përgjigje të shkurtra, në
20 mënyrë që përfundojmë sa më shpejt.

21 PË. Do të përpiqem.

22 PY. Faleminderit. Do filloj me librin tuaj, z. Maloku, për të
23 cilin ju bënë disa pyetje.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Lutem që të vendoset në ekran prova
25 materiale me numër p2103. Në anglisht është faqja 49 e PDF-së,

1 ndërsa në shqip është faqja 54.

2 PY. Do të filloj me disa pyetje për një fragment të librit,
3 për kontekst, ndërkohë që presim librin. Pyetje më shumë për
4 të kuptuar kontekstin.

5 Z. DIXON: [Përkthim] 49 anglishtja, 54 shqipja, ju lutem.
6 Po, është kjo pjesa këtu, për shënimet biografike, domethënë
7 është pjesa ku fillon, "Z. Maloku, ju lutem për lexuesit tanë
8 disa shënime biografike." Ju lutem, të zmadhoni pjesën e
9 majtë. Të djathtë, më falni, të djathtë. Në shqip, të
10 djathtë.

11 PY. Ju thoni kështu, po e lexoj:

12 "Në vitin 1981 kam kryer akademinë ushtarake në Zagreb.
13 Ndërsa në 1985 jam burgosur nga shërbimi sekret i Armatës
14 Jugosllave. Në atë kohë, jam dënuar politikisht në Sarajevë,
15 në grupin e parë të oficerëve shqiptarë. Pastaj, nga viti 1988
16 deri në vitin 1991 jam marrë me themelimin e Këshillit për
17 Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut me seli në
18 Lubjanë. Po ashtu në ato vite, kam qenë ndër themeluesit dhe
19 më pas kryetari i shoqatës shqiptaro-slllovene "Migjeni" në
20 Lubjanë, që në atë kohë në opinionin njëhej më tepër me emrin
21 "Alternativa". Në vitin 1991 kam qenë i angazhuar në formimin
22 e një njësie ushtarake të përbërë nga shqiptarët në Kroaci.
23 Dihet ndërkaq se për shkak të kundërthënieve që në ato kohë
24 ndodhën në Kosovë, ne u detyruam të heqim dorë nga ai projekt.
25 Po e përsëris, fatkeqësisht, jemi detyruar të heqim dorë nga

1 ai projekt. Edhe sot mendoj se detyrimi që të lëmë atë projekt
2 ishte i gabuar. Që nga muaji prill i këtij viti", ky është
3 viti 1998, pra, "jetoj në Kosovë, jam në Kosovë. Këtu jetoj
4 dhe veproj duke qenë krah për krah me UÇK-në dhe popullin që
5 luftojnë për vetëmbrojtje".

6 Pra, z. Maloku, tani unë do t'ju bëj disa pyetje lidhur
7 me këtë fragment.

8 PË. Po.

9 PY. A është e vërtetë që keni qenë kryetari i kësaj shoqatës
10 "Alternativa" nga 1989 deri 1996, pak para fillimit të luftës,
11 1989-1996?

12 PË. Në atë periudhë kohore kam qenë tri herë kryetar i asaj
13 shoqate. I pari kryetar, dhe e kam lënë mandatin në 1997. Do
14 të thotë, për shkak se statuti i shoqatës Migjeni ishte i
15 tillë që kryetari duhet të ndërroreshin çdo vit, për të mos e
16 monopolizu postin e kryetarit të shoqatës. Pra, tri herë kam
17 qenë nga një vit.

18 PY. Faleminderit. A e është e vërtetë se kjo shoqatë ka qenë
19 një shoqatë e mbarënjohur dhe kishte profil shumë të lartë
20 qysh në fillimet e veta, sepse kërkonte vetëqeverisje në
21 Kosovë dhe pavarësinë e Kosovës?

22 PË. Po. Po.

23 PY. Pra, është e vërtetë që kryetari i kësaj shoqate, pra jo
24 vetëm që ishit ushtar karriere ju, por ishit një figurë e
25 spikatur publike, i mirënjohur në Kosovë dhe në rajon, për

1 shkak të punës, veprimtarisë tuaj me këtë shoqatë?

2 PË. Isha shumë i njohur. Jo vetëm në opinionin kosovar, por
3 edhe më gjerë, edhe në atë ndërkombëtar. Jo vetëm slloven, në
4 shtetin ku jetoja unë, por edhe më gjerë.

5 PY. Po. Kjo është një nga arsyt pse shumë gazetarë dhe
6 komentatorë gjatë luftës vinin t'ju takonin gjatë luftës për
7 të marrë pikëpamjen tuaj lidhur me atë që po ndodhte, sepse
8 ishit figurë publike e njohur, apo jo?

9 PË. Po. Isha oficer me emër ma të njohur që isha fut në
10 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës edhe isha fut me emrin tim
11 personal, dhe normalisht ishin të rrallë oficerët ushtarakë e
12 profesionistë në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në
13 Kosovë. Dhe gazetarët më kërkonin, t'jua them të drejtën, më
14 kërkonin nëpër territore ku isha, dhe kërkonin që të
15 zhvillojnë intervista me mu për pikëpamjet e mia në lidhje me
16 situatën, në lidhje me luftën, në lidhje me politikën në
17 Prishtinë, në lidhje me të gjitha çka për të cilat pyetjet,
18 person, për të cilët gazetari mendon që ka njohuri ma tepër se
19 sa të tjerët që ishin në atë kohë në Ushtrinë Çlirimtare të
20 Kosovës.

21 PY. Po, Faleminderit. Dhe gjithmonë jeni ndier i lirë, keni
22 folur hapur me gazetarët lidhur me pikëpamjet tuaja, apo jo?

23 PË. Gjithmonë kam qenë i lirë në mendimet e mia. Gjithmonë
24 ato i kam shpreh në bazë të njohurive të mia profesionale. Dhe
25 z. Avokat, më lejoni të them vetëm një fjali, e cila do të

1 thotë shumë për ju dhe për të gjithë.

2 Nëpër të gjitha strukturat e Ushtrisë Çlirimtare të
3 Kosovës që i kemi ngrit ne oficerët, ato struktura
4 organizative, për 14 muaj kanë kaluar 60.000 vullnetarë. Pra,
5 për 14 muaj, 60.000 mendime të ndryshme, por na ka lidhur vetëm
6 një, qëllimi për të luftuar për me çliruar Kosovën. Unë i kam
7 thënë ZPS-së edhe në Lubjanë, ju e keni atje në transkript.
8 Është vështirë me e kuptuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës,
9 është vështirë me e kuptuar një ushtri që ngritet prej një
10 populli të robnum, ushtri vullnetare dhe ushtri e rregullt.
11 Kjo është.

12 Pra, mendime të ndryshme ka pas, por një na ka lidhur,
13 qëllimi na ka lidhur. Bashkë, na ka bërë bashkë që e kemi respektuar
14 njëri-tjetrin. Ka qenë, dhe nuk e kemi lënë veten, ka qenë
15 qëllimi jonë për, lufta për çlirimin e Kosovës.

16 PY. Po, Faleminderit, z. Maloku. Atëherë do t'ju pyes për një
17 nga personat që ka thënë [Sipas përkthimit] bashkëluftëtari
18 juaj në Kroaci në 1991, bëhet fjalë për Mensur Kosumin.

19 Ju thotë dje që atij i kishit bërë një kërkesë për
20 demobilizim në qershor të 1999-s, dhe se e keni parë atë dhe
21 keni biseduar gjatë me të kur e dhatë, kur i dorëzuar këtë
22 kërkesë. A të kujtohet kjo pjesë e dëshmisë?

23 PË. Po. Unë nuk ia bëra atij kërkesën, por ia dhashë që ta
24 dërgon ai në Shtabin e Përgjithshëm. T'ia dërgon shefit të
25 shtabit, praktikisht shefi i shtabit duhej të bënte

1 demobilizimin tim me urdhër.

2 Dhe nëse e keni lexu kërkesën time, shkruan që në qoftë
3 se nuk më demobilizoni me urdhër, atëherë unë do të shfrytëzoj
4 të drejtën time që pasiqë jam fut vullnetarisht në radhët e
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, vullnetarisht të
6 demobilizohem. Pra, kjo do të thotë që ai nuk ka pas fuqi as
7 me rregullore, as me ligje të atëhershme brenda, me
8 rregulloret, brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të më
9 ndalon mu, nëse është dëshira ime për demobilizim. Është e
10 cekur fjalía aty.

11 PY. Po. Po, e kuptojmë që ishte pjesë asokohe e Shtabit të
12 Përgjithshëm, z. Kosumi, dhe tha se, ai më tha se kishte
13 riorganizim të Shtabit të Përgjithshëm që po bëhej atëherë dhe
14 është në faqen 68 të transkriptit të përkohshëm dje.

15 Dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë, sepse mbase dhe
16 nuk e dini, mendoj mos po kemi ndonjë deklaratë nga z. Kosumi,
17 pjesë të së cilës i janë lexuar z. Zyrapit kur ka dëshmuar
18 këtu, dhe është në faqen 17826 e më tutje. S'ka rëndësi shifra
19 për ju, por kjo është për pjesëmarrësit këtu në sallë që ta
20 dinë.

21 Por pyetja që kam unë për ju është kjo. Ai ka thënë në
22 deklaratën e tij se ishte në fillim zëvendëskomandant i zonës
23 në Shalë, në zonën e Shalës dhe në shkurt të vitit 1999 në
24 thelb mori postin që kishit pasur ju, një nga postet që kishit
25 pasur ju, pra përgjegjës për drejtorinë operative të UÇK-së.

1 Dhe pastaj tha këtë. Do t'jua lexoj çfarë ka thënë dhe do t'ju
2 bëj një pyetje:

3 "Pas Rambujesë dhe formimit të Qeverisë së Përkohshme
4 roli im vijoi që të ishte si shef i drejtorisë operative, por
5 në javën e parë të prillit të vitit 1999 u bëra edhe shef i
6 zbulimit dhe kundërzbulimit."

7 Dhe pastaj tregoi një urdhër ku ishte nënshkruar ky
8 emërim. Që është një provë materiale këtu, në rastin e 2017
9 [Sipas përkthimit].

10 Por ajo që dua të them është kjo, për këtë e kishte
11 fjalën, për këtë ka biseduar me ju kur tha për riorganizimin e
12 Shtabit të Përgjithshëm që tani ai ishte drejtor i drejtorisë
13 operative dhe shef i zbulimit të ushtrisë, kështu ju kujtohet?
14 PË. Me tregu të drejtën, për pozitën e tij që e ka pas shef
15 zbulimi, nuk e kam dit. Mirëpo, që riorganizohet Shtabi i
16 Përgjithshëm këtu, për shkak se kishte përfundu lufta dhe tash
17 strukturat organizative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
18 tkurrehin, zvogëloheshin, ishte, do të thotë, Marrëveshja e
19 Kumanovës edhe obligimi që i kishte marrë Ushtria Çlirimtare e
20 Kosovës ndaj faktorit ndërkombëtar, dhe ato zbatoheshin. Pra,
21 ishte kjo normale që zvogëlohej, riorganizohej, edhe Shtabi i
22 Përgjithshëm. Do të thotë, tkurrej, zvogëlohej stafi atje.

23 Dhe unë vetëm e pyeta që a është, a jam përmend unë si
24 ndonjë emër atje që do të, që kanë pretendime me u kyçë, edhe
25 ai më ka thanë që, jo, nuk ka ndëgjju që bisedohet për ty. Kjo

1 ka qenë. Unë kam shkru kërkesën për demobilizim, edhe ka
2 përfundu, jam largu nga Kosova. Ju kam spjegu edhe ZPS-së, kam
3 shku në trajtim shëndetësor në Mainz afër Frankfurtit, në
4 Gjermani, dhe jam kthi më 8 gusht në Kosovë.

5 PY. Po, faleminderit. Të përqendrohemi tek pyetja që ju bëra.
6 A ju kujtohet se ajo që po thoshte ai ishte se disa njerëz po
7 lëviznin nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për t'u
8 transferuar tek disa pozita në Qeverinë e Përkohshme, apo në
9 pozita të tjera jashtë UÇK-së? Në përgjithësi ju kujtohet kjo
10 ishte ajo që ju tha?

11 PË. Ma shumë kemi bisedue për jetën tonë prej që jemi njoft
12 në Gospiç, e deri atë ditë. Do të thotë, unë e kam pas edhe
13 synimin tim që një ditë me e lënë uniformën, e kam cek këtë
14 edhe në libër. Edhe në intervista para asaj.

15 PY. Po. Por ju kujtohet që ai vërtet jua ka përmendur se po
16 bëhej riorganizimi i Shtabit të Përgjithshëm asokohe? Kjo ju
17 kujtohet, besoj, vetëm kaq ju kujtohet?

18 PË. Po, kjo është -- po.

19 PY. Tani dua t'ju bëj një pyetje për një çështje tjetër. Dje
20 Prokuroria ju bëri disa pyetje lidhur me z. Faton Mehmetaj.
21 Thatë këtë, dhe është faqja 18 e transkriptit të përkohshëm:
22 "Me sa më kujtohet, Faton Mehmetaj ishte epror i lartë
23 ose përgjegjës për të ashtuquajturën sektor i zbulim-
24 kundërzbulimit në zonën e Dukagjinit. Nga ajo që kam dëgjuar,
25 Fitnete Mimoza [Sipas përkthimit] e ndihmoi."

1 Dhe pastaj në vitin 1999 kur keni qenë në zonën e
2 Dukagjinit ju thatë që, e keni parë disa herë, jeni "parë në
3 rrugë, por nuk më kujtohet", keni thënë ju, "se të kem qenë i
4 pranishëm në ndonjë mbledhje a takim ku ka qenë edhe ai i
5 pranishëm. Nuk më kujtohet që unë të kem marrë pjesë në ndonjë
6 takim të tillë".

7 Tani t'ju bëj një pyetje. Në të gjitha takimet që keni
8 zhvilluar në atë zonë në vitin 1999, pra, kur shkonit nëpër
9 fshatra në të gjitha njësitet, në të gjitha inspektimet që ju
10 thatë se i keni bërë, pra keni shkuar në front, e në të gjitha
11 këtu, marrëdhënie që keni pasur në nivel të komandave të
12 zonave, po thoni që asnjëherë nuk e keni hasur z. Mehmetaj
13 nëpër takimet, pra në asnjë takim që ju keni marrë pjesë?
14 PË. Jo, në ato njësi ku unë kam qenë, në ato takime dhe në
15 ato inspektimet që unë i kam bo, në njësitet e vogla të
16 secilës brigadë brenda Zonës Operative të Dukagjinit, ai, nuk
17 e kam pa askund atë që të ketë marrë pjesë. Ai ka pas punë
18 tjetër. Unë e kam pas këtë, punën time e kam kry, do të thotë
19 inspektimin, këshillimin e ushtarëve, nëse ka nevojë
20 trajnimit, mësimin, tregimin se si duhen të përdoren armët
21 nëse ka pas persona, se në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në
22 vazhdimësi kanë ardh vullnetarë, prej fillimi e në fund, disa
23 vijshin, disa dilshin. Pra, kjo ka qenë puna ime. Puna ime nuk
24 është përputh askund me punën dhe përgjegjësitë që i ka pas
25 Faton Mehmeti. Nuk është përputh askund, nuk ka pas, nuk ka

1 pas pikëkryqëzim askund.

2 PY. Po, e kuptoj që ai nuk ka qenë në asnjë prej takimeve ku
3 ju keni marrë pjesë. Por ajo që desha t'ju pyes më tutje, z.
4 Maloku, është se z. Mehmetaj, në fakt është intervistuar nga
5 Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe unë do them dhe numrin e
6 referencës, por kjo s'është për ju, është për të tjerët këtu.
7 Është numri 056292, Pjesa 3, faqja 24, dhe Pjesa 5, faqja 5,
8 ku ZPS-së i ka thënë. Dhe kjo lidhet --

9 Pra ai tha se ka qenë në zbulimin, sektorin e zbulimit në
10 Dukagjin në qershor të 1998-s, megjithatë, këtë pozitë e ka
11 mbajtur vetëm një muaj e gjysmë pastaj është zëvendësuar nga z.
12 Hysen Gashi, i cili këtë rol e ka bërë pastaj më mbrapa
13 afërsisht për një muaj e gjysmë dhe askush nuk e ka
14 zëvendësuar më z. Gashi në këtë pozitë.

15 Pastaj ai ka thënë, dhe do t'ju lexoj për të parë nëse
16 kjo përputhet me atë që ju mbani mend, është me të njëjtën
17 numër reference në pjesën 5, faqja 15 e tutje. Ai ka thënë
18 kështu që:

19 "Unë nuk kam qenë aktiv fare midis shtatorit dhe
20 janarit", pra shtator 1998, janar 1999. Pra, "Nuk kam qenë
21 fare aktiv.

22 "Kam qëndruar në ilegalitet, pra, i fshehur për dy muaj
23 në shtëpinë time dhe një muaj në shtëpinë e Fitnetes. Pastaj
24 kam shku në Turjakë, pastaj kam qëndruar aty rreth dy muaj,
25 pastaj kam shkuar në shtëpinë e vajzës, kam qëndruar aty një

1 muaj gjatë qëndrimit tim në Jabllanicë. Për një muaj kam
2 vizituar Shtabin, jo dhe aq shpesh sepse nuk kam qenë pjesë,
3 nuk isha pjesë për një kohë të gjatë. Nuk jam përfshirë vetë
4 për shkak se nuk kisha qenë në kontakt.”

5 Por, pyetja që kam unë për ju është kjo, se dua të
6 verifikoj me ju. Duke qenë se ju s’keni qenë nëpër mbledhje me
7 të, pra a është e vërtetë që ngaqë ai nuk po kryente ndonjë
8 funksion të UÇK-së në 1999, kjo është arseja pse ju nuk keni
9 qenë, pra, nuk e keni hasur nëpër takime gjatë kësaj periudhe
10 aty në Jabllanicë?

11 PË. Unë në zonën operative të Dukagjinit kam shku në fund të
12 janarit 1999. Pra, dhe si duket unë e paskam pa atë nëpër që
13 sillet rreth shtabit, dhe kam mendu që ka, e ka qatë funksion.
14 S’jam marrë me të se s’ka, as nuk kemi pas kurrë një
15 pikëtakimi, në asnjë veprimtari luftarake të cilën unë e
16 kryeja në Kosovë në atë periudhë. Nuk kam pas pikëtakime të
17 aktiviteteve të mia me të tijat.

18 PY. Pra, do të ishte e saktë nëse do të thoshim që ju thjesht
19 nuk e dinit se çfarë funksioni kishte? Edhe nëse kishte
20 funksion, ju nuk e dini çfarë funksioni mund të kishte?

21 PË. Po, po. Saktë.

22 PY. Dua të verifikoj, t’i kthehem tani vitit 1998, kur keni
23 qenë në Junik. Nuk e keni hasur, nuk e keni takuar asnjëherë
24 në atë kohë, apo jo?

25 PË. Jo.

1 PY. Tani dua që t'ju pyes, t'ju bëj disa pyetje lidhur me atë
2 dokument që ju treguan dje, i cili ka sektorin e zbulimit në
3 fund, që është i panënshkruar.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Me numër P2102. Do ta nxjerrim në
5 ekran në mënyrë që ta shohim të dy së bashku.

6 Po, ky është.

7 PY. Ju kujtohet ky dokument nga dje, z. Maloku? Pra, është e
8 vërtetë që ju thatë që nuk e kishit parë asnjëherë përpara se
9 t'jua tregonte ZPS-ja, por është po kështu e vërtetë se ju nuk
10 e dini fare se kush ka qenë autor i këtij dokumenti?

11 PË. E saktë.

12 PY. Dhe nuk e dini fare se çfarë ka ndodhur me këtë dokument,
13 pra kujt mund t'i jetë dërguar, apo jo?

14 PË. Unë për herë të parë nga ky dokument e kam parë që dikush
15 ka, si me e thanë tash, ka raportu apo ka dhanë vlerësime për
16 angazhimet e mia në terren, dikujt tjetër. Nuk e di këtë, z.
17 Avokat. Nuk kam njohuri, për herë të parë e kam pa këtë
18 dokument këtu.

19 PY. Po. Dhe desha t'ju bëj një pyetje lidhur me këtë, dikush
20 pra, ndokush pas kësaj periudhe, mbas 16 marsit, a ju ka thënë
21 diçka lidhur me një raport për ju, pra, ka ngritur ndonjë
22 problem para jush se ju keni sjellë një farë Major Dibra këtu
23 dhe se ai nuk duhet që të mobilizohet në detyrë aktive në
24 Luginën e Baranit, jua ka thënë dikush këtë?

25 PË. Z. Avokat jo, se unë s'e kam sjell Major Dibrën. Unë e

1 kam shpjegu se si jam taku me të, me Gëzim Ozdrenin. Dhe unë
2 kam pas nderin me qenë me të tanë kohën, kemi kry detyrat dhe
3 punë të cilat ne i kemi konsideru që janë të dobishme për
4 strukturën e njësive të UÇK-së për ngritjen e efikasitetit
5 të tyre në luftë.

6 Se, z. Avokat, unë s'kam shku me vjelë mollë në Kosovë.
7 Unë kam shku me luftu, kam shku me ngrit struktura, kam shku
8 me ushtru njerëz, kam shku me mësu njerëz për t'u përball me
9 luftën, për me pas ma pak viktima. Kjo ka qenë puna ime. Se
10 kush ka bo raporte për mu, nuk më hyn fare në punë as sot.

11 PY. Pra, për të sqaruar, askush në nivel të zonës, z.
12 Haradinaj, apo dikush tjetër, askush tjetër nga zona, nuk të
13 ka kontakti për të të thënë që, "Shiko, kemi një raport në të
14 cilin ngrihet një problem lidhur me ju", pra nuk ka ndodh një
15 përballje e tillë kurrë?

16 PË. Deri sot, kurrë.

17 PY. Marrëdhëniet tuaja në nivel zone me z. Haradinaj ishin
18 gjithmonë të mira dhe pozitive? Nuk jeni ndier kurrë se kishte
19 ndonjë dyshim lidhur me ju apo që t'ju kenë mënjeluar në
20 njëfarë mënyre?

21 PË. Z. Haradinaj vetë më ka kërkuar në Shtabin e Përgjithshëm
22 në janar, që unë të kthehem për t'i ndihmu në Zonën Operative
23 të Dukagjinit. Edhe mund t'ju them se të gjithë gazetarët që
24 vijshin në zonë edhe kërkonin kontakte ose intervista, ai i
25 dërgonte te unë. Edhe vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar,

1 gjersa ishin atje, se kur fillun bombardimet e NATO-s, ata u
2 tërhoqën, pra edhe ata i orientonte për çështje për të cilat
3 kishin të bënin me mu. I dërgonte te, i orientonte që unë t'u
4 jap përgjigje.

5 E kam ndi veten shumë të sigurt, dhe e kam ndi veten
6 shumë komod edhe të sigurt me z. Haradinaj.

7 PY. Pra, nuk ju ka konfrontuar askush lidhur me këto
8 pretendime për një qëndrim pro-qeverisë edhe për lëvdatat për
9 Rugovën, nuk doli kurrë si problem, nuk jua ka ngritur kurrë
10 si problem dikush, kështu apo jo?

11 PË. Z. Avokat, Rugova nuk ka qenë vetëm lider politik. Ai ka
12 qenë lideri shpirtëror i shqiptarëve. Edhe unë atë e kam çmuar
13 ashtu se në vitin, unë kam bashkëpunu me Rugovën ose Rugova me
14 mu, para se të formohej Lidhja Demokratike e Kosovës. Gazetën
15 që shoqata ime e ka nxjerrë në Lubjanë, quhej "Alternativa".
16 Rugova ka qenë anëtar i këshillit botues të asaj gazete. Në
17 1989, ju mundeni me e marrë ato gazeta, ato numra, dhe shifni
18 që Rugova ka qenë anëtar i këshillit botues të asaj gazete.
19 Pra, unë Rugovën e kam njoft para se të formohej Lidhja
20 Demokratike e Kosovës. Unë e kam pas, kam pas lidhje edhe
21 shpirtërore me të. Ai ka qenë lideri shpirtëror i shqiptarëve,
22 a më kupton?

23 PY. Po, po. E kuptoj. Unë desha vetëm të marr si përgjigje që
24 ka qenë e vërtetë që askush nuk ka bërë problem në nivel të
25 zonës së Dukagjinit për këto lloj problemesh, për këto lloj

1 çështjesh, kështu është, po a jo?

2 PË. Ashtu është, se unë përndryshe --

3 PY. Mirë, pra. Kalojmë tani tek temë të fundit, ju kanë
4 treguar një dokument dje me numër P2097.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk ka nevojë ta nxjerrim në ekran.

6 PY. Është procesverbali i një mbledhje ku ju keni marrë pjesë
7 më datë 30 janar i vitit 1999. Ju kujtohet që ishte aty një
8 listë e komandantëve të togave të ndryshme. Dhe një prej
9 personave që kishte marrë pjesë ishte Lulzim Morina. Ju
10 kujtohet që dhatë dëshmi dje për këtë?

11 PË. Po.

12 PY. Pra, është e vërtetë se z. Lulzim Morina u bë komandant i
13 Brigadës 135 në zonën e Dukagjinit? Po apo jo?

14 PË. Kjo për që është bë komandant i Brigadës 135 nuk më
15 kujtohet. Nëse është bë komandant i asaj brigade, pasi që unë
16 kam lëshu Zonën Operative të Dukagjinit me 8 maj. Përndryshe
17 Brigadë 135 ka qenë në, ne i thomë Lugu i Drinit, edhe e ka
18 pas selinë në Terstenik. Pra, gjatë kohës kur unë kam kalu
19 nëpër Terstenik, me shku në Brigadën 133, nuk ka qenë Lulzim
20 Morina as në pjesë e atij asaj strukture, që ne, që mua më
21 pritën në Terstenik dhe më përcollën pastaj deri në Studenicë,
22 ku ishte shtabi i Brigadës 133.

23 Pra çështja e emërimit të Lulzim Morinës për komandant të
24 asaj brigade mund të ketë ndodh pas majit të vitit 1999.

25 PY. Mirë, do t'i kthehem emërimit të tij pas pak. Por dua të

- 1 verifikoj, Lulzim Morina, a thirrej ndryshe Luli? Ngaqë është
2 Lulzim, dhe për shkurt për Lulzim është Luli, apo jo?
- 3 PË. Po, dikush e thirrte Luli, por ne të gjithë e dinim që
4 është Lulzim Morina. Edhe ushtarët e dinin edhe stafi i
5 brigadës e dinte, pra, që ai ishte Lulzim Morina. Pseudonimet
6 zakonisht përdoren për -- kur nuk i njef struktura ose rrethi,
7 ku ai vepron. Luli ne edhe fëmijët edhe kur janë Lulzim, i
8 thërrasim Lul. Por nuk është ndonjë pseudonim që ai e ka pas
9 si nofkë.
- 10 PY. Po. Jo, nuk po thosha që është pseudonim. Jo, thashë që
11 është emri shkurt për Lulzim është Lul. Dhe kështu njihet.
- 12 PË. Emri shkurt është Lul, po. Emri shkurt është Luli, po.
- 13 PY. T'i kthehem emërimit të tij tani.
- 14 Z. DIXON: [Përkthim] Të kërkoj që të nxjerrim në ekran
15 një dokument lidhur me këtë, me numër U001-4608. Versioni në
16 shqip me përkthim në anglisht.
- 17 PY. Do të dalë në ekran, z. Maloku. Të shohim pjesën e
18 poshtme, do shihni që është një urdhëresë e datës 22 mars e
19 vitit 1999, nënshkruar nga Lulzim Morina, si komandant i
20 Brigadës 135. E shihni në pjesën e poshtme të faqes?
- 21 PË. Po.
- 22 PY. E njihni nënshkrimin e tij?
- 23 PË. Jo, nuk e kam pa kurrë unë nënshkrimin e tij.
- 24 PY. Por do pajtoheshit me mua në qoftë se do thosha që ky, që
25 kjo urdhëresë konfirmon që ai ka qenë komandant i Brigadës 135

1 asokohe, pra në datë 22 mars 1999, në bazë të kësaj urdhërese,
2 ajo që thotë kjo urdhëresë?

3 PË. Nëse mundeni me e lëshu ma poshtë, do të thotë,
4 dokumentin.

5 PY. Që të shihni pjesën e sipërme, po, patjetër.

6 PË. Nuk shoh këtu asnjë vulë, asnjë shenjë që ky është
7 dokument zyrtar i Zonës Operative të Dukagjinit. Zakonisht
8 dokumentet e tilla mbaheshin me, i mbante Emrush Xhemajli, i
9 mbante ato dokumente. Dokumentacionin e Zonës Operative të
10 Dukagjinit. Këtu s'shof unë asnjë shenjë që ky është dokument
11 i zonës operative të Dukagjinit.

12 Dhe data 22.03.1999, sinqerisht nuk më kujtohet që në atë
13 periudhë ka qenë ai komandant brigade. Unë nuk e kam njoft
14 ashtu.

15 PY. Ka dhe një dokument tjetër të cilin dua t'jua tregoj.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Është dokumenti me numër U000-3661
17 deri në U000-3661. Është vetëm një faqe, bashkë me përkthimin
18 në anglishte.

19 PY. Ky është një tjetër dokument i cili na është dhënë nga
20 Gjykata. Është, pra, është dokumenti i Brigadës 135, i datës
21 18 mars 1999. Nuk ka të plotësuar nga batalioni më poshtë, por
22 si komandant tregohet që emri është Lulzim Morina, e shihni?
23 Bashkë me zëvendëskomandantin, emri, mbiemri.

24 PË. Po. Po, e shof.

25 PY. Po me këtë tani a ju kujtohet që ai të ketë qenë

1 komandant i brigadës asokohe?

2 PË. Jo, nuk e kam dit derisa që ai ka qenë në q'atë kohë
3 komandant brigade.

4 PY. Më duket se keni thënë në dëshminë tuaj pak më herët që
5 ai mbase mund të ketë qenë emëruar në këtë pozitë, por më
6 vonë, mendoni ju, kështu?

7 PË. Po, ashtu kam mendu.

8 PY. A është e saktë, e vërtetë, pra, që në një prej
9 dokumenteve Brigada 135 përmendet se ka komandant Lulin, dhe
10 nëse thuhet komandant Luli atëherë do të ishte komandant
11 Lulzim Morina?

12 PË. Në qoftë se ka qenë Lulzim Morina komandant brigade,
13 atëherë shumë ushtarë edhe eprorë të strukturave të ndryshme
14 në Dukagjin kanë mund me thanë që komandant është Luli,
15 komandant Luli është komandant i Brigadës 135.

16 PY. Pra, që fjala komandant Luli, është pikërisht për këtë
17 duke qenë se është Lulzim, Luli është shkurt për Lulzim?

18 PË. Është logjike ajo.

19 PY. Faleminderit, z. Maloku. Unë s'kam më pyetje të tjera për
20 ju.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
23 z. Dixon.

24 DËSHMITARI: Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Maloku, do

1 bëjmë tani pushim prej dhjetë minutash. Do të rikthehemi mbas
2 dhjetë minutash. Ju lutem, mos flisni me askënd jashtë kësaj
3 salle lidhur me dëshminë tuaj këtu. Asistentja e sallës do ju
4 shoqërojë të dilni nga salla.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
7 ndërprerjen e seancës deri në orën 10.10.

8 --- Seanca ndërpritet në orën 9.59

9 --- Seanca rifillon në orën 10.12

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
11 dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts që
14 përfaqëson z. Rexhep Selimi do t'ju bëjë pyetjet tani. Ju
15 lutem dëgjojeni me vëmendje.

16 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

17 Z. ROBERTS: [Përkthim]

18 PY. Mirëmëngjes, z. Maloku.

19 PË. Mirëmëngjes.

20 PY. Shpresoj që me pak fat do të përfundojmë para orës 11.00.
21 kam disa tema të ndryshme dhe shpresoj t'i kem pyetjet të
22 qarta dhe përgjigjet mundësisht me "po" ose me "jo" për
23 shumicën e pyetjeve. Sigurisht në çdo moment që keni nevojë që
24 duhet të shpjegoni më shumë, lirisht bëjeni këtë gjë.

25 PË. Faleminderit, Avokat.

1 PY. Keni thënë disa herë në sallën e gjyqit, por edhe gjatë
2 intervistave dhe në transkripte shohim të 24 marsit, keni
3 treguar sesi UÇK-ja ka qenë një ushtri vullnetare. E keni
4 thënë këtë disa herë dhe gjatë intervistës me ZPS-në.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do të më duhet të jap referencat
6 për palët. Këtë e keni thënë në provën P2090.4, faqja 5;
7 P2090.3, faqet 17, 18.

8 PY. Dhe keni thënë të njëjtën gjë dhe për intervistën që i
9 keni dhënë ish-Tribunalit të Hagës në 2005-n. Kështu është
10 ama, ka qenë një ushtri vullnetar, apo jo?

11 PË. Nga ushtari i parë deri tek i fundit, e tërë struktura e
12 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë vullnetare.

13 PY. Po. Dhe kur u demobilizuat ose kërkuat të
14 demobilizoheshit në 20 qershor '99, ju e keni përmendur faktin
15 që jeni kyçur vullnetarisht dhe nëse nuk ju përmbushje kërkesa
16 do largoheshit vullnetarisht, apo jo?

17 PË. Po, sigurisht. Pra, është drejtë e imja nëse unë jam kyç
18 vullnetarisht, kam të drejtën edhe të largohem vullnetarisht
19 nëse nuk më plotësohet kërkesat që të demobilizohem me shkrim.
20 Çdo ushtar, z. Avokat --

21 PY. Po.

22 PË. -- ka pas që kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës një muaj, disa dy muaj, disa tanë kohën, por të gjithë
24 janë veteranë për shkak se nuk ke mujt me ja mohu kontributin
25 në qoftë se edhe vetëm një ditë ka qenë në radhët e Ushtrisë

1 Çlirimtare të Kosovës.

2 Për shembull, ushtri të tjera, kroate e kanë së paku me
3 qenë në luftë për me marrë statusin e veteranit. Tek ne s' kemi
4 mujt për shkak se një në qoftë se ka qenë me uniformën e UÇK-
5 së, atij i takon statusi i veteranit. Ky o ndryshimi, më
6 falni, ky o ndryshimi mes një strukture, një ushtrie që
7 vullnetarisht krijohet dhe ushtrive që krijohen në baza
8 institucionale me ligje, me ftesa, me mobilizime. Ka ligje
9 strikte të miratuara në kuvendet, në qeveri, e të tjera. Më
10 falni.

11 PY. Faleminderit. Po përpigësja t'ju thoja që doja ta sqaroja
12 pak pyetjen. Edhe mund të jepni një përgjigje koncize dhe të
13 shkurtër nëse është e mundur. Unë po përpigësja të thoja këtë,
14 që situata nuk ka ndryshuar gjatë luftës në asnjë moment, qysh
15 nga momenti kur u kyçët ju e deri në qershor. Ti në çdo moment
16 mund të largoheshe po të doje si vullnetar?

17 PË. Po.

18 PY. E njëjta gjë vlente dhe për ushtarët e tjerë, apo jo, me
19 të cilët luftonit ju? Ata mund të largoheshin kur të
20 dëshironin?

21 PË. Sigurisht. Nëse më lejoni, një minutë.

22 PY. Patjetër, patjetër.

23 PË. Erdhën dy ushtarë nga Zvicra. Kishin marrë pushim vjetor.
24 Njoni një muaj, tjetri dy muaj e dy ditë. Kur e kreu pushimin
25 vjetor, tha, "Komandant, tha, unë duhet të kthehem në punë". E

1 la armën edhe shkoi në Zvicër. Ky tjetri e kish pas fatin
2 ashtu kishte edhe dy javë kohë, mbas tri dite u vra, me 7
3 korrik në Morinë. Dhe është sot dëshmor. Kështu ka qenë.
4 PY. Faleminderit. Kjo na ndihmoi, në fakt, për ta sqaruar.
5 Por, unë po përpigësja të të thoja sa e vështirë është për një
6 ushtri të kesh persona vullnetarë. Kur personat kyçen e ikin
7 kur dëshirojnë, kjo e bën të vështirë punën e një njësitit, apo
8 jo, të luftojë siç duhet?

9 PË. Është vështirë në një aspekt. Për shembull, mbajtja e
10 strukturës konstante, do të thotë, ushtria e rregullt që
11 mbahet konstant, për shembull, një vit, dy vjet, dhe ai krijon
12 përvojë; ushtarët që vijnë e shkojnë e merr një përvojë shkon,
13 vjen tjetri por pa përvojë. Pra, duhet edhe atë me e fillu
14 trajnimin prej fillimit. Problemi tjetër është edhe te
15 respektimi ose te zbatimi i zinxhirit komandues, i komandës, i
16 urdhnit.

17 Për shembull, na nuk kemi mujt me i thon ushtarit, "Të
18 urdhnoj me shku këtu e këtu", por "A po shkon", edhe "kush po
19 shkon vullnetar në këtë pikë". Ne kemi pas pika të nxehta që i
20 quanim ne, zgjidhshim vullnetare, pra nga vullnetarët,
21 vullnetarë kush po shkon është atë pozicion që ishte shumë më
22 i rrezikshëm, për shembull, se të tjerat.

23 Po e them prapë, është e vështirë me e spjegu me një
24 proces gjyqësor, pra, krejt problematikat me të cilat
25 ballafaqohet struktura komanduese në një ushtri vullnetare.

- 1 PY. Kuptoj. Tani dua të flas për drejtorinë operative.
- 2 Ju e keni shpjeguar gjatë seancës përgatitore se
- 3 drejtoria operative pranë Shtabit të Përgjithshëm, apo Shtabi
- 4 i Përgjithshëm më saktë, u krijua në dhjetor, filloi të ishte
- 5 funksionale në dhjetor 1998. Kjo është thënë në paragrafin 7
- 6 të shënimit tuaj përgatitor. Po i keni thënë po ashtu
- 7 Prokurorit se në korrik të '98-s erdhi t'ju takonte Bislim
- 8 Zyrapit dhe ju informoi se po krijonte drejtorinë operative. A
- 9 ju kujtohet ta keni thënë këtë? Kjo thuhet në transkriptin
- 10 provizor të ditës së djeshme, faqet 31 dhe 32.
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Pra, në atë kohë në korrik, në fakt, në thelb drejtoria
- 13 operative ishte thjesht z. Zyrapit, një person i vetëm që po
- 14 përpiqej të krijonte drejtorinë operative. Saktë?
- 15 PË. Po. Se fillimisht krijohet drejtoria operative për të
- 16 mund me pas komplet pasqyrën në krejt territorin. Bislimi
- 17 kishte dalë me i vizitue të gjitha territoret që mbaheshin nën
- 18 kontroll nga UÇK-ja me u njoftu me të gjitha njësitë, më këqyr
- 19 kush ku është, në mënyrë që pastaj me e pas një fotografi të
- 20 qartë për krejt territorin, kapacitetet logjistike, kapacitete
- 21 njerëzore, strukturat në të gjithë territorin e Kosovës. Kjo
- 22 është normale një aktivitet i tillë.
- 23 PY. Mesa keni ju dijeni, përpara këtij takimit në mes të
- 24 korrikut të '98-s me z. Zyrapit, s'ka pasur ndonjë drejtori
- 25 operative funksionale, apo jo?

1 PË. Jo, s'ka pas.

2 PY. Në këtë periudhë kohore, korrik të '98-s dhe deri në
3 momentin që ju u bëtë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm në
4 nëntor, z. Zyrapi supozojmë po përpiquej të krijonte këtë
5 drejtori, por nuk ka qenë funksionale deri në nëntor, dhjetor,
6 apo jo? A ka të drejtë?

7 PË. Keni të drejtë. Nëse më lejoni edhe një shpjegim të
8 shkurtër.

9 PY. Patjetër.

10 PË. Ishte 17 korriku kur jam taku me Zyrapi, në fakt, kur
11 Zyrapi më ka vizitu mu në brigadën time në Junik dhe jemi taku
12 në një fshat, se une isha një njësi tjetër duke e vizituar.
13 Por kur me 17 ose 18 gusht jam tërheq, unë i plagosur nga Zona
14 Operative -- nga Prapaqani në Breshanc të Suharekës Bislim
15 Zyrapi nuk ka qenë më në Kosovë dhe ai është kthi në nëntor të
16 '98-s. Pra, s'ka qenë fare në territor të Kosovës.

17 PY. Pra, planifikimi po bëhej gjatë nga z. Zyrapi, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Kur u kyçët thatë që drejtori i drejtorisë operative ka
20 qenë Gjeneral Ramiz Beriqi. Ky ishte caktuar por nuk e mori
21 asnjëherë detyrën dhe qëndroi gjatë Kosovës -- gjatë të gjithë
22 konfliktit. Kështu?

23 PË. Po, ashtu mu ka komuniku mu nga Bislim Zyrapi që shefi i
24 drejtorisë operative do të vjen një gjeneral shumë i njohur ka
25 qenë nga lufta në Bosnje, Ramiz Beriqi. Më kujtohet, z.

1 Avokat, që gjatë qëndrimit tim në drejtorinë operative të
2 Shtabit të Përgjithshëm, në telefonin e drejtorisë operative
3 dy herë ka thirr Ramiz Beriqi dhe dy herë, të dy herët kam
4 qenë une afër telefonit dhe kemi bisedu. Mu ka prezantuar si
5 Ramiz Beriqi dhe është njoftu -- është interesu se ç'ka po
6 bohet dhe na kemi pritë, pra, që ai do të vjen.

7 PY. Por ama ai s'erdhi asnjëherë për gjatë gjithë konfliktit
8 mesa keni ju dijeni?

9 PË. S'erdhi asnjëherë.

10 PY. Edhe sigurisht me një shef të drejtorit operativ jashtë
11 shtetit, jashtë vendit ku po ndodhte konflikti, e bënte të
12 vështirë punën e kësaj drejtorie, apo jo?

13 PË. Ne ishim të detyruar pastaj të punojmë me kapacitetet që
14 i kishim. Z. Avokat, te oficerët madhorë siç ishte Ramiz
15 Berici, gjeneral i njohur, Rrahim Ademi, emër i njohur në
16 luftë në Kroaci, pak është vështirë kyçja e tyre ose vendimi i
17 tyre me u kyç në funksione ose në shtabe ku nuk janë kupolë e
18 tyre institucionet, ku nuk merret emërimi prej komandantit
19 suprem.

20 Këto janë problematika me të cilat e kanë vështirë
21 vendimin me e marrë, vendimin njerëzit apo personat me të
22 kaluar atë të famshme, për shembull, në disa luftëra dhe me
23 grada atë të larta. Po unë i kuptoj të dytë.

24 PY. Po. Nuk po përpigësja t'i vija fajin z. Beriqi, po pasoja
25 po thoj, fakti që shefi i drejtorisë operative nuk ishte

1 fizikisht në Kosovë e bënte të vështirë punën e asaj
2 drejtorie, ja ndërlikonte punon, apo jo, duke mos qenë vetë
3 kreu i drejtorisë?
4 PË. Ka qenë -- kam pas nderin me qenë Sali Veseli si njeri i
5 dytë, dhe po në fakt që ishte shef tani i drejtorisë operative
6 dhe unë e mendoj që i kemi kry ato detyra sa kemi mundur me
7 kapacitetet tona që i kemi pas.

8 Në Shtabin e Përgjithshëm, thashë edhe dje, kanë qenë tre
9 oficerë, pra ka qenë Bislir Zyrapi, shef i shtabit; Sali
10 Veseli, që tani e kryente, do të thotë, e kryente tanë kohën e
11 detyrën e shefit të drejtorisë operative; edhe unë një oficer.

12 Por që unë e kisha kry akademinë për oficer të
13 prapavijës. Mu puna më qiti me qenë nëpër vija të frontit, se
14 unë kam qenë oficer i shkolluar për oficer të prapavijës.

15 PY. Kalojmë tani tek një temë tjetër. Lidhet me dëshminë që
16 keni thënë me inspektorin e përgjithshëm, me kryeinspektorin.
17 Keni dhënë dëshmi të hënën për inspektorin e përgjithshëm. Po
18 ua lexoj që ta kemi të qartë për kontekst.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pyetje -- më falni, fillimisht për
20 palët bëhet fjalë për transkriptin e 24 marsit, në faqet 58
21 dhe 59.

22 PY. Pyetja ka qenë kjo:

23 "Mesa keni ju dijeni, çfarë roli kishte inspektori i
24 përgjithshëm i UÇK-së?"

25 Ju jeni përgjigjur që:

1 "Inspektori i përgjithshëm i UÇK-së, tani unë nuk e di
2 sesa ja dilte ky inspektor ta ushtronte këtë funksion. Në fakt
3 detyrat e tij ishin të caktonte inspektorë në zonat operative,
4 mbase në nivel brigade. Duhet t'i propozoheshin Shtabit të
5 Përgjithshëm dhe të emëroheshin si inspektorë. Dhe inspektorët
6 kishin detyrën që të mbikëqyrnin të gjitha veprimtaritë e
7 njësive në zonat operative në të gjitha brigadat për gjatë
8 të gjithë territorit të Kosovës për të konstatuar ndonjë
9 parregullsi të mundshme. T'i raportonin Shtabit të
10 Përgjithshëm, shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe të
11 propozonin masa për të reduktuar këto parregullsi apo këto
12 mangësi."

13 Dhe në fund ke vazhduar të flasësh dhe ke thënë pastaj:

14 "Kjo është ajo që di unë lidhur me përgjegjësitë e një
15 inspektori të përgjithshëm në një ushtri të rregullt. Ama sesa
16 ja doli inspektori i përgjithshëm ta zhvillonte këtë sektor
17 unë nuk di të them, sepse siç ju thatë në janar unë ika nga
18 Shtabi i Përgjithshëm dhe shkova në Dukagjin."

19 Këtë jua dhashë për kontekst që t'ju kujtohet. E mbani
20 mend që biseduat për këtë të hënë?

21 PË. Po. Patjetër. Vetëm një shpegim i shkurtë. Inspektori i
22 përgjithshëm --

23 PY. Do t'ju bëj unë disa pyetje. Më mirë t'ju bëj unë
24 pyetjet, pastaj po gjykove që prapë duhet ta shtjellosh,
25 shtjelloje. Që të jemi të qartë, ky sipas jush ka qenë

1 teorikisht roli i një inspektori të përgjithshëm në një

2 ushtri, apo jo? Në teori duhet të funksiononte kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Ky rol, ky post i inspektorit të përgjithshëm, nuk ishte

5 rol që buronte nga ish-Armata Jugosllave. Në ish-Armatën

6 Jugosllave nuk ka patur ndonjë post të inspektorit të

7 përgjithshëm, të paktën në vitet '90.

8 PË. Ka pas edhe në Armatën Jugosllave, është qujt pak

9 ndryshe, por ka pas. Ka pas rol të tillë, por të gjitha

10 ushtritë e kanë inspektorin e përgjithshëm, për shkak se ai e

11 ka një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e

12 parregullsive nëpër nivele organizative të njësive nën

13 komandën e shefit të shtabit të shtabit.

14 Dhe identifikimi i atyne pastaj me u raportue te shefi i

15 shtabit, por inspektori i përgjithshëm sipas detyrës ka pas të

16 drejtë përgjegjësi vetëm me propozu masa, pra, për me u

17 përmirësue parregullsitë që janë has në punën e inspektoratit,

18 tash. Ky është inspektori i përgjithshëm, por kur të emërohen

19 inspektorët në nivele ma të ulëta në zona operative dhe

20 brigada, atëherë inspektori i përgjithshëm i identifikon

21 parregullsitë, ja raporton shefit të shtabit dhe propozon

22 masa. Kjo është.

23 E kam thënë edhe dje, nuk e di sa ka arrit me e ndërtu

24 këtë strukturë.

25 PY. Po. Që të jemi të qartë, dëshmia juaj mbështetet në

1 pozitë -- në atë që ushtronte një pozicion i tillë në ish-

2 Armatën Jugosllave, apo jo? Si duhej të kishte qenë?

3 PË. Jo, jo ne -- jo, kemi marrë shefi i shtabit ka marrë

4 rregullore edhe të shteteve të NATO-s. Na jemi mundu me

5 instalu drejtori edhe funksione në bazë të skemave

6 organizative të shtabeve të shteteve të NATO-s. këto i kemi

7 marrë na.

8 Edhe z. Zyrapi ju ka spjegu këtu që i kemi përkthi ato,

9 pra janë përkthi ato shqip edhe janë dhon nëpër drejtori.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj se ka një gabim

11 transkripti. Ju lutem në rreshtin 32, faqja 32, "I raportonte

12 Shtabit të Përgjithshëm", duhet të thuhej këtu, i raportonte

13 shefit të shtabit. Mbase mund ta sqarojmë këtë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tha Shtabi i

15 Përgjithshëm dëshmitari.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ekipi më thonë që ka thënë

17 shefi i shtabit të përgjithshëm.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] E sqarojmë me dëshmitarin.

19 PY. Dëshmitar, kur thoni që i raportonte, i raportojtë kujt?

20 I raportojtë Shtabit të Përgjithshëm apo shefit të Shtabit të

21 Përgjithshëm? Çfarë keni dasht të thoni?

22 PË. Vetëm nëse kam gabu në një fjalë, ky është dasht t'i

23 raporton shefit të shtabit.

24 PY. Faleminderit. Ta kuptoj, kur flisni për inspektorin e

25 përgjithshëm, është një lloj -- pra është një lloj bashkimi,

1 shkrirje e rregulloreve të vendeve të NATO-s apo aq sa edhe
2 diçka ekuivalente me Armatën Jugosllave?

3 PË. Por ndëgjoni, të gjitha armatat në fakt kanë pak dallime
4 në krijimin e strukturave. Por sa di une i gjithë
5 dokumentacioni që është përkthyer në Shtabin e Përgjithshëm ka
6 ardhur nga vende të ndryshme të NATO-s. Nuk e di cilat, po sa më
7 kujtohet ka qenë një ekip përkthyesish që janë marrë me
8 përkthimin e atyre rregulloreve, përgjegjëseve, edhe jemi
9 mundu pra. Kjo ka qenë përpjekja jonë për të ndërtuar një shtab
10 të përgjithshëm të secila drejtori dhe secila pozitë me i pas
11 përgjegjësitë dhe detyrat e caktuara me rregullore.

12 PY. E kuptova. Të përpiqemi tek inspektori i përgjithshëm,
13 vetëm roli i inspektorit të përgjithshëm. Pra, nga ajo që
14 thoni ju, ju mendoni se rregulloret lidhur me inspektorin e
15 përgjithshëm ishin frymëzuar apo vinin nga vendet e NATO-s,
16 kështu? Vetëm për inspektorin e përgjithshëm e kam fjalën.

17 PY. Jo, për të gjitha. Për të gjitha drejtoritë.

18 PY. Nuk është diçka për të cilën do të kishin përvojë shumë
19 ushtarë nëse vinte nga vendet e NATO-s, në dallim nga situata
20 po që se do të kishte ardhur nga ish-Armata Jugosllave,
21 kështu?

22 PË. Nuk kisha ditë të përgjigjem ndoshta unë këtu, se ne, ish-
23 Armatën Jugosllave e kishim lëshuar, unë në '85-s. Ishte kohë e
24 gjatë ajo, z. Avokat, edhe z. Zyrapi --

25 PY. Ju kuptoj.

1 PË. -- kishte përvojë nga lufta në Bosnje. Ka komandu me
2 nëntë brigada, do të thotë, edhe ai sigurisht ka marrë ndonjë
3 përvojë edhe nga atje. Pra, ishin përvoja që ne disa i dinim,
4 disa i kishim në aspektin teorik të shpjeguara nga mësimet që
5 i kemi pas. Pra, ne jemi mundu me dhënë kontributin tonë për
6 me ngrit një shtab i cili do të kishte secila drejtori
7 përgjegjësitë edhe detyrat e veta të caktuara.

8 Unë nuk jam marrë me përkthimin dhe përpilimin e atyne
9 rregulloreve.

10 PY. Ju kuptova. Edhe një herë, të gjitha pyetjet e mia i kam
11 për rolin e inspektorit të përgjithshëm. Të qëndrojmë vetëm
12 tek roli i inspektorit të përgjithshëm. Ta përqendrojmë aty
13 dëshminë tuaj. Pra, nuk kishte inspektor të përgjithshëm
14 përpara nëntorit apo dhjetorit të vitit 1998. Kështu është me
15 aq sa keni ju dijeni?

16 PË. Nuk kishte para dhjetorit 1998.

17 PY. Kur këtë pozitë e zuri z. Selimi, besoj se keni thënë në
18 seanca përgatitore se kishte anëtarë të ndryshëm të Shtabit të
19 Përgjithshëm të cilët nuk kishin njohuri apo stërvitje
20 ushtarake. Është në shënimin përgatitor paragrafi 3. Pra, z.
21 Selimi, pra, ishte njëri prej tyre, pra nuk kishte formim
22 ushtarak me aq sa keni ju dijeni. Flas formim ushtarak zyrtar,
23 ë, në Armatën Jugosllave.

24 PË. Nuk e di a e ka pas shërbimin ushtarak të kryer në ish-
25 Armatën Jugosllave, por z. Avokat, në të gjitha ushtritë që

1 janë në luftë përvoja merret edhe në luftë. Edhe ngritja në
2 pozita graduese merret edhe në luftë. Pra, ne kemi edhe
3 gjeneralët e luftës për shembull. Nuk ka kry shkolla
4 profesionale, por me luftë është bo gjeneral. Z. Selimi ka
5 qenë prej ditëve të para në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës
6 edhe në bazë të përvojave që ky i ka arrit gjatë tanë
7 veprimtarisë së tij, nga dita, praktikisht, nga ditët e para
8 të themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës muj me thanë
9 që z. Selimi ka pas, ka qenë një epror me një përvojë të
10 respektueshme në strukturën e Shtabit të Përgjithshëm.
11 PY. Do bëj tani pyetje për realitetin faktik të inspektorit
12 të përgjithshëm. Inspektori i përgjithshëm nuk është drejtor
13 drejtorie, apo jo? Nuk ka një drejtori brenda Shtabit të
14 Përgjithshëm që të ishte drejtoria e inspektorit të
15 përgjithshëm. Mund ta konfirmoni këtë?
16 PË. Po une e thashë edhe dje, nuk di sa ka arrit me e
17 zhvillu, do të thotë, atë sektor. Pastaj kur të ishte kriju,
18 do të thotë, rrjeti i inspektorëve dhe funksionimi i tyre ka
19 mund me u qujt vetëm inspektor i përgjithshëm ose drejtori e
20 inspekcionit në Shtabin e Përgjithshëm. Për emërtimet nuk e di
21 une pastaj se si do të vendoste Shtabi i Përgjithshëm.
22 PY. Por nuk kishte kurrë një rrjet inspektorësh të emëruar
23 nëpër zona me aq sa dini ju?
24 PË. Kur kam shku në Dukagjin nuk më kujtohet që ka pas në
25 Dukagjin. E di që komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit

1 ma ka dhënë një farë si detyre inspektimin e krejt njësiteve
2 nëpër vija dhe brigada të Zonës Operative të Dukagjinit.

3 PY. Pra, në thelb, bënit ju inspektime brenda kësaj
4 kompetence, pra, në zonën e Dukagjinit pas mesit të janarit
5 1999. Pra, ju inspektonit trupat, kontrollonit nëse kishte
6 parregullsi, e të tjerë, kështu është?

7 PË. Po, mund të quhet ashtu që një prej detyrave të mia dhe
8 kompetencave që i kam kry në Zonën Operative të Dukagjinit nga
9 dikund gjysma e dytë e janarit e deri me 8 maj ku kam kaluar
10 në Brigadën 138 në Koshare, në atë periudhë një prej atyne
11 detyrave që unë i kam kry, ka qenë edhe inspektimi i të gjitha
12 njësive që ishin vartëse të Zonës Operative të Dukagjinit.

13 PY. Dhe brenda këtij roli, për të cilin ju keni folur
14 gjerësisht në seancën përgatitore, dokumenti numër 2,
15 paragrafi 7, 37 dhe 72, ku flisni për të cilat inspektimet e
16 ndryshme të cilat i keni kryer në zonën e Dukagjinit, në këtë
17 rol tuajin ju nuk i keni raportuar asnjëherë drejtpërdrejtë z.
18 Selimi si inspektori i përgjithshëm?

19 PË. Jo.

20 PY. Në fakt, nuk kishit asnjë marrëdhënie me të pasi kur e
21 latë Shtabin e Përgjithshëm në janar të vitit 1999. Kështu apo
22 jo?

23 PË. Jo, asnjë komunikim, as nuk e kam pa.

24 PY. Po në të njëjtën periudhë, besoj se mund të konfirmoni se
25 nuk kishte zyra të inspektorit të përgjithshëm, me aq sa dini

1 ju?

2 PË. Nuk kishte mesa di unë.

3 PY. Se nuk kishte personel që të punonte drejtpërdrejtë me z.

4 Selimi si inspektori i përgjithshëm?

5 PË. Unë të gjitha vërejtjet që unë i kisha, vizitat që i bëja

6 nëpër brigada dhe deri në nivelin e togut brenda Zonës

7 Operative të Dukagjinit ja komunikoja komandantit të Zonës

8 Operative të Dukagjinit dhe masat që duhet marrë sipas

9 njohurive të mia dhe propozoja masat që duhet marrë.

10 PY. Dua që të flasim shkurtimisht për takimet informuese për

11 të cilat keni folur në Shtabin e Përgjithshëm me komandantët e

12 zonave, për të cilat folët me z. Misetic dhe. Pra, ishin dy

13 mbledhje kur ju ishit në drejtorinë operative në Shtabin e

14 Përgjithshëm, një në dhjetor dhe një në janar. Kjo është në

15 faqen 108 të transkriptit të përkohshëm të djeshëm.

16 Në shënimin përgatitor që është -- në seancat përgatitore

17 që keni bërë me Prokurorinë, ju keni thënë se "Në këto

18 mbledhje merrnin pjesë vetëm Shtabi i Përgjithshëm i -- më

19 falni, shefi i shtabit, z. Zyrapi, drejtorët e drejtorive dhe

20 komandantët e zonave". Ky është paragrafi 8 i dokumentit

21 përgatitor 1. Ju kujtohet që i keni thënë kështu Prokurorisë

22 dhe a është e saktë kjo?

23 PË. Po, e saktë është.

24 PY. Por, ka dallim midis drejtorit të drejtorisë, për

25 shembull, midis Ramë Bujës, që më duket ka qenë drejtori i

1 çështje civile?

2 PË. [E padëgjueshme].

3 PY. Më duket se nuk u regjistrua përgjigja. Pra, ishte
4 drejtor i drejtorisë për çështjet civile, kështu?

5 PË. Po, Ramë Buja.

6 PY. Dhe unë do them që ka dallim ndaj atij dhe pozitës së
7 inspektorit të përgjithshëm, për të cilën, siç e thamë më
8 herët inspektori i përgjithshëm nuk ishte drejtor drejtorie.
9 Pra, nuk ishte në nivel të drejtorisë në Shtabin e
10 Përgjithshëm. Pra, ka dallim midis këtyre dy lloj pozitave,
11 këtyre dy lloj personave.

12 PË. Ka dallim edhe në mes Ramë Bujës edhe Bislim Zyrapit. Po
13 kanë qenë bashkë në mbledhje, do të thotë. Është çështje e
14 shtabit a ka qenë edhe z. Selimi si inspektor i përgjithshëm
15 anëtar i atij shtabi. Unë e kam kuptu është, pra. Nuk është që
16 unë e kam pa strukturën organizative të shtabit me emra e
17 mbiemra, do të thotë. Edhe për ato dy mbledhje, z. Avokat, për
18 njërin, ato të parën që mbajt në dhjetor përafërsisht i di do
19 tema të cilat janë diskutu aty, ndërsa për të dytën unë nuk di
20 për shkak se të nesërmen jam largu nga Shtabi i Përgjithshëm
21 për në Zonën Operative të Dukagjinit.

22 PY. Kur thoni pak a shumë temat për të cilat është folur aty,
23 ju e konfirmuat dje që ju nuk ishte në atë mbledhje.

24 PË. E kam spjegu, z. Avokat, se procesverbali, temat,
25 raportet me shkrim që vijshin nga komandantët e zonave në atë

1 mbledhje, vinin në drejtorinë operative të Shtabit të
2 Përgjithshëm dhe në drejtorinë operative të gjitha ato
3 materiale bëheshin si raport, si raport nga mbledhja e Shtabit
4 të Përgjithshëm dhe --

5 PY. Po, po. Ajo që desha të them është kjo: Duke qenë se ju
6 vetë s'keni qenë i pranishëm në mbledhje nuk mund të thoni, me
7 aq sa dini ju vetë se kush ka qenë e kush nuk ka qenë në ato
8 mbledhje -- në këto dy mbledhje?

9 PË. Ashtu është.

10 PY. Pra, nëse kishte mangësi në informacion a gabime, ju nuk
11 keni nga dinit që ta verifikoni këtë në bazë të asaj që ju
12 dini vetë personalisht. Kështu është, apo jo?

13 PË. Sigurisht.

14 PY. Dua të kaloj në një temë të fundit tani. E di se ju keni
15 folur për këtë me z. Misetic, pjesërisht për këtë. Ka të bëjë
16 me demobilizimin duaj.

17 Tani, në shënimin përgatitor, mbi seancën përgatitore me
18 ju thatë që -- është Shënimi Përgatitor numër 2 - ju nuk --
19 pra, "Ju dhe anëtarë të UÇK-së nuk ishit të shqetësuar në
20 lidhje me rihyrjen e serbëve në Kosovë asokohe sepse kishte
21 45.000 trupa të KFOR-it". Dhe pastaj ju thoni që:

22 "Procesi i demobilizimit u krye nga UÇK-ja".

23 Është në Shënimin Përgatitor numër 2. Ju kujtohet që e
24 keni thënë këtë?

25 PË. Po, më kujtohet. Edhe po ju them se demobilizimi ka shku

1 me faza ashtu qysh janë marrë vesh me -- në bazë të
2 marrëveshjeve të ndërkombëtarët. Dhe e fundit ka qenë
3 transformimi nga UÇK në TMK. Por, demobilizimi ka shku me faza
4 ashtu qysh janë, qysh kanë qenë të parapare me marrëveshjet që
5 janë bo nga Rambujeja, pastaj nga marrëveshja e Kumanovës e ka
6 bo NATO-ja dhe --

7 PY. Po.

8 PË. -- me faza ka qenë.

9 PY. Tani, kërkesa juaj për demobilizim ka qenë me 30 qershor.
10 Keni parë dokumentacionin e kësaj. Ju jeni larguar me datë 27
11 qershor 1999. Kështu?

12 PË. Kërkesa ka qenë më duket me 20. Nuk e di është data atje
13 e kërkesës. Ndërsa urdhrin e kam marrë me 1 korrik. Me 1
14 korrik une -- por disa [E padëgjueshme].

15 PË. Dhe --

16 PË. Me 25 i kam dorëzu pajisjet luftarake, sa di une, dhe e
17 kam prit pastaj urdhrin për demobilizim, por kam qenë në Pejë
18 në fshatin tim.

19 PË. Dhe ju ishit shumë i qartë në mendimin tuaj asokohe, apo
20 jo, se lufta kishte marrë fund dhe s'kishte asnjë mundësi që
21 të do të fillonte prapë, sepse si një ushtar krenar që e
22 kishte ndihmuar UÇK-në 18 muajt e fundit, ju nuk do të ishit
23 demobilizuar po të kishit menduar vërtetë se kishte ndonjë
24 rrezik se do të rifillonte konflikti, apo jo?

25 PË. Sigurisht.

1 PY. Dhe po kështu, UÇK-ja, sipas mendimit tuaj dhe në bazë të
2 bisedave që keni bërë me anëtarë të tjerë të UÇK-së, UÇK-ja
3 nuk do të ishte demobilizuar, pra nuk do ta kishte përfunduar
4 demobilizimin pa incident, apo pa rezistencë nëse edhe ata nuk
5 besonin -- pra, nëse ata nuk do të besonin se nuk kishte më
6 rrezik se do të rifillonte konflikti në vitin 1999. Kështu?

7 PË. Jam shumë i bindur që po që se kishte pas një mosbesim
8 nga cilido njësit i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, atëherë
9 nuk i kishte lënë armët. Kish dal në mal.

10 PY. Ama nuk ndodhi. Demobilizimi ndodhi sepse vërtetë besohej
11 se lufta kishte marrë fund me 20 qershor?

12 PË. Besuam të gjithë, pra, edhe të gjithë ushtarët e UÇK-së,
13 strukturat edhe të gjithë populli besum që lufta ka marrë fund
14 dhe Kosova u çliru. Pra, nuk kishte asnjë lloj dyshimi në
15 asnjë anëtar që do të ketë luftë përsëri në Kosovë për sa të
16 jenë forcat e KFOR-it aty.

17 PY. Faleminderit shumë, z. Maloku. U përhoqa që t'i mbyll
18 para orës 11.00 dhe me ndihmën tuaj ja arrita kësaj.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,
20 nuk kam më pyetje të tjera.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 z. Roberts.

23 DËSHMITARI: Faleminderit, Avokat, faleminderit shumë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta bëjmë
25 tani pushimin, në mënyrë që të mos filloni e ta ndërprisni pas

1 pesë minutash.

2 Do bëjmë gjysmë ore pushim tani, mbase dhe 35 minuta. Do
3 të rikthehemi këtu në orën 11.30.

4 Mund të dilni tani nga sallë. Asistentja e sallës do t'ju
5 shoqërojë tani të dilni nga sallë. Mos flisni me askënd lidhur
6 me dëshminë tuaj këtu jashtë kësaj sale.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
9 ndërprerjen e seancës deri në orën 11.30.

10 --- Pauza fillon në orën 10.54

11 --- Seanca rifillon në orën 11.33

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
13 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Maloku,
16 tani, znj. Alagendra, që përfaqëson z. Krasniqi, do t'ju bëjë
17 disa pyetje. Dëgjojini me vëmendje.

18 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjesi, z. Maloku.

21 PË. Mirëmëngjesi.

22 PY. Unë quhem znj. Alagendra dhe përfaqësoj z. Jakup
23 Krasniqi.

24 PË. Faleminderit.

25 PY. Fillimisht dua t'ju bëj disa pyetje për kohën që keni

1 kaluar në Divjakë. Ju thatë që keni shkuar në Divjakë më 15
2 nëntor të 1998. Saktë?

3 PË. Po.

4 PY. A është e vërtetë që kur shkove në Divjakë rreth datës 15
5 nëntor të 1998-s, ka qenë vetëm një ndërtesë, shtëpia e bardh
6 siç e përshkruani ju dhe kanë qenë dhe dy ndërtesa tjera në të
7 njëjtin kompleks që përdoreshin për gjënë e gjallë dhe ato po
8 rinovoheshin, po rregulloheshin, saktë?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, a kam të drejtë unë kur them se ju personalisht, z.
11 Sali Veseli dhe Bislum Zyrapi fillimisht keni pas një zyrë në
12 shtëpinë e bardhë?

13 PË. Po. Unë e Salihu, po. Për Bislumin nuk më kujtohet në
14 cilën zyrë ka qenë.

15 PY. Më pas thatë që mes datës 18 dhe 27 nëntor 1998, pasi
16 morët detyrën e parë nga Bislum Zyrapi, ju nuk ishit më në
17 Divjakë, kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Më 28 nëntor morët pjesë në ceremoninë e Ditës së
20 Flamurit, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, vetëm pas datës 28 nëntor keni qenë ju në zyrat e
23 Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë, kështu?

24 PË. Po. Tani u rinovu një stallë edhe drejtoria operative
25 doli në atë shtëpi.

1 PY. Dhe meqë nuk keni qenë në Divjakë mes datës 18 dhe 28
2 nëntor të 1998, ju personalisht nuk keni nga ta dini se kush
3 ka qenë e kush nuk ka qenë atje, apo jo?

4 PË. Sigurisht.

5 PY. Por ju mund të flisni për Divjakën nga dhjetori i 1998
6 deri në janar të 1999 kur u larguat për të shkuar në zonën e
7 dukagjinit, saktë?

8 PË. Po. Po, saktë. Deri dikun ka 21 janari 22, 1999.

9 PY. Gjatë seancës përgatitore i keni thënë Prokurorisë dhe
10 këtë e thatë dhe të martën --

11 Z. PACE: [Përkthim] Dhe për palët po i referohem provës
12 P02091, Shënimi Përgatitor numër 1, paragrafët 5 dhe 7 dhe
13 është po ashtu në transkriptin e 25 marsit në faqen 96. Është
14 transkripti provizor ky.

15 PY. Pra, ju i thatë Prokurorisë se keni se, sipas jush,
16 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka filluar të jetë funksional
17 në dhjetor të 1998, saktë?

18 PË. Saktë.

19 PY. Të hënën kur thatë që Jakup Krasniqi ka qenë atje gjatë
20 gjithë kohës, ju e keni fjalën për Divjakën, apo jo?

21 PË. Po, për Divjakën e kam patur fjalën.

22 PY. Kur thoni që z. Krasniqi ka qenë atje gjatë gjithë kohës,
23 ju e keni fjalën që ai ka qenë në Divjakë në muajt dhjetor
24 1998, janar 1999, në të njëjtën periudhë kur keni qenë ju vetë
25 fizikisht atje, saktë?

1 PË. Po.

2 PY. Pas nëntorit të 1998-s, drejtoria operative përbëhej nga
3 ish-oficerë karriere, apo jo?

4 PË. Po. Sali Veseli ishte shef. Unë vartës i tij.

5 PY. Ju pajtoheni me mua që ekspertiza dhe njohuritë ushtarake
6 janë shumë të rëndësishme për të marrë vendime operative dhe
7 për të trajtuar aspektet ushtarake, përfshirë logjistikën, si
8 armatimet, municionet e gjëra të këtij lloji. A pajtoheni me
9 mua?

10 PË. Këto janë përgjegjësi e drejtorisë operative. Jo vetëm që
11 janë të asaj lamie, por kjo është përgjegjësi e vetëm
12 drejtorisë operative. Saktë.

13 PY. Në paragrafin 3 të Shënimit Përgatitor 2 - kur themi
14 "shënimi përgatitor", është raporti që ka përgatitur
15 Prokuroria pas seancës përgatitore javën e kaluar. Këtu thuhet
16 që ju keni thënë se:

17 "... ka pasur vetëm tre oficerë", mes të cilëve dhe ju
18 vetë, "që kishin kapacitetet dhe njohurinë profesionale dhe se
19 ishin të vetmit persona që dinin si ta organizonin Shtabin e
20 Përgjithshëm dhe si të shpërndanin përgjegjësitë në drejtori.
21 Pjesa tjetër e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së
22 nuk kishin dijeni apo formim ushtarak."

23 Saktë?

24 PË. Ashtu është. Kur thoni tre oficerë, i takon Bislim
25 Zyrapit, Sali Veseli dhe ju personalisht, për këta e keni

1 fjalën?

2 PË. Po. Në muajin dhjetor më duket erdhi edhe një Safet Sylja,
3 po ai merrej me ndërlidhjen, pra, me sistemin e ndërlidhjeve.
4 Ishte profesion shumë i ngushtë, mirëpo kishte akademinë
5 ushtarake adekuate për atë lami edhe mendoj që ka dhënë një
6 kontribut të jashtëzakonshëm në sistemin e ndërlidhjeve. Nuk
7 di sa e ka avancu, por ai ishte, ai kishte njohuri në atë lami
8 se ishte i atij profesioni.

9 PY. Faleminderit. Tani çështjet operative dhe ushtarake ishin
10 pjesë e kompetencës së drejtorisë operative sepse
11 profesionistët ushtarakë që punonin në këtë drejtori ishin
12 personat më të përshtatshëm për të ndihmuar zonat dhe njësitet
13 në terren, saktë?

14 PË. Saktë, drejtoria operative edhe shefi i shtabit. Këta
15 merren me strukturat organizative edhe me çështjet që kanë të
16 bëjnë me luftën.

17 PY. Në paragrafin 55 të Shënimit Përgatitor 2, sipas këtij
18 paragrafi ju keni thënë që sa herë që merrnit informata dhe
19 kërkesa prej njësiteve në terren, ju i zgjidhnit kërkesat me
20 aq sa mundnit vetë, saktë?

21 PË. Saktë. Më falni? Ato merreshin nga drejtoria operative.
22 Se ato, drejtoria operative kishte komunikim me zonat
23 operative. Dhe zonat operative i drejtoheshin drejtorisë
24 operative ose shefit të shtabit.

25 PY. Do t'ju lexoj paragrafin 55, këtu thuhet që i zgjidhnit

1 kërkesat që merrnit dhe ato që nuk i zgjidhnit dot ia thonit
2 Bislim Zyrapi që ta informonin kur të kthehej. Pra, zgjidhnit
3 ç'mundeshit vetë, ato që nuk i zgjidhnit dot vetë ia
4 raportonit Bislim Zyrapi kur të kthehej. Kjo ishte në
5 paragrafin 55 të Shënimit Përgatitor, saktë?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U përgjigjët,
7 Dëshmitar, se nuk morëm përgjigje?

8 DËSHMITARI: E saktë.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

10 PY. Ju po ashtu i thatë Prokurorisë se anëtarët e tjerë të
11 Shtabit të Përgjithshëm nuk kishin formim dhe dijeni
12 ushtarake. A është e vërtetë që Jakup Krasniqi është një prej
13 personave nuk kishte njohuri apo ekspertizë ushtarake sepse ai
14 përpara luftës ka qenë mësues historie?

15 PË. Jakup Krasniqi ishte zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës edhe ka mund me qenë shef i drejtorisë për informim në
17 Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

18 PY. Do flasim dhe për këtë. Të hënën ju thatë që dy muaj para
19 emërimit të tij në delegacionin e Rambujesë, detyrat e tij
20 kryesore kanë qenë detyrat e zëdhënësit të UÇK-së, përgjegjës
21 për informacion dhe media, kështu?

22 PË. E keni marrë pak gabim më duket. Unë e thashë vetëm dy
23 muaj e ka kry një funksion tjetër shtesë se funksionin bazë
24 për zëdhënës e ka pas tanë kohën prej që është lajmëru si
25 zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe është njëri i

1 parë që u dalë me emën, mbiemën në emër të Ushtrisë Çlirimtare
2 të Kosovës dhe deri në fund të luftë edhe mbas Rambujesë.
3 Jakup Krasniqi ka qenë vetëm zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare
4 të Kosovës. Për ata dy muaj, ai një pozicion shtesë -- unë e
5 kam spjegu për shkak të rregullave procedurale që ne mendonim,
6 oficerët, që duhen edhe ju ka dhënë atij për shkak që ishte
7 aty dhe e kam spjegu, do të thotë, për çfarë arsye e ka pas
8 atë funksion shtesë.

9 PY. Po. Ky ishte pozicioni i zëvendëskomandantit të cilin e
10 mbajti për ndihmë vetëm për dy muaj, apo jo?

11 PË. Vetëm dy muaj. Po.

12 PY. Ju e bëtë shumë të qartë që ky pozicion ishte një
13 pozicion dytësor për të sepse detyrat dhe fokusi kryesor i z.
14 Jakup Krasniqi nuk ndryshoi gjatë kësaj kohe, ai vazhdoi ta
15 ushtronte detyrën e tij si zëdhënës i UÇK-së, apo jo?

16 PË. Sigurisht.

17 PY. Pajtoheni me mua besoj që një nga detyrat apo objektivat
18 e UÇK-së ishte ta prezantonte UÇK-në si një strukturë të
19 rregullt dhe të organizuar mirë, apo jo?

20 PË. Po, sigurisht. Po ne në atë kohë ishte misioni vëzhgues
21 ndërkombëtar që ishte me mision nga Këshilli i Sigurimit të
22 Kombeve të Bashkuara. Komunikonin me neve. Pra, ne ishim
23 avancu, ne ishim pranë edhe në nivel ndërkombëtar që ishim një
24 ushtri e cila monitorohej tani nga faktori ndërkombëtar.

25 PY. Pra, synimi ishte që t'i jepej atyre përshtypja që UÇK-ja

1 është një ushtri e rregullt sepse ju duhej mbështetja
2 ndërkombëtare, të jepej një imazh i UÇK-së si një ushtri e
3 rregullt, apo jo?
4 PË. Por çdo zëdhënës, çdo drejtori informative e ka atë
5 detyrë në secilën ushtri, për me ngrit imazhin e asaj ushtrie
6 në botë. Ky është misioni bazë i propagandës në luftë, që
7 është një prej armëve kryesore, kryesore në luftë është. Është
8 pjesë e luftës. Dhe ajo ishte pjesë e jona.

9 Unë muj me thënë vlerësimin tim personal që z. Krasniqi
10 nuk e ka kry sa duhet një detyrë të tillë për shkak se u dasht
11 të mbahen briefingje me gazetarë nja tri herë në javë. Ne ishim
12 të njohur, ishin vëzhguesit ndërkombëtarë, do duhej ma tepër
13 në atë punë, po kjo është vlerësimi i imi, do të thotë, që ka
14 pas mangësi.

15 Përndryshe kjo ka qenë detyrë e z. Krasniqi. Dhe detyrë e
16 tij ka qenë, unë e kam spjegu dhe dje, detyrë e tij ka qenë
17 ngritja e qendrave për informim të Ushtrisë Çlirimtare të
18 Kosovës që i kemi pas ato. Pra, i ka ngritë vetë Krasniqi në
19 Gjenevë, Berlin, Vjenë, Paris, Londër edhe Uashington, duke
20 përfshi edhe Prishtinën edhe Tiranën. Në Prishtinë e kemi pas
21 zyrën për informim edhe në Tiranë ka qenë Zyra për Informim e
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pra, kjo ka qenë puna e tij.
23 Nuk ka punë tjetër.

24 Nuk ka punë më të rëndësishme gati në një luftë sesa
25 informimi, sesa propaganda. Ajo është armë shumë e fuqishme

1 PY. Ditën e hënë --

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe për palët në faqen e
3 transkriptit provizor 25749 të datës 24 mars.

4 PY. Ju keni thënë që në një ushtri të rregullt duhet të ketë
5 një pozicion të lartë, pra, si shefi i shtabit për të
6 vendosur për komandantët e brigadave ë zonë. Dhe ju thatë që
7 "ne krijuam dhe një pozicion edhe mbi shefin e shtabit për ta
8 plotësuar këtë vakancë".

9 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

10 PË. Po, po. Po. Më lëni t'ju sqaroj. Ne i krijuam dy
11 pozicione, dy zëvendëskomandantë. Njëni, 11-shi, që pastaj unë
12 e kam dit që është Sokol Bashota pas lufte, ai e kishte, do të
13 thotë, detyrën me vëzhguesit ndërkombëtarë, komunikimi,
14 ndërmjetësin në mes të përfaqësuesve të misionëve vëzhguese me
15 shefin e shtabit. Dhe një pozicion ishte z. Krasniqi për shkak
16 se emnimin e zonave, e komandantëve të zonave operative duhej
17 bërë një pozicion m i lartë sesa shefi i shtabit. Pra,
18 komandanti -- shefi i shtabit e propozon komandantin e zonës
19 operative pozitës më të naltë që ai për me e emnue me urdhën
20 atë.

21 Pra, ne mundoheshim, mundoheshim që një ushtri vullnetare
22 me e bë të rregullt. Dhe unë po e përsëris prapë para jush
23 edhe kësaj Gjykate, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë
24 ushtri e rregullt vullnetare. Në historinë e luftërave që unë
25 i kam mësu edhe në akademi ushtarake, nuk ka një rast të

1 tillë, që një popull me e ngrit për 14 muaj një ushtri të
2 rregullt vullnetare nëpër strukturat e të cilës kalojnë 60.000
3 ushtarë. Pra, nuk keni pas. Gjykata, këto gjykata në Hagë nuk
4 kanë pas një rast të tillë dhe nuk e besoj që kanë me pas. Nuk
5 kishim mundësi me pas institucione se përndryshe z. Krasniqi
6 s' ishte marrë me nënshkrimin e atyne urdhnave. Po t'i kishim
7 pas ne, për shembull, komandantin suprem, komandantin e
8 përgjithshëm, ligjet, Ministrinë e Mbrojtjes dhe po qe se
9 Ushtria Çlirimtare e Kosovë ishte hy në kornizat e
10 institucioneve shtetnore të Kosovës. Kjo.

11 PY. Pra, ju po na thoni në thelb që ky pozicion u krijua
12 thjesht për të formalizuar propozimet dhe vendimet që merrnin
13 të tjerët, konkretisht shefi i shtabit ose drejtoria operative
14 për të nënshkruar dokumentet me shkrim, apo jo?

15 PË. Drejtoria operative i drejtohet, do të thotë, shefit të
16 shtabit. Në raste të veçanta kur ishin raportet e mbledhjeve
17 të Shtabit të Përgjithshëm që ishte edhe shefi i shtabit pjesë
18 e atij shtabi, na nuk mundeshim në aspektin procedural që atë
19 raport nga ajo mbledhje me ia dhënë shefit të shtabit. Por sa
20 kujtoj unë, i jepej raporti, i bëhej përmbledhja e asaj çka
21 kishte ndodhë në atë mbledhje edhe me nënshkrimin e shefit të
22 drejtorisë operative, Sali Veseli, i cili faktikisht i vetmi
23 ka pas të drejtë me nënshkru dokumente që dalin nga drejtoria
24 operative. Keni parasysh? Dhe ai ia drejtojke, do të thotë, z.
25 Krasniqi. E si raport, si informim se çka ka ndodhë në atë

1 mbledhje. Për atë --

2 PY. Po do flasim.

3 PË. -- e di vetëm në një mbledhje. Ajo e dyta që ka ndodh
4 mbasi në janar nuk kam qenë, do të thotë, aty kur u bë raporti
5 nga ajo mbledhje.

6 PY. Do flasim për raportin, z. Maloku. Po unë po përpqem
7 t'ju bëj këtë pyetje. Kur bëhet fjalë për pozicionin e
8 zëvendës komandantit dhe se pse u krijua është kjo, z.

9 Krasniqi ishte zëvendës komandant për mbështetje, apo jo?

10 PË. Zëvendëskomandant, më duket, zëvendëskomandant i Shtabit
11 i Përgjithshëm. Dy ishin. Po. Dy.

12 PY. Mirë atëherë. Po.

13 PË. Se nuk ishte z. Krasniqi --

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran --

15 DËSHMITARI: Nuk ishte z. Krasniqi në logjistikë për
16 mbështetje. Ishte zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po. Do t'ju tregoj një
18 dokument, z. Maloku. Do shohim një dokument. Shohim në ekran
19 materialin 4D00011.

20 PY. Mendohet që ky është një procesverbal i një mbledhje të
21 Shtabit të Përgjithshëm më 12 nëntor të 1998. Në krye thuhet:

22 "Në këtë mbledhje u bë ristrukturimi organizativ i SHP-së
23 të UÇK-së."

24 E shihni fjalinë e parë fare?

25 PË. Po.

1 PY. Struktura e re ka vetëm një komandant dhe dy
2 zëvendëskomandantë, siç na e shpjeguat dhe ju, një për
3 aspektet operative dhe një për suport, për mbështetje. Kështu
4 thotë ky dokument, për mbështetje? E shihni?

5 PË. Po.

6 PY. Në mes të faqes pika e tretë shohim:

7 "Jakup Krasniqi - Zëvendëskomandant për mbështetje."

8 Pika e tretë nga poshtë.

9 "Jakup Krasniqi - Zëvendëskomandant për mbështetje."

10 E shihni?

11 PË. Po, po shof.

12 PY. Pra, kur thoni që pozicioni i zëvendëskomandantit u
13 krijua për të nënshkruar dokumentet me shkrim kjo ishte
14 thjesht --

15 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Ku e ka thënë dëshmitari
16 se këtë e tha vetëm avokatja?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem ku e
18 ka thënë dëshmitari këtë?

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po e bëj si pyetje atëherë.

20 PY. A është e vërtetë që ky pozicion, pra, pozicioni i
21 zëvendëskomandantit u krijua thjesht për të formalizuar me
22 shkrim vendimet apo propozimet që merreshin, për shembull, nga
23 shefi i shtabit?

24 PË. Po, s'ka tjetër.

25 PY. Dhe z. Krasniqi u zgjodh për këtë rol. Dhe, siç na thatë

1 të hënën, ai ishte prezantuar me emër dhe mbiemër. Pra, ai u
2 zgjodh me këtë emër, besoj pajtoheni me mua, se a ai njihej me
3 emër dhe me mbiemër? Të gjithë të tjerët e kishin nga një
4 pseudonim. Pajtoheni me mua?

5 PË. Ky është i pari që është prezantuar në muajin qershor 1998
6 me emër, mbiemër si zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë.
7 Aty në drejtori operative kemi pas, kanë qenë në Shtab të
8 Përgjithshëm janë dalë pastaj me emna. O dit Ramë Bujë, janë
9 dit të tjerët. Po kur flas për z. Krasniqi, kur është dalë
10 herën e parë, herën e parë kur është prezantuar si zëdhënës i
11 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

12 PY. Po. Dje në transkriptin provizor ju thatë që:

13 "U përpoqëm të krijojmë rend dhe rregulla njësoj si ato
14 që ndiqen në një ushtri të rregullt."

15 Dhe më tej kur folët për z. Krasniqi ju thatë kështu dhe
16 po e lexoj:

17 "... mendoj asokohe se Jakup Krasniqi do të kishte dhe
18 rolin e zëvendëskomandantit që do të emëronte apo pushonte nga
19 puna komandantët e zonave. Sepse komandantët e zonave
20 operative duhet të emëroheshin apo zëvendësoheshin vetëm me
21 propozim të shefit të shtabit, njësoj siç ndodhi me mua.

22 "Këtë jemi përpjekur të bëjmë ne sepse Ushtria Çlirimtare
23 e Kosovës nuk ekzistonte si institucion apo brenda
24 institucioneve."

25 Pra, a pajtoheni me mua që këto masa apo këto veprime

1 janë kryer nga persona me përvojë dhe me njohuri ushtarake?

2 Siç thatë ju janë ju janë përpjekur të vendosin masa të tilla,

3 kështu?

4 PË. Po. Po. Z. Sali Veseli që ishte i zoti i kësaj pune edhe

5 Bislir Zyrapi, pra, janë përpjekjet tona për me kriju një

6 pasqyrë të një ushtrie të rregullt. Pra, janë përpjekje. Ne

7 kemi konstituuar Shtabin e Përgjithshëm, sipas meje, në dhjetor

8 dhe ato janë përpjekje tani. Nuk mundet për njëherë të

9 funksionon mbrenda një dite. Sot konstituohet Shtabi i

10 Përgjithshëm dhe nesër është çdo gjë funksionale si një ushtri

11 që ka përvojë 100 vjet. A kuptoni? Mendoj që këtu duhet të

12 keni parasysh të gjithën.

13 PY. Mirë. Po në realitet, z. Maloku, nuk kishte komandantë

14 zonash të zëvendësuar apo të shkarkuar gjatë dy muajve kur z.

15 Krasniqi ishte në komandë - më fal - që ishte

16 zëvendëskomandant për mbështetje, kështu?

17 PË. Nuk di a ka pas emërime me shkrim të komandantëve të

18 zonave, por pavarësisht asaj, duhet me u kriju si t'i kem

19 shtatë zona operative edhe mos me pas një nevojë të tillë, ajo

20 duhet me ekzistuar një pozicion i tillë edhe po të mos kishte

21 fare do të thotë. E di që, më duket në prill, u bë ndërrimi i

22 një komandanti të zonës operative Ekrem Rexha, Drini, është

23 zëvendësuar me Tahir Sinanin, sa kam unë njohuri. Po atëherë,

24 sa di unë, z. Krasniqi ka qenë në Rambuje.

25 PY. Dua të kalojmë tani tek dëshmia që keni dhënë këtu në

1 sallë - është në faqen 85 të transkriptit të përkohshëm - që
2 urdhri i parë dhe i vetëm që keni marrë nga Shtabi i
3 Përgjithshëm është kur ju ka transferuar nga drejtoria
4 operative në zonën operative të Dukagjinit. Ju kujtohet që e
5 thatë këtë?

6 PË. Po. Saktë është.

7 PY. Dje na thatë se ju pyetën nëse donit të shkonit në Zonën
8 Operative të Dukagjinit pas një kërkesë nga z. Ramush
9 Haradinaj, kështu?

10 PË. Po, ashtu.

11 PY. Dhe në intervistën që keni dhënë në vitin 2019 - me numër
12 reference P2090.2 në faqen 12 - ju thatë se:

13 "... me kërkesë të komandantit të zonës operative jam
14 kalu në, pra, Zonës Operative të Dukagjinit, kam kaluar aty me
15 pëlqimin tim - jam lëndu aty - ndërkohë që ndihmoja Zonën
16 Operative të Dukagjinit."

17 Kjo është në intervistën tuaj të vitit 2019. Ju kujtohet
18 që keni thënë kështu?

19 PË. Ashtu është. Edhe po jua sqaroj. Nuk ka mujt me më lëvizë
20 z. Krasniqi për pa pëlqimin tim. Për shkak se, kuptoni, unë
21 isha vullnetar dhe vullnetarët në ushtritë vullnetare nuk
22 lëvizën dhe nuk avancohen do gjëra për pa pëlqimin e personit.
23 Unë jam ftu. Mu kanë thënë që, "Komandanti i Zonës Operative
24 të Dukagjinit po kërkon që ti të transferohesh atje për
25 ndihmë. A pajtohesh?". Pra, është dasht me u marrë pëlqimi im.

1 Po të kisha thënë unë jo, unë kisha mbet q'aty ku isha. Kjo

2 është. A jam i qartë? Unë mendoj jam i qartë, apo?

3 PY. Po. Dhe kjo ka ndodhur në praninë e z. Haradinaj sipas

4 dëshmisë tuaj, apo jo?

5 PË. Po, po, sigurisht.

6 PY. Në seancën përgatitore që keni bërë me Prokurorin javën

7 që shkoi, paragrafi 21 i Shënimit Përgatitor numër 1, thuhet

8 se e kishit informuar z. Haradinaj se nuk e kishit marrë veten

9 plotësisht dhe z. Haradinaj ju kishte thënë që nuk priste prej

10 jush që të përfshiheshit drejtpërdrejt në veprimtari luftarake

11 Dhe se ju do të ishit i dobishëm dhe duke qenë prej zonës së

12 Dukagjinit dhe njiheshit atje, kështu?

13 PË. Po. Ishim prezent aty tre. Ishte z. Haradinaj në zyrën e

14 z. Krasniqi dhe unë. Ia shpjegova z. Haradinaj gjendjen time

15 që nuk mund të jem shumë aktiv në operacione luftarake atje

16 dhe ai tha ato fjalë. Pra, këto ishin bisedat për pëlqimin

17 tim, apo jo, për t'u transferuar nga drejtoria operative e

18 Shtabit të Përgjithshëm në Zonën operative të Dukagjinit.

19 Është e saktë.

20 PY. Po kështu këtu thuhet se keni thënë që e dhatë pëlqimin

21 tuaj për transferimin dhe në një moment të mëpasshëm Krasniqi

22 dërgoi një ushtar për t'i shkuar atij në zyrë. I shkuaat në

23 zyrë Krasniqit dhe Krasniqi ju dha urdhrin për transferimin.

24 Pra, dokumenti me shkrim ju ka ardh në një moment të

25 mëpasshëm, kështu?

1 PË. Një ditë pas atij takimi. Po, një ditë pas dhënies së
2 pëlqimit tim.

3 PY. Po. Dokumenti që keni marrë ishte thjesht zyrtarizim i
4 asaj për të cilën kishit dhënë pëlqim z. Haradinaj një ditë më
5 parë, apo jo?

6 PË. Po, ishte ai pëlqimi.

7 PY. Më herët sot dhe në intervistën e vitit 2019, keni dhënë
8 dëshmi për disa raporte me shkrim të cilat janë përpiluar në
9 bazë të informacioneve që drejtoria operative kishte marrë nga
10 zonat dhe ishin dy mbledhje informuese me zonat, në bazë të
11 këtyre u krijuan këto raporte, një në dhjetor të vitit 1998
12 dhe tjetra në janar të 1999, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe sipas dëshmisë suaj, këto dy raporte u përpiluan dhe
15 i janë dhënë z. Krasniqi për t'u përdorur në sektorin
16 logjistik, kështu thatë në intervistën e vitit 2019 Pjesa 5,
17 faqja 3. Kështu?

18 PË. Unë e di vetëm për raport e parë të mbledhjes së parë, të
19 dytën jo se unë kam shku të nesërmen, jam largu nga Shtabi i
20 Përgjithshëm, nga drejtoria operative dhe ai raport pastaj
21 është bërë disa ditë më vonë është hartu, janë përpilu. Ato
22 ishin kërkesa të zonave operative për logjistikë, ishin
23 njoftime për numrin e ushtarëve, për numrin e të lëndumve, do
24 të thotë, për pajisje me pajisjet e spitaleve që ishin nëpër
25 zona.

1 Ne në fillim kishim edhe trajtimin sekondar edhe terciar.
2 Por ma vonë kur u rëndu situata në pranverën e vitit 1999,
3 flas tash për Dukagjinin, duhet t'i transportonim për trajtim
4 sekondar dhe terciar jashtë Kosovës. Pra, këto ishin ato
5 problematika të cilat i shprehshin komandantët e zonave në atë
6 mbledhje, ato kërkesa. Dhe ne ato i bënim raport dhe ju
7 dërgojke, do të thotë, komandantit, zëvendëskomandantit.
8 PY. Në Pjesën 3, në faqen 6 të intervistën të vitit 2019,
9 keni thënë:

10 "E pastaj nuk e di se kujt ia jepte Jakup Krasniqi ..."

11 Mund ta konfirmoni? Mund ta konfirmoni, megjithëse para
12 se të vijojmë me këtë. Ju keni thënë:

13 "... mbase mendoj ia jepte shefit të shërbimit logjistik
14 në Tiranë."

15 Ju kujtohet që e keni thënë kështu në vitin 2019?

16 PË. Po ashtu kishte me qenë logjike. Unë nuk e di ku pastaj
17 kanë shku ato dokumente. Unë e di vetëm që ato janë -- ai
18 dokument, flasim për një, se të dytin nga mbledhja me
19 komandantë të zonëve nuk kam qenë unë. Po ato Sali Veseli i ka
20 nënshkru, i ka lexu dhe i ka procedue, ku kanë shku ato pasta
21 dhe në cilët sektorë janë marrë me ato problematika, unë nuk e
22 di.

23 PY. Sa u takon përmbajtjes së raportit apo raporteve ju sapo
24 shpjeguat se çfarë përmbanin. Është e saktë që ky raport, se
25 veç për një folët, nuk përmbante asnjë informacion për

1 arrestime, ndalime apo keqtrajtime të civilëve, kështu?

2 PË. Jo, në këto raporte nuk ka pas. Nuk ka pas raportime të
3 tilla nga komandantët e zonave, nuk ka pas raportime as në
4 raportime ditore. Në muajin dhjetor jemi përpjekë me instalu
5 një linjë komunikimi që më pas komunikim ditor me marrë
6 informacione vetëm çka i takojnë drejtorisë operative, pra,
7 për lëvizjet e forcave të armikut, angazhimet ushtarake ose
8 përplasjet luftarake nëpër zona operative në cilat brigada, në
9 cilat zona, humbjet e pjesëve të territorit, për shembull, që
10 ishin në kontroll të brigadave të ndonjë fshati apo marrja
11 pastaj, numri i ushtarëve të vramë, të plagosur që e kishim,
12 pra, humbjet, humbjet në teknikë, humbjet që pretendoheshin,
13 pretendonin zonat operative që ju kanë shkaktu armikut në
14 teknikë, në njerëz edhe në gjëra tjera materiale.

15 Po këto i merrnin ne këto informacione dhe mund t'ju them
16 që nuk kishim mundësi me i verifiku që a janë të sakta a jo.
17 Ne ato i merrshim dhe i dërgonim në dhomën operative të cilën
18 e ngritëm, dhomën operative, afër drejtorisë operative, harta
19 topografike e Kosovës në një tavolinë të madhe dhe i vendosnim
20 ato të dhëna që na vijshin në atë hartë për të përcjellë, do
21 të thotë edhe zhvillimet luftarake në terren. Edhe në bazë të
22 informacioneve që ne i merrshim për lëvizje të forcat serbe
23 dhe kapacitetit të tyre ne mundoheshim në operativë me
24 parashiku se ku mendon armiku me sulmu ditët në vijim.

25 Pra, mundoheshim të parashikojmë në bazë të përvojave që

1 kishim si oficerë me parashiku dhe me i paralajmëru pastaj
2 zonat operative, brigadat, se brigadat kanë qenë njësitë
3 themelore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë qenë lokale.
4 Ne nuk kemi pas njësi më të mëdha sesa brigadat. Se në ushtri
5 tjera ka brigada, regjimente, divizione, korparmata. Pra, ka
6 qenë, brigada ka qenë njësia themelore e Ushtrisë Çlirimtare
7 të Kosovës në krejt kohën e luftimeve.

8 Pra, ne mundoheshim që në bazë të atyne informacioneve në
9 hartë dhe me u mundu me parashiku se cila brigada do të
10 atakohet në ditët që vijnë, që vijojnë. Po. kjo ishte ajo puna
11 e drejtorisë operative që bëhej ato dy muaj sa isha, një muaj
12 e gjysë në fakt, tash sa isha aty.

13 PY. Faleminderit. Do të kaloj në një temë tjetër. Thatë më
14 herët që z. Krasniqi ishte shef i drejtorisë së informimit,
15 kështu?

16 PË. Po ashtu ish dashtë të jetë, do të thotë, jo vetëm
17 zëdhënës, po pse për shkak se ishin ngritë edhe qendrat e
18 informimit në shtetet që thashë e ishin zëvendësuar atje,
19 atëherë logjikisht, unë këtë e them në bazë të logjikës time,
20 që ish dashtë të ngritët nga zëdhënës ose në shef të një
21 drejtorie për informim që kish dashtë të ketë, të zhvillohet
22 ajo drejtori. Keni parasysh? Ne e kemi fillu, do të thotë,
23 Shtabin e Përgjithshëm dhe tash duhet të avancohet, ish dashtë
24 të avancohet në një drejtori dhe me një staf pak më të gjerë
25 që merret me informimin, me propagandën, me të gjitha këto

1 pra. Është logjika ime. Jo që unë i kam pa ato.

2 PY. Po. Pra, kjo ishte logjika juaj, mendoni ju se duhet të
3 ishte kështu duke pasur parasysh rolin që ai luante si
4 zëdhënës.

5 Tani nëse mund t'ju kthej prapë tek dokumenti që është në
6 ekran. Pika e fundit ka një listë emrash në mes të faqesh me
7 pozitat. E shihni? Ka një listë emrash me pozitat.

8 PË. Po.

9 PY. Dhe i fundit thotë:

10 "Berat Luzha - përgjegjës shtypi e radio."

11 Kështu?

12 PË. Po, ne e ngritëm edhe radion. Po. Ai ishte përgjegjës për
13 radion.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Dua të kalojmë në seancë
15 private, ju lutem.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
17 seancës, na kaloni në seancë private, ju lutem.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 66

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 67

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

24 jemi në seancë publike.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të

1 vazhdoni, znj. Alagendra.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. Po kaloj në një temë tjetër, është tema e komunikatave,
4 z. Maloku.

5 Në intervistën e tij me Prokurorinë, Bislim Zyrapi, ish-
6 shef i shtabit, ka thënë se nuk e dinte se kush i shkruante
7 këto komunikata se nuk hynte tek përgjegjësia e tij kjo gjë.
8 Ju nuk keni asnjë arsye për ta kundërshtuar për ta
9 kundërshtuar këtë, do të kishit arsye?

10 PË. Jo, nuk kam arsye. Unë vetëm e thashë vlerësimin tim. Se
11 kur ka ardh Misioni Vëzhgues Ndërkombëtar në Kosovë nuk ka pas
12 nevojë më për komunikata, ka pas nevojë për brifingje,
13 konferenca për shtyp, tri herë në javë së paku me gazetarë të
14 huaj me të gjithë, se ne dihej kush ishim, ishim ushtri që në
15 pozicione, kishim shtatë zona operative. Bashkëluftëtarët e mi
16 që më ndëgjojnë tash edhe në këtë seancë publike e dinë që një
17 farë aeroplani që e kishte një farë zhurme, ne e dijshim që ai
18 është aeroplan që fotografon, nuk kishim kurrgjë fshehtësi
19 s'kishte. Në fakt, do të thotë edhe duhej komunikimi të jetë i
20 hapur. Kjo është kjo logjika ime do të thotë.

21 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. Më
22 duket se ka një gabim në transkript në rreshtin 24 të faqes
23 63. Thotë "Kur Misioni Ndërkombëtar erdhi në Shqipëri". Besoj
24 duhet të jetë "në Kosovë".

25 DËSHMITARI: Po, në Kosovë. Po, më falni.

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 70

1 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. Z. Maloku, ju vetë personalisht nuk e dinit se kush i
3 shkruante këto komunikata?

4 PË. Jo.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju kërkoj të kalojmë prapë
6 në seancë private, të nderuar Gjykatës. Ka të bëjë me disa
7 dokumente që Prokuroria ia ka treguar dëshmitarit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
9 kalojmë në seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 71

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 72

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 73

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 74

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra

Faqe 75

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 Faleminderit.

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mirë.

23 PY. Flasim për takimin e Bellanicës. Fshati Bellanicë është

24 shumë afër fshatit, ju kërkojmë ndjesë për shqiptimin sipas

25 Avokates, Muçat, Mucap.

1 PË. Është afër fshatit Ngucat.

2 PY. Ngucat.

3 PË. Mes fshatit Ngucat edhe Lladroviq. Është fshatrat më të
4 afërt, ata më të afërt me të Bellanicës. Pastaj është Seniku
5 edhe Lladrovci, ku unë i kam dajët. Po.

6 PY. Ju i thatë Prokurorit se keni pasur të afërm nga ana e
7 nënës në fshatin Bellanicë, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Ke shkuar në një takim në Bellanicë sepse kishe kushërinj
10 në Bellanicë, këtë e ke thënë gjatë seancës përgatitore e
11 reflektuar kjo në paragrafin 6, kështu?

12 PË. Jo, pak më ndryshe është. Unë e kam spjegu qartë. Dhe,
13 znj. Avokate, unë e kam dhënë një dëshmi nën betim me gjykatë
14 në Gjakovë që është bë për këtë rast. Unë kam dhënë edhe atje
15 dëshmi. Dhe më vjen shumë keq që -- gjykimi ka qenë publik,
16 por unë këto ditë kam hy në rrjetet *Google* dhe Betimi për
17 Drejtësi dhe kam gjet që vetëm dy-tri fjalë të mia janë
18 publiku aty.

19 Pra, ai takim është mbajtur, në muajin dhjetor është ndërru
20 komandanti i brigadës. Është zëvendësu me zëvendësin e
21 komandantit të brigadës. Dhe komandanti i ri i brigadës ka
22 mbajtur takim, ka organizu takim me fshatarët dhe me njësitin e
23 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Bellanicë.

24 Dhe në atë takim e kam shoqëru edhe unë. Pra, ka qenë
25 komandanti brigadës, shefi i shtabit të brigadës edhe unë kam

1 qenë shoqërues. Pra, mbledhjen e ka thirr komandanti brigadës
2 dhe e ka organizu me shefin e shtabit të brigadës. Unë jam lut
3 që për shkak të lidhjeve, për shkak të njohurive që kam, për
4 shkak që më njohin shumë ajo anë që të shkoj edhe unë t'i
5 shoqëroj këta dy atje. Kjo është ajo e vërteta që ka ndodhë. E
6 kam spjegu edhe në Lubjanë, edhe këtu, edhe në gjykatë në
7 Gjakovë edhe, me ju thënë të drejtën, që dhjetë vite jam shumë
8 i rëndum me këtë çështje. A po më kuptoni? Se ka ndodhë ai
9 rast kishte ndodhë tre muaj para se të mbahet ajo mbledhje,
10 pra, ai tubim, pra, tre muaj përpara. Kur kishte ndodhë rasti
11 unë isha i plagosun dhe i strehum në fshatin Sedllar, komuna e
12 Lipjanit. Pra edhe unë kam qellu vetëm si shoqërues i
13 komandantit të brigadës edhe shefit të shtabit të brigadës.
14 PY. Jo, unë thjesht doja të thoja që ishit ju personi që
15 kërkuat personi që kërkuat vetë të shkonit vetë me ta, kështu,
16 ju kërkuat vetë që të shkonit, apo jo?
17 PË. Jo. Jo. Si duket komandanti i brigadës i cili edhe ai
18 ishte një lidhje e largët mes përmes nënës time, pak ma e
19 largët, si duket ka ardh -- se shtabi i brigadës ishte afër
20 ndërtesës së Shtabit të Përgjithshëm, e ka lut ndoshta z.
21 Krasniqi që me marrë pjesë edhe unë. Z. Krasniqi më tha, "A po
22 shkon? Ndoshta kishte qenë mirë me shku atje se ty të njohin".
23 Dhe kjo ka qenë ajo.

24 Mu më kanë marrë ata me kerrin e tyne, me automjetin e
25 tyne edhe kemi shku në atë tubim në Bellanicë ku kanë qenë

1 prezent nja 5, 600 qytetarë të Bellanicës dhe asaj ane.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
3 126097 deri në 126100. Shqipja është 126097-126100. Në të dy
4 dokumentet do të doja që të shfaqej faqja 126098. Në mes të
5 faqes tek anglishtja është disa rreshta mbi -- është paragrafi
6 i madh në mes.

7 PY. Po filloj ta lexoj: "Për shkak të popullaritetit tim mes
8 personave ...". E gjeni dot në shqip? "Për shkak se njihesha
9 me personave ...". Këtu ku thuhet "Gjatë kohës në Shtabin e
10 Përgjithshëm ...". "Gjatë kohës time në Shtabin e Përgjithshëm
11 ...".

12 E shihni, z. Maloku? Kjo është dëshmia juaj.

13 PË. Po, po.

14 PY. Në mes të paragrafit thuhet:

15 "Gjatë kësaj kohe Shtabi i Përgjithshëm, brigadat, zonat
16 operative u ristrukturuan dhe komandanti i Brigadës 121 i cili
17 ishte emëruar në muajin dhjetor të 1998 dhe shefi i shtabit të
18 brigadës, Shaban Dragaj kanë mbajtur një takim me popullatën.
19 Dhe për shkak se te autoriteti që unë kam pasur, pasi unë jam
20 nip i asaj zone, unë jam lutur që t'i shoqëroj në atë takim."

21 E patë, e gjetët në paragraf?

22 PË. Po.

23 PY. Kjo ka qenë dëshmia juaj në Gjykatën Themelore të
24 Gjakovës, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Në 16 janar të 2018?

2 PË. Po.

3 PY. Në intervistën e 2019-s me Prokurorinë ju keni thënë --

4 PË. Më falni vetëm --

5 PY. -- atje që keni shkuar si --

6 PË. Vetëm një sqarim këtu. Këtu thotë nuk është e vërtetë që
7 këtu kam thënë unë, unë në atë takim kam kuptuar për vrasjen e
8 këtyre, do të thotë, ai ka qenë rast që unë që është fol,
9 është fol shumë herë.

10 PY. Po nuk na intereson kjo fjali.

11 PË. Ani në rregull.

12 PY. Nuk na intereson.

13 PË. Në rregull. Po nuk është dëshmia ime e saktë e qitun
14 këtu. A më kupton? Se ne një fjalë mundet me ndryshu shumëçka.
15 Po urdhnoni.

16 PY. Tek pjesa e dytë e intervistës së 2019-s me Prokurorinë
17 këtu -- po më ndiqni, z. Maloku?

18 PË. Po. Po.

19 PY. Pra, në 2019-n me intervistën me Prokurorinë Pjesa 2,
20 keni thënë se nuk i keni raportuar askujt në Shtabin e
21 Përgjithshëm lidhur me atë që ndodhi në takimin e Bellanicës
22 apo atë çka dëgjuar në këtë takim. Kjo është e saktë, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit, z. Maloku. Nuk kam më pyetje të tjera për
25 ju.

1 PË. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
3 znj. Alagendra.

4 Ka Prokurori pyetje plotësuese?

5 Z. PACE: [Përkthim] Po.

6 Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani, ju lutem.

7 Pyetje vijuese nga z. Pace:

8 Z. PACE: [Përkthim]

9 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Kam dhe disa pyetje plotësuese për
10 ju.

11 Gjatë pyetjeve dje, ju dhatë dëshmi lidhur me faktin a
12 keni pasur komandant përpara nëntorit 1998.

13 Z. PACE: [Përkthim] Për palët në sallën e gjyqit, po i
14 referohem faqes 25848, rreshtat 2 deri në 5.

15 Do të doja që të shfaqej në ekran tani dokumenti
16 P02090.2-ET dhe -AT. Janë në listën tonë të materialeve. Dhe
17 dua të shohim faqen 10 në të dyja versionet.

18 PY. Dëshmitar, do nxjerr një pjesë të intervistës për
19 Prokurorinë. Do ju lexoj një pjesë dhe pastaj do t'ju bëj
20 pyetjet.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faqet 10 në të dyja versionet. Në
22 anglisht do lexoj rreshtat 3 deri në 11, shqipja duhet të jetë
23 rreshti 3 deri në 10.

24 PY. "Dhe në mes të qershorit, Sali Veseli erdhi nga Gjermania
25 dhe ne ngritëm një nënzonë operacionale dhe njësi informacioni

1 ishte si një brigadë. Ne kishim 1500 ushtarë të armatosur. Nga
2 fshati Jasim Gjotl, nga fshatrat Jasic dhe Gjotl, mbi Junik,
3 deri në Cabrat pranë Gjakovës. Të gjithë këta fshatra ranë nën
4 kontrollin tonë në atë kohë. Ata u bënë pjesë e zonës sonë të
5 kontrollit.

6 "Sali Veseli u bë komandanti i nënzonës operationale dhe
7 i brigadës dhe unë u bëra zëvendëskomandant. Këtë pozicion e
8 mbajta deri më 25 korrik."

9 Dëshmitar, a ju kujtohet sa kohë pasi mbërriti Sali
10 Veseli u bëtë ju zëvendëskomandant?

11 PË. Z. Prokuror, ju ma keni prezantu këto edhe dokumentin që
12 unë e shifsha për herë të parë të takimit në Dobrosh, diku ka
13 16, 17, 20, 15 qershor 1998 me komandantët e shtabeve të 20
14 fshatrave, pra, të Junikut dhe 19 fshatareve. A është e saktë
15 kjo? Ma keni prezantu? Po.

16 Pra, në atë takim, pra, z. Sali Veseli që në Kosovë
17 kishte hy nga fundi i majit u bë, me pëlqimin e të gjithë
18 komandantëve të fshatrave, 20 fshatrave, u bë komandant i
19 brigadës. Ndërsa unë, me pëlqimin e komandantëve të 20
20 fshatrave, të shtabeve të 20 fshatrave, u bëna
21 zëvendëskomandant.

22 Nuk e kam mashtru as z. Misetic, por edhe këtij i kam
23 tregu se si u ngrit Ushtria çlirimtare e Kosovës.

24 Pra, unë prej që hyra, ishte, kur hyra unë ishte vetëm
25 një shtab, e kishte Smolica shtabin. Këto tjera fshatra jo. A

1 më kupton? Nuk janë dallu këto kurrgjë --

2 PY. Dëshmitar. Dëshmitar, po dilni përtej pyetjes sime. Ju
3 lutem ndërprisni.

4 PË. Mirë.

5 PY. Po kaloni përtej asaj që ju pyetja unë. Ju bëra një
6 pyetje shumë të thjeshtë. E mora përgjigjen tuaj. Pra, a është
7 e saktë, siç keni thënë në intervistë që keni qenë
8 zëvendëskomandanti i Sali Veselit deri në momentin që jeni
9 plagosur më 25 korrik të 1998-s? Po apo jo?

10 PË. Jo. Unë kam qenë zëvendëskomandant i Aziz Hysenit edhe
11 këtë e kemi sqaru në fazën përgatitore. Kur ka ardh Aziz
12 Hyseni dikun fillimi i muajit korrik, ka ardh Aziz Hyseni me
13 Kamer Elezin dhe një toger finlandez që ka ardh vullnetar dhe
14 e kemi lënë me njësitin Luani në Morinë. Pra, u bë pastaj Aziz
15 Hyseni komandant brigade, unë zëvendës.

16 PY. Dhe më pas ju ishit zëvendësi i Aziz Hysenit, pra, deri
17 kur u plagosët më 25 korrik?

18 PË. Po, po. Po, e kemi sqaru bashkë.

19 PY. Në rregull.

20 PË. E kemi sqaru bashkë.

21 PY. Po, po.

22 PË. E kemi sqaru bashkë.

23 PY. Dakord. Sidoqoftë unë duhet ta bëjë pyetjen duhet t'i
24 përgjigjeni pyetjes sime.

25 Z. PACE: [Përkthim] Do e heqim dokumentin nga ekrani.

1 PY. Dje gjatë kundërpjetjeve nga Ekipet e Mbrojtjes, ju thatë
2 nga prilli i 1998-s deri në plagosjen tuaj në korrik të 1998-
3 s, Ramush Haradinaj nuk kishte asnjë autoritet, asnjë
4 autoritet përkundrejt jush përveç se kishit respekt të
5 ndërsjellë dhe nuk ka lëshuar asnjë urdhër për ju. Këtë e keni
6 thënë dje në transkript faqja 25848, rreshtat 6 deri në 11.

7 PY. Dëshmitar, pra, e kuptoj unë drejt kur keni thënë ju që
8 Ramush Haradinaj nuk ka lëshuar asnjë urdhër për mua
9 specifikisht në prill të 1998 deri në korrik të 1998, e kam
10 kuptuar drejt, për ju e kishit fjalën si person?

11 PË. Po, drejt. Po, drejt.

12 PY. Mesa dini ju gjatë kësaj periudhe kohore, pra, prill-
13 korrik i 1998, Ramush Haradinaj a ka lëshuar urdhra për
14 persona të tjerë në zonën tuaj të përgjegjësisë në Dukagjin
15 pra?

16 PË. Jo në -- jo për brigadën të cilën unë e kam qenë
17 zëvendëskomandant por një javë pasi është ndërtu shtabi i
18 brigadës në Junik, Sali Veseli ka kalue në Gllogjan. Aty ishte
19 Gllogjani dhe 40 fshatra që i kishin 40 shtabe të fshatrave.
20 Ka shku për me ndërtu tash komandën e zonës jo operative, po e
21 kemi quajt zona e rajonit të Dukagjinit.

22 Menduam me Sali Veselin, në fakt, ai ishte kryesori që
23 mendoj Gllogjanin me e bë shtabin e zonës operative se për
24 shkak se ishte në mes të territorit që ne që kontrollohej nga
25 këto 60 fshatra. Pra, 20 të brigadës së Junikut dhe 40 që

1 ishin rreth Gllogjanit.

2 Z. PACE: [Përkthim] Dua të nxjerrim në ekran materialin
3 P02092 dhe P02092-ET. Janë në prova që u pranuan ditën e hënë.
4 Mund t'i gjeni në listën origjinale të ZPS-së. Dhe do të doja
5 të shihnim faqen e dytë në të dyja versionet.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të pyes Prokurorin, se thotë
7 Prokurori lista origjinale. Keni listë tjetër? Se s'kemi marrë
8 dokumente të reje.

9 Z. PACE: [Përkthim] Jo, jo, është gabim formulimi. Një
10 listë kemi.

11 PY. Dëshmitar, kur ju bënë pyetje të hënën, ju dhatë dëshmi
12 për këtë faqen që shohim ne në ekran.

13 Z. PACE: [Përkthim] E zvogëlojmë që ta shohim të plotë
14 faqen.

15 PY. Dhe ju thatë që është lëshuar nga komandanti i brigadës,
16 Sali Veseli dhe ju e njohët dhe nënshkrimin e tij në këtë
17 faqe.

18 Z. PACE: [Përkthim] Kjo është thënë në transkriptin e
19 ditës përkatëse.

20 Tani dua që zmadhojmë pak gjysmën e sipërme të dokumentit
21 në të dyja versionet. Edhe pak më shumë. Mjafton. Në shqip
22 mjafton. Ju lutem të njëjtën gjë edhe në anglisht.

23 PY. Do t'ju lexoj një pjesë dhe pastaj do t'ju bëj një
24 pyetje.

25 "Në bazë të rrethanave luftarake në zonë e përgjegjësisë

1 luftarake, si dhe në bazë të Urdhëresës së Komandantit të
2 Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit me qëllim të
3 organizimit, ristrukturimit, rritjes së gatishmërisë,
4 bashkëkoordinimit dhe bashkëveprimit si dhe masave të sigurisë
5 për popullsinë e pambrojtur:

6 "Urdhëroj

7 "1. Në zonën e përgjegjësisë sime ndalohet qarkullimi i
8 luftëtarëve, eprorëve dhe popullsisë pa lejen e komandantit të
9 Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe lejen time personale të
10 cilën e lejon komandanti i shtabit të fshatit."

11 Tani, Dëshmitar, siç e pamë dhe siç folëm dhe të hënën,
12 dokumenti ka datën 15 qershor 1998. Unë kam këtë pyetje
13 atëherë: Kush ka qenë komandanti i Zonës Operative të
14 Dukagjinit në atë kohë, në këtë periudhë?

15 PË. Dëgjoni, ju kam thënë, z. Prokuror, shumë i nderuar edhe
16 në Lubjanë --

17 PY. Dëshmitar, ju lutem, përgjigjuni një pyetjeje kaq të
18 thjeshtë. Kush ka qenë komandant i shtabit të Zonës Operative
19 të Dukagjinit? Ose më thuaj emrin ose më thuaj s'e di? Pyetja
20 është e thjeshtë.

21 PË. Nuk e di se është mendu me u ndërtu Zona Operative e
22 Dukagjinit. Sali Veseli e ka mendu dhe ka shku mbas një ore
23 për me -- mbas një jave për me ngritë. Pra, është mendu mu
24 ndërtu Zona Operative e Dukagjinit. Dhe unë nuk e di kush ka
25 qenë atëherë. Ky e ka lëshu këtë urdhër me e lënë aty që kur

1 të shkon atje me e pas urdhnin knej veç të gatshëm. Ne e kemi

2 --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

4 DËSHMITARI: Po.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

6 përpiquuni t'i përgjigjeni pyetjes, se po jepni informacione

7 shitesë. Thjesht përgjigjuni pyetjes. Është një pyetje e

8 thjeshtë. Në fakt ju u përgjigjët. Nuk keni nevojë të shtoni

9 më gjë.

10 Z. PACE: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, do vazhdojmë tani. Gjatë kundërpvetjeve dje,

12 ju bënë pyetje për organizimin e Shtabit të Përgjithshëm të

13 UÇK-së dhe ju u përgjigjët, që sipas jush, Shtabi i

14 Përgjithshëm i UÇK-së mund të referohet, pra, mund t'i

15 referohesh si Shtabi i Përgjithshëm që nga dhjetori i 1998-s.

16 PË. Po.

17 Z. PACE: [Përkthim] I referohem transkriptit të ditës së

18 djeshme faqet 25854, rreshtat 10 deri 22.

19 Tani dua të heqim këtë dokument nga ekrani dhe të

20 vendosim në ekran provën materiale me numër P02090.3-ET dhe -

21 AT. Në anglisht shohim faqen 20 dhe do lexoj rreshtat dhe do

22 lexoj rreshtat 9 deri në 16. Ndërsa në shqip do lexoj nga

23 rreshtat 8 deri në 15.

24 PY. Dëshmitar, në të majtë është shqipja është intervista me

25 Prokurorinë në 2019. Po ju lexoj pyetje-përgjigje dhe pastaj

1 do t'ju bëj një pyetje unë.

2 "PY. Dhe në këtë kohë Zona Operative e Dukagjinit i
3 raportonte drejtpërdrejt Shtabit të Përgjithshëm?

4 "PË. Jo.

5 "PY. Kur --

6 "PË. Deri kur bëra unë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm
7 më 15 nëntor nuk e kam idenë sesi kanë funksionuar gjërat --

8 "PY. Por të paktën --

9 "PË. -- të organizuara."

10 Dëshmitar, unë kam këtë pyetje: Siç keni thënë këtu ju a
11 është e saktë, që deri në momentin që u bëtë anëtar i Shtabit
12 të Përgjithshëm më 15 nëntor të 1998 ju nuk e keni pasur idenë
13 sesi ishin organizuar gjërat në Shtabin e Përgjithshëm?

14 PË. Ashtu është.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani
16 dhe do shohim diçka tjetër.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, besoj
18 duhet të shohim, po shoh pushimin dhe e kemi dhe të shkurtuar
19 pushimin e drekës.

20 Z. PACE: [Përkthim] Unë kam dhe një temë tjetër për të
21 mbuluar. Pesë minuta më duhen.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do jua japim
23 prapë një orë pushim sidoqoftë.

24 Z. PACE: [Përkthim]

25 PY. Gjatë pyetjeve dje, ju thatë kështu, që është në

1 transkriptin e djeshëm.

2 "Kosova ka qenë shënjestra e një lufte speciale. Armiqtë
3 u përpoqën që të bënin një luftë speciale që prej krijimit të
4 UÇK-së në 1992. Shërbimi sekret serb në mënyrë të vazhdueshme
5 u përpoq të bënte përçarje dhe të krijonte konflikte brenda
6 radhëve të UÇK-së. Po ka ardhur nga elementë të jashtëm kjo.
7 Kjo ishte një luftë speciale."

8 Dëshmitar, unë kam këtë pyetje tani: A ju kujtohet që
9 ndonjë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të ketë diskutuar
10 ndonjëherë për konceptin e një lufte speciale në 1998-n ose në
11 1999-n?

12 PË. Jo. Kjo vlerësim i imi personal. Na kemi fol kështu me
13 Bislir Zyrapi qysh në Tiranë edhe Agim Ramadanin, por ky
14 vlerësim i imi personal.

15 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua që të vendosim në ekran
16 provën P01288 dhe do të shohim segmentin kohor 09:10-10:17 me
17 zë. Kam edhe titrat për këtë në anglisht. Nuk është nevoja që
18 të vendosim përkthimin në anglishte. Por për procesverbal, po
19 i referohem provës P01288-ET, po përkrah videos të vendosim
20 transkriptin në shqip P1288-AT dhe të zmadhojmë ju lutem
21 paragrafin në krye të faqes 2. Është një incizimi i shkurtër
22 dhe më pas do t'ua lexoj unë transkriptin dhe do t'ju bëj disa
23 pyetje.

24 PY. Dëshmitar, do shihni dhe do dëgjoni një video. Mund ta
25 dëgjoni në shqip kuptohet. Dhe mund ta ndiqni edhe në

1 transkript nëse dëshironi në moment që është në ekranin tuaj.

2 Z. PACE: [Përkthim] Duhet të kalojmë tek faqja e dytë e
3 transkriptit në shqip edhe të zmadhojmë paragrafin lart në
4 krye të faqes dhe ju lutem shfaqni përbri edhe videon. Pra,
5 nga minuta 9:10 deri në minutën 10:17.

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi me shumë fronte,
8 secili më egër se tjetri, secili më finok se tjetri. Luftoi
9 kundër një makinerie të tërë ushtarake propagandistike,
10 përballoi ofensiva ushtarake të papara pas Luftës së Dytë
11 Botërore në Kosovë, përballoi një luftë speciale të koordinuar
12 nga jashtë dhe brenda dhe eci pandalshëm përpara. Dhe çuditën
13 miqtë dhe armiqtë me mbijetesën e Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës, me gatishmërinë dhe vendosmërinë e saj luftarake.
15 Qëllimi u armiqtë të të gjitha ngjyrave ishte zhdukja e UÇK-
16 së, eliminimi i saj nga jeta politike që pastaj Kosovës t'i
17 imponohet një zgjedhje e parëndësishme, mjerake, pacifiste apo
18 gandiste."

19 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Mjafton. E ndalojmë
20 këtu.

21 PY. Dëshmitar, kush ishte personi që po fliste në këtë
22 incizim që sapo pamë?

23 PË. Ishte z. Krasniqi.

24 PY. Jemi tek minuta 10:17. Kë shihni ju në ekran ose na thoni
25 kush është z. Krasniqi nga këta?

1 PË. Jakup Krasniqi është ky që po flet.

2 PY. Është personi që ka një letër në dorë dhe që është pas
3 podiumit?

4 PË. Po.

5 PY. A e njihni personin në të majtë të z. Jakup Krasniqi,
6 personin e parë?

7 PË. Është babai i një dëshmori.

8 PY. Po personi tjetër në të majtë kush është?

9 PË. Është Fatmir Limaj.

10 PY. Po në të majtë të Fatmir Limajt kush është?

11 PË. Jam unë vetë.

12 PY. Dhe në të majtën tuaj?

13 PË. Musë Jashari, Musa Jashari.

14 PY. A ju kujtohet kush ka qenë tjetër i pranishëm në këtë
15 ngjarje?

16 PË. Ka qenë edhe Ramë Buja edhe --

17 PY. Për çfarë rasti ka qenë ky, me ç'rast u bë kjo?

18 PË. Kjo u bë me festimin e Ditës së Flamurit, 28 nëntori.

19 PY. Në cilin vit?

20 PË. 1998.

21 PY. Do t'ju lexoj një tekst dhe do t'ju bëj një pyetje.

22 Z. PACE: [Përkthim] Shumë shkurt, i nderuar Kryegjykatës.

23 PY. Ne dëgjuaam Jakup Krasniqin që tha:

24 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi me shumë fronte,
25 secili më egër se tjetri, secili më finok se tjetri. Luftoi

1 kundër një makinerie të tërë ushtarake propagandistike,
2 përballoi ofensiva ushtarake të papara pas Luftës së Dytë
3 Botërore në Kosovë, përballoi një luftë speciale të koordinuar
4 nga jashtë dhe brenda dhe eci pandalshëm përpara. Dhe çuditën
5 miqtë dhe armiqtë me mbijetesën e Ushtrisë Çlirimtare të
6 Kosovës, me gatishmërinë dhe vendosmërinë e saj luftarake.
7 Qëllimi u armiqve të të gjitha ngjyrave ishte zhdukja e UÇK-
8 së, eliminimi i saj nga jeta politike, që pastaj Kosovës t'i
9 imponohet një zgjedhje e parëndësishme, mjerake, pacifiste apo
10 gandiste."

11 Dëshmitar, unë kam këtë pyetje.

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kemi kundërshtim. Kjo nuk
13 lidhet me kundërpyetjet.

14 Z. PACE: [Përkthim] Nuk është jashtë kuadrit të
15 kundërpyetjeve. Dëshmitari foli për luftën speciale.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
17 kundërshtimi.

18 Vazhdoni.

19 Z. PACE: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, po e filloj dhe një herë pyetjen. Në 1998 ose
21 1999 ju personalisht a keni dëgjuar ndonjëherë që të jetë
22 përshkruar politika e Ibrahim Rugovës si një politikë
23 pacifiste?

24 PË. Po, ajo ka qenë politikë, unë e thashë për z. Rugova. Z.
25 Rugova ka qenë lideri shpirtëror i shqiptarëve që ka pas

1 pacifizmin, paqen, ideologji edhe veprim. Nuk ka kurrgjë këtu.

2 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

3 PË. Po, po.

4 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

5 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje tjera, të nderuar
6 Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Do bëjmë pushimin tani të drekës. Një orë.

9 DËSHMITARI: Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një orë do ta
11 bëjmë këtë pushim të drekës duke pasur parasysh edhe kohën për
12 ju. Do të rikthehemi në orën 2.15 këtu në sallë. Në orën 2.15.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
15 ndërprerjen e seancës deri në orën 2.15.

16 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.11

17 --- Seanca rifillon në orën 14.15

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duket se do
19 të na duhet që të jemi këtu deri të martën. Duhet të jemi këtu
20 të martën se nuk kemi ende një përgjigje nga vendi ku ai
21 banon, nëse do të dëshmojë apo jo deri në momentin që do
22 fillojë. Por nëse nuk do të ketë dëshmi prej tij, ai do jetë
23 edhe fundi i punimeve për atë ditë.

24 Më vjen keq nëse nuk, nëse nuk ju sjell probleme kjo gjë
25 -- nëse s'është problem kjo gjë - më falni.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon planeve të udhëtimit,
2 nëse Trupi Gjykses ka ndërmend që të bëjë ndonjë konferencë
3 për ecurinë e çështjes javës tjetër, mund të na e thoni që të
4 bëjmë plane përkatëse.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
6 [Përkthim] Do të pres -- do të presim deri më datë 15 në
7 momentin kur Prokuroria do të jetë në gjendje që të mbyllë
8 paraqitjen e provave dhe vetëm atëherë mund të fillojmë që të
9 flasim për plane të tjera.

10 Ndonjë pyetje lidhur me këtë? Në rregull. Faleminderit.

11 Fusni dëshmitarin në sallë, ju lutem.

12 Do të vazhdojmë deri në orën 14.30 dhe atëherë do të
13 bëjmë një pushim të shkurtër -- ndjesë, deri në 15.30 do bëjmë
14 një pushim të shkurtër dhe pastaj do të vazhdojmë derisa të
15 përfundojmë.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Maloku,
18 tani do të ketë disa pyetje nga Gjykatësi, duke filluar me
19 Gjykatësin Barthe, i cili është në të majtën time, në të
20 djathtën tuaj. Gjykatësi Barthe është i pari që do të bëjë
21 pyetje.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
23 Smith.

24 Pyetje nga Trupi Gjykses:

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Maloku.

1 PË. Mirëdita, faleminderit.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Anëtarët e Trupit Gjykses
3 kanë disa pyetje të tjera. Do t'ju tregojmë disa dokumente
4 nëse mund të thoni diçka për to dhe çfarë mund të thoni dhe të
5 na i vendosni në kontekst.

6 I lutem Sekretarit të seancës që të sjellë provën e parë
7 materiale në ekran që është 099990-099990-ET së bashku me
8 versionin përkatës në shqip. Faleminderit.

9 Z. Maloku, në këtë dokument në anglisht thuhet:

10 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës

11 "Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit --

12 "24 qershor '98.

13 "Urdhër për shtabet e lokaliteteve dhe popullatën e
14 Rrafshit të Dukagjinit

15 "Në bazë të rrethanave luftarake në Rrafshin e
16 Dukagjinit, me qëllim të përballimit me sukses të operacioneve
17 luftarake, lëshoj këtë:

18 "Urdhëresë

19 "1. Në rajonin e përgjegjësisë së Shtabit Operativ të
20 Rrafshit të Dukagjinit të bëhet mobilizimi i përgjithshëm i
21 potencialit njerëzor dhe material.

22 "2. Të kryhet përgatitja e popullsisë, luftëtarëve dhe
23 eprorëve për nevojat e luftës.

24 "3. Të bëhet evidentimi i luftëtarëve më të aftë dhe i
25 atyre me karakter të veçantë për nevojën e luftës.

1 "4. Të merren masa për të ndaluar çdo veprimtari kundër
2 luftës sonë."

3 Po e kaloj pikën 5 dhe 6 [Sipas përkthimit] dhe do
4 vazhdoj me pikën 7 [Sipas përkthimit]:

5 "Të merren masa të menjëhershme izolimi, çarmatimi,
6 burgimi dhe për këtë të raportohet në Shtabin Operativ të
7 Rrafshit të Dukagjinit, gjegjësisht në Shtabin Qendror të
8 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës."

9 Dhe për kryerjen e kësaj urdhërese janë përgjegjës veç e
10 veç komandantët e shtabeve lokale të nënzonave dhe vetë
11 Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit."

12 Dërguar arkivës - dhe siç lexon në anglisht, RRDOZ - pra,
13 - më falni - i dërgohet arkivës, shtabeve të rajonit të
14 përgjegjësisë së SHORD-së dhe shikojmë që komandant me emër
15 mbiemër dhe nënshkrimin, Ramush Haradinaj.

16 Pikë së pari, z. Maloku, t'ju bëj këtë pyetje: Këtë
17 dokument e keni para më përpara? Mjafton të përgjigjeni me
18 "po" ose "jo" ose nuk e di.

19 PË. Jo, zotëri.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A e dini nëse
21 ka pasur një thirrje të përgjithshme për mobilizim të njerëzve
22 dhe të materialeve në zonën e rrafshit të Dukagjinit në
23 qershor të vitit '98?

24 PË. Për këtë thirrje s'e di, por në brigadën ku unë isha
25 zëvendëskomandant tash në atë kohë, ne i kemi pas të gjitha

1 shtabet e fshatrave të mobolizum, nuk ka pas nevojë më s'kem
2 pas më mundësi me mobilizu ndonjë ushtar, me ardh ndonjë
3 ushtar. S'kishim as kapacitete për të pranë vullnetarë më.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kuptoj. Po të shihni
5 pjesën e poshtme djathtas të dokumentin; e shihni nënshkrimin?
6 PË. Po, e shoh.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E njihni atë nënshkrim?
8 PË. Ky është nënshkrimi -- po thotë Ramush Haradinaj, por me
9 ju tregu të drejtën nuk jam grafolog vetë edhe por të më
10 kishte ardh ky dokument e kisha pranë si nënshkrimin e tij,
11 por s'është vula e -- nuk e besoj që ai ka dhënë nënshkrime pa
12 vulën e zonës operative të Dukagjinit, nëse është krijuar
13 atëherë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në fakt e
15 thatë edhe më herët sot këtë gjë.

16 Z. Maloku, a do të kishit arsye për të besuar se ky nuk
17 është nënshkrimi i Ramush Haradinajt?

18 PË. Kjo është tash një pyetje diskutabile. Kisha vetëm, po, e
19 kisha gjet një arsye në pikën 6. Nuk kemi pas infrastrukturë
20 në atë kohë për ndalimin, izolimin, burgimin. Pra, nuk ka pas
21 infrastrukturë të tillë. Në -- nuk kemi pas në brigadën të
22 cilën unë kam qenë zëvendëskomandant.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj këtë, z. Maloku.
24 Por pyetja ime ishte disi ndryshe. Unë ju pyeta vetëm për
25 nënshkrimin. Pyetja ka të bëjë për nënshkrimin, po ju pyes

1 prapë: Keni ndonjë arsye për të besuar se ky nënshkrim nuk
2 është i Ramush Haradinajt? Nuk po flas për përmbajtjen e
3 dokumentit. Nisur jo nga përmbajtja; thjesht nisur vetëm nga
4 nënshkrimi.

5 PË. Jo, por unë duhet me u bazu - më falni, zotni - unë duhet
6 me u bazu në përmbajtjes. Nëse nuk kemi një infrastrukturë të
7 tillë qysh me u dhonë ky urdhër pastaj. Pra, kjo kishte me më
8 qit në dyshim. Nëse nuk ekziston, a vërtetë nuk ka ekzistuar
9 infrastruktura për të izolu njerëz, burgos njerëz në atë
10 territor ku unë kam qenë, kjo kishte me më dhënë -- një bazë
11 për me dyshu, një bazë. Se qysh i jepet urdhër dikujt kur nuk
12 është infrastruktura?

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dua të kaloj
14 tani, ju lutem, në një dokument tjetër, prova me numër IT-04-
15 84 P00168, në anglisht dhe në shqip, ju lutem. Faleminderit.
16 Në këtë dokument thuhet - në anglisht po e lexoj siç është:

17 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës

18 "Komanda Operative e Rrafshit të Dukagjinit

19 "Dukagjin

20 "5 korrik 1998

21 "Sekret shtetëror"

22 Thotë:

23 "Emërim në detyrë zëvendëskomandant të shtabit operativ
24 të Rrafshit të Dukagjinit

25 "Sipas rrethanave luftarake me qëllim të udhëheqjes dhe

1 komandimit të mirëfilltë dhe rritjes së gatishmërisë luftarake
2 nën nënzonën operative urdhëroj si vijon:

3 "1. Lahi -- shkarkohet Lahi Brahimaj nga shërbimi, pra,
4 nga detyra e zëvendëskomandantit të Shtabit Operativ të
5 Rrafshit të Dukagjinit dhe emërohet Nazmi Brahimaj si
6 zëvendëskomandant në vendin e tij."

7 "2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

8 "I dërgohet arkivës, Lahi Brahimajt, Nazmi Brahimajt."

9 Dhe pastaj po të shohim më poshtë në pjesën e djathtë
10 poshtë thotë, "Komandant," nënshkruar nga Ramush Haradinaj.

11 Pyetja ime, z. Maloku, është, a e keni parë më përpara
12 këtë dokument, z. Maloku?

13 PË. Jo, z. Gjykatës.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me nënshkrimin, a na
15 ndihmoni dot?

16 PË. Është nënshkrimi i Ramushit nuk -- duhet me e krahasu me
17 atë tjetrin. Tash unë s'po di. Nuk -- është dokument të cilin
18 unë s'e kam pa, z. Gjykatës.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj --

20 PË. I njoh këta edhe Lahi Brahimin edhe Nazmi Brahimin kishte
21 me qenë njëfarë lidhje që ka mund me ndodhë kjo, por unë këtë
22 dokument s'e kam pa, z. Gjykatës, as nuk e di këtë ngjarje.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] T'ju pyes, një pyetje, z.
24 Maloku. A është e vërtetë, me aq sa dini ju, që Lahi Brahimaj
25 është zëvendësuar nga Nazmi Brahimaj si zëvendëskomandant i

1 shtabit operativ të Rrafshit të Dukagjinit në korrik të vitit
2 '98?

3 PË. Unë e kam sqaruar se Sali Veseli pas ngritjes së brigadës
4 të Junikut ka shku për të ndërtu zonën operative të Dukagjinit
5 me seli në Gllogjan. E tash çfarë ndërmarrjeve kanë marrë ata
6 vërtet nuk muj me -- kush ka qenë ku dhe si janë ndërru. Nuk
7 kisha mujt me dhënë këtu ndonjë -- shpjegim. Më vjen keq.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pa problem. Z. Maloku, a e
9 dini nëse Lahi Brahimaj kishte ndonjë nofkë gjatë luftës?

10 PË. Më duket e ka pas Magjupi. Nuk jam fort i sigurt.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se ku ishin të
12 vendosur gjatë luftës Lahi dhe Nazmi Brahimaj?

13 PË. Ata kanë qenë në Jabllanicë ose Gllogjan. Ajo ana andej.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe kishin lidhje
15 farefisnore me njëri-tjetrin? Nëse po, çfarë lidhje?

16 PË. Lahiu edhe Nazmiu ishin vllazën, sa di unë. Ata të dy
17 ishin dajat e Ramushit -- po, dajat e Ramushit ishin, po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, faleminderit.
19 Dëshiroj tani që të nxjerrim një dokument tjetër me numër
20 prove IT-04-84bis P00248 në anglisht dhe në shqip, të dy, ju
21 lutem.

22 Z. Maloku, ky dokument thotë:

23 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës

24 "Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit

25 "Dukagjin

1 "12 korrik 1998

2 "Formimi i brigadave dhe emërimi i eprorëve në detyra të
3 komandantëve të batalionit dhe brigadës

4 "Komandës së Brigadës së 2-të

5 "Në bazë të Rregullores Luftarake të Shtabit të
6 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rrethanave
7 luftarake në sektorin N/O/D/14.05, për shkak të rritjes së
8 njësisë të Ushtrisë Çlirimtare dhe me qëllim të udhëheqjes dhe
9 komandimit, subordinimit, koordinimit dhe bashkëveprimit në
10 kryerjen e operacioneve luftarake në sektorin e lartpërmendur:

11 "Urdhëroj

12 "1. Në sektorin e përgjegjësisë së Shtabit Operativ të
13 Rrafshit të Dukagjinit të formohen brigadat e caktuara.

14 "2. Në Brigadën e 2-të emërtoj eprorin Shemsedin Çeku si
15 komandant të brigadës, ndërsa në formacionet e komandantëve të
16 batalioneve të kësaj brigade emërtoj..."

17 Dhe ajo që vijon është shefi i shtabit, komandanti i
18 batalionit të 1-rë, 2-të e të 3-të dhe emri i përgjegjësit të
19 artilerisë, komandantit të artilerisë dhe pastaj vijon që
20 thotë:

21 "Zbatimi i këtij urdhri i ngarkohet komandantit të
22 Brigadës [Sipas përkthimit] në përputhje me strukturën."

23 Po, ju kërkoj ndjesë. Faleminderit.

24 Dhe pastaj thotë në fund:

25 "Arkivës

1 "Komandës së Brigadës së 2-të

2 "Eprorit Shemsedin Cekaj."

3 Dhe në të djathtë, "Komandant Ramush Haradinaj," dhe me
4 shkrim është nënshkrimi.

5 Z. Maloku, e keni parë më përpara këtë dokument?

6 PË. Jo, z. Gjykatës.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse një urdhëresë
8 e tillë, pra, një urdhër i tillë është lëshuar nga Ramush
9 Haradinaj më datë 12 korrik të vitit 1998?

10 PË. Jo, z. Gjykatës.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e njihni rregulloren
12 luftarake të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të cituar në
13 paragrafin hyrës të këtij urdhri?

14 Nëse mund ta ngremë pakëz lart dokumentin. Faleminderit.

15 PË. Jo, z. Gjykatës.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk e njihni
17 rregulloren luftarake?

18 PË. Nuk e kam parë, z. Gjykatës, në atë kohë as pastaj.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nënshkrimin në pjesën e
20 poshtme, a e njihni?

21 PË. Është i njëjtë si të tjerët, por i njoh këta emrat këtu
22 që janë emëru, i njoh të gjithë, i kam njohtë. Vetëm këtë,
23 këta të dy poshtë, jo, Sylë Shabani dhe Shemsedin Fetahaj. E
24 njoh Shaban Dragaj, Musa Gjakova, Driton Zeneli, po këta dy
25 poshtë, jo.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në lidhje me personat emrat
2 e të cilëve ju i njihni, a përputhet me pozitat që janë të
3 shënuara aty, asokohe, në momentin me aq sa dini ju?
4 PË. Po këta dy të parë janë oficerë karriere. Edhe i kam njoh
5 të dytë. Logjikisht, këto pozita kanë qenë dedikuese për ta,
6 po, në bazë të njohurive, në bazë të profesionalizimit të tyre
7 dhe akademive të cilat ata i kanë kry.
8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju po flisni për emrin e
9 parë, Shemsedin Ceku --
10 PË. Jo, jo. Shaban Dragaj dhe Musa Gjakova.
11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, ju kuptova.
12 Faleminderit. Z. Dragaj, ishte vërtet shef shtabi i Brigadës
13 së 2-të?
14 PË. Nuk e di për atë, por që pastaj ka qenë shef Brigade 121
15 në Pashtrik, po.
16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E dini nëse z. Gjakova ishte
17 komandant i Batalionit të 1-rë?
18 PË. Jo, për atë, por e di që Musa Gjakova ka qenë një kohë të
19 gjatë në luftë në Dukagjin dhe është plagos aty.
20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Duhet të
21 nxjerrim dokumentin tjetër në ekran, ju lutem me numër IT-04-
22 84 P0199. Në anglisht edhe në shqip, ju lutem. Faleminderit.
23 Në këtë dokument thuhet:
24 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës
25 "Shtabi operativ i Rrafshit të Dukagjinit

1 "Dukagjin
2 "12 korrik 1998."
3 Në të djathtë thotë:
4 "Sekret shtetëror
5 "Formimi i brigadave dhe emërtimi i eprorëve në detyra të
6 komandantëve të batalionit dhe brigadës
7 "I dedikohet: Komandës së Brigadës së Parë
8 "Në bazë të Rregullores Luftarake të Shtabit të
9 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rrethanave
10 luftarake në sektorin N/O/D/14,05, për shkak të rritjes së
11 njësive të Ushtrisë Çlirimtare, me qëllim të udhëheqjes dhe
12 komandimit, subordinimit, koordinimit dhe bashkëveprimit në
13 sektorin e lartpërmendur si dhe udhëheqjeve të operacioneve
14 luftarake
15 "Urdhëroj
16 "Të krijohen brigadat e mëposhtme në zonën e
17 përgjegjësisë së Rrafshit të Dukagjinit..."
18 Ju lutem, edhe në shqip që të paraqitet dokumenti.
19 "Në Brigadën e Parë emërtoj eprorin Tahir Zemaj për
20 komandant të brigadës, ndërsa në formacion komandantët e
21 batalionit të kësaj brigade emërtoj..."
22 Dhe aty janë emrat e kryeshefit të brigadës, komandantit
23 të batalionit të 1-rë, të 2-të dhe të 3-të dhe emri të
24 kryeshefit të artilerisë.
25 Pjesë tjetër të dokumentit nuk po e lexoj. Dua t'ju

1 tregoj nënshkrimin në pjesën e poshtme djathtas dhe faktin që
2 kopjet i janë dërguar arkivës, komandës së Brigadës së 1-rë
3 dhe eprorit Tahir Zemaj.

4 Z. Maloku, e njëjta pyetje: Jeni në dijeni që është dhënë
5 një urdhër i tillë më 12 korrik të vitit '98?

6 PË. Jo, z. Gjykatës. Jam në dijeni që është bërë inkorporimi
7 i oficerëve që erdhën me Tahir Zemajn me oficerët dhe stafin e
8 mëparshëm të zonës operative të Dukagjinit. Këtë e kemi dëgju
9 kështu, se unë jam -- unë isha tërë kohën në Junik.

10 I njoh këta, disa prej këtyre emrave. Kemal Shaqiri,
11 Ismet Ibishi, Fadil Hadërgjonaj edhe normalisht e kam njoh
12 eprorin Tahir Zemaj.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këta persona që ju i njihni
14 që i njihni nga kjo listë, a ishin aktiv në zonën operative të
15 Dukagjinit?

16 PË. Po ata kanë ardh me luftu. Kemal Shaqirin e kam njoft
17 prej Zagrepit; Ismet Ibishin nga Postojan, ka qenë oficer
18 atje, kur unë isha oficer; Fadil Hadërgjonaj nuk di ku ka
19 shërby dhe çfarë akademie ushtarake ka kry, por e di që ka
20 qenë epror ushtarak profesionist; Tahir Zemaj ka qenë oficer
21 madhor, akademinë ushtarake të kryer në Zar.

22 Ne vetëm kemi dëgju që janë inkorporu, do të thotë janë
23 bashku edhe ka fillu zhvillimi i brigadave. Këtej kemi qenë të
24 njoftum, për si ka shku procesi dhe këto dokumente nuk i kam
25 parë, z. Gjykatës.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

2 Dokumenti tjetër që dua t'ju tregoj mban numrin U001-3408
3 deri në U001-3409 në anglisht, në shqip, në anglisht dhe në
4 shqip, ju lutem. Faleminderit.

5 Z. Maloku, dua t'ju kërkoj që të përqendroheni në
6 paragrafin e parë që thotë:

7 "Më 11 korrik 1998, Vesel Lekaj nga Lumbardhi nuk ka
8 pranuar që të jetë anëtar i UÇK-së. Ai edhe më tutje i mbron
9 ngjyrat e LDK-së, agjiton kundër ushtrisë, bashkëpunon me
10 rrymat e errëta që 9 vite kundër progresit të popullit të vet;
11 është spiun i hapt i Fatmir Sejdisë, Sekretari i Përgjithshëm
12 i LDK-së."

13 Kjo besoj duhet të mjaftojë.

14 Z. Maloku, i njihni ju këta dy persona, domethënë, Vesel
15 Lekaj dhe Fatmir Sejdia?

16 PË. Veselin nuk e kam njohur, as s'e njoh nëse është gjallë
17 tani. Fatmir Sejdiu ka qenë presidenti i Kosovës pas Ibrahim
18 Rugovës.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Të shohim
20 faqen e dytë të dokumentit me numër 13409 [Sipas përkthimit].

21 Z. Maloku, paragrafi i parë thotë kështu:

22 "Gjatë kohës kur Sali Veseli erdhi me punë dyditore me
23 punë në Gllogjan, Naim Maloku me disa oficerë të Rekës së Keqe
24 e kishin mbajtur në mbledhje kundër UÇK-së, pra, në përkrahje
25 të njerëzve të qeverisë. Sali Veseli ia tërhoqi vërejtjen

1 Tahir Zemajt për këto veprime të oficerëve të vet që gjenden
2 në zonën e Junikut.”

3 Pyetja që kam për ju z. Maloku është kjo: A ju kujtohet
4 të keni bërë një takim të tillë me oficerë nga Reka e Keqe?
5 PË. Nuk më kujtohet që kam bërë ndonjë mbledhje kundër UÇK-së
6 kur vetë kam qenë pjesë e ngritjes së saj, dhe më lejoni të
7 them z. Gjykatës se kjo s’po përputhet me urdhrat e mëparshëm
8 kur krejt këta oficerë që ishin ardh me Tahir Zemën ishin
9 inkorporu në zonën operative të Dukagjinit. Po vjen vërtet
10 shpërputhje.

11 Pra, këtu flitet për oficerë që janë kundër UÇK-së, dhe
12 ju m’i prezantuat këtu shumë dokumente ku po ato oficerë janë
13 inkorporu në strukturën komanduese të zonës e cila ngritje.
14 Pra, janë, më falni, por vërtet, vërtet është një shpërputhje
15 e madhe dhe një diskrepancë e madhe mes këtyre dokumenteve.
16 Pra.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet të keni -- të
18 jetë zhvilluar një mbledhje a një takim i tillë të Rekës së
19 Keqe për një moment të caktuar të vitit ’98, apo qoftë edhe të
20 ’99-s, apo nëse është zhvilluar ndonjëherë?

21 PË. Ne kemi zhvilluar në lidhje me oficerë, por këtë mbledhje
22 nuk që kemi punuar kundër ushtrisë që vetë jemi konë pjesë e
23 ngritjes së saj, nuk ka logjikë kjo, dhe nuk muj me e pranuar
24 një fakt të tillë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kuptoj. Ju lutem, a e

1 dinë nëse është e vërtetë që Sali Veseli, ia ka tërhequr
2 vërejtjen Tahir Zemajt për këto veprime të oficerëve të vet;
3 keni dëgjuar gjë për këtë?
4 PË. Në dokumentet e mëparshme në qoftë se janë të sakta
5 atëherë Sali Veseli ka qenë në atë kohë shef i shtabit të
6 zonës operative, se ai e ka ngrit atë zonë operative. Ndërsa
7 të gjithë këta oficerë edhe Tahir Zemaaj në ato dokumente
8 shihet se është inkorporu në strukturën e zonës operative të
9 Dukagjinit.

10 Janë gjëra që, z. Gjykatës, nuk po muj me i bo bashkë.
11 Nuk po mundem -- me i ofru njënën me tjetrën. Pra, ky dokument
12 ndoshta ndonjë raport, ku di unë, ku shkrujna flet për do
13 mosmarrëveshje mes Salit Veselit e Tahir Zemaajt, dokumentet e
14 mëparshme emërimi i Tahir Zemaajt për komandant edhe oficerë të
15 tjerë që kanë ardh me të, po ashtu në strukturën komanduese të
16 zonës operative të Dukagjinit. Singerisht nuk muj me dhënë
17 ndonjë --

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Maloku, t'ju ndërpres.
19 Nuk po ju pyesja për të bërë pajtim. Nuk është kjo detyra për
20 të, por pyetja ime ishte e thjeshtë: A keni dëgjuar, apo jo,
21 që z. Veseli t'i ketë tërhequr vërejtjen Tahir Zemaajt për
22 sjellën e oficerëve të vet? Keni dëgjuar ndonjëherë? Nëse jo,
23 mund të thoni dhe jo.

24 PË. Jo, z. Gjykatës.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kemi

1 dokumentin tjetër në Ekran me numër IT-04-84 P00230. Në
2 anglisht dhe në shqip, ju lutem. Faleminderit.

3 Siç e shihni, z. Maloku, është një dokument relativisht i
4 shkurtër, që thotë:

5 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës

6 "Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit

7 "Dukagjin

8 "1 gusht '98

9 "Urdhëresë

10 "Të rekrutohen të gjithë djemtë e rinj nga mosha 18 deri
11 35 vjeç për shërbim në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Në
12 rekrutim nuk përfshihen ata që janë në pikat dhe vijat e
13 frontit."

14 Arkivit, shtabeve të fshatrave, brigadave të shtabit
15 operativ të Rrafshit të Dukagjinit dhe policisë ushtarake.
16 Edhe në të djathtë shkruhet "komandant", nënshkrimi, Ramush
17 Haradinaj.

18 Pyetja përsëri: E keni parë këtë dokument më përpara?

19 PË. Jo, z. Gjykatës, isha i plagosur në atë kohë shumë rëndë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni që Ramush
21 Haradinaj ta ketë dhënë një urdhër të tillë më datë 1 gusht
22 '98 për të rekrutuar --

23 PË. Jo.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- të gjithë djemtë e rinj
25 nga mosha 18 deri 35 vjeç?

1 PË. Jo, z. Komandant -- z. Gjykatës, - më fal. Jo, z.

2 Gjykatës.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kalojmë në
4 dokumentin tjetër, ju lutem, me numër IT-04-84 P00227. Edhe
5 një herë anglishten dhe shqipen krahë për krahë.

6 Z. Maloku, ky dokument thotë, siç është në përkthimin
7 anglisht:

8 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës

9 "Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit

10 "Dukagjin

11 "30 korrik '98

12 "Drejtuar: Faton Mehmetajt

13 "Emërtim

14 "Në bazë të Rregullores së Përkohshme të '98 të UÇK-së
15 dhe vendimit të Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit të
16 datës 23 qershor 1998, Faton Mehmetaj emërtohet
17 ndihmëskomandant i zbulimit dhe kundërzbulimit të Ushtrisë
18 Çlirimtare të Kosovës në Shtabin Operativ të Rrafshit të
19 Dukagjinit."

20 Pastaj thuhet:

21 "Arkivës."

22 "Faton Mehmetajt.

23 Dhe në të djathtë komandant dhe me shkrim dore është
24 nënshkrimi dhe thotë aty më poshtë, Ramush Haradinaj.

25 Z. Maloku, unë e di që e përmendët tashmë më herët sot

1 një individ të quajtur Faton Mehmetaj në lidhje me zbulimin.
2 Pyetja që kam unë është kjo: A jeni në dijeni që z. Haradinaj
3 apo nëse z. Haradinaj e ka bërë këtë emërim në korrik të vitit
4 '98 për ta emëruar z. Faton Mehmetaj si ndihmëskomandant i
5 zbulimit dhe kundërzbulimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
6 në Shtabin Operativ të Rrafshit të Dukagjinit? Jeni në dijeni
7 të kësaj?
8 PË. Jo, z. Gjykatës.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë më herët sot se z.
10 Mehmetaj, por e thatë edhe të hënën, më duket, gjatë pyetjeve
11 që jua bëri Prokuroria, që z. Mehmetaj vërtet ka qenë, me as
12 sa dinit ju, në veprimtari për zbulim dhe kundërzbulimi, pra,
13 në sektorin zbulim-kundërzbulimit, apo jo?

14 PË. Po, z. Gjykatës. Por këtë unë e kam marrë në janar '99
15 kur jam kthyer në zonën operative të Dukagjinit. Gjithmonë e
16 kam kuptu ashtu prej fundjanarit, janar deri më 8 maj sa kam
17 qenë. Me dijeninë time, pra, ai ka qenë në këtë sektor.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe një herë pyetja tjetër
19 ka të bëjë me nënshkrimin. A është e mundshme ta identifikoni
20 këtë nënshkrim?

21 PË. Ky është nënshkrim që, thotë që është i Ramushit, tash
22 unë s'muj me e dit saktë, po, po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dokumentin
24 tjetër në ekran, ju lutem, me numër U002-1395 deri në U002-
25 1395.

1 Siç e shihni, z. Maloku, është një dokument i shkruar me
2 dorë dhe thotë, siç është në anglisht:

3 "SHIK /Shërbimi i Zbulimit i Kosovës/ UÇK - Dukagjin."

4 Dhe thotë:

5 "Ftesë

6 "Për Komandantin e shtabit të fshatit Kryshec, Muhamet
7 Berisha

8 "Ftoheni të merrni pjesë në inaugurimin e objektit, të
9 organit SHIK - UÇK për Dukagjin që do të mbahet në fshatin
10 Kryshec më datë 29.07.1998 praj orës 09:00 në ish-shtabin e
11 fshatit.

12 "Prezent do të jenë edhe Shtabi Qendror i Rrafshit të
13 Dukagjinit."

14 Dhe mbaroj me:

15 "Përshëndetje të përzemërta.

16 "Kryshec, 28 korrik 1998."

17 Dhe po ta shohim dhe pjesën e poshtme në shqip shohim dhe
18 një nënshkrim. Z. Maloku, a jeni në dijeni që -- apo a e dini
19 nëse ka pasur një inaugurim, apo një ceremoni të tillë për
20 objektin e SHIK-ut në fshatin Kryshec më datë 28 [Sipas
21 përkthimit].07.98. Nuk e di a keni dëgjuar për një ceremoni të
22 tillë?

23 PË. Jo, z. Gjykatës. Unë në fillim të gushtit në Kryshec jam
24 strehu për dy ditë në spital. Ka qenë një spital në Kryshec.

25 Po që ka pas një objekt të tillë, unë nuk kam njohuri. Unë jam

1 plagos më 25 korrik '98.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk jeni ftuar dhe
3 as nuk keni qenë i pranishëm, apo jo, në ceremoninë e
4 inaugurimit?

5 PË. Jo, unë isha në Junik, zëvendëskomandant brigade.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj.

7 Tani dua të më ndihmoni lidhur me tri dokumente të tjerë.
8 Nuk duhet të zgjasë shumë.

9 Të dalë në ekran dokumenti SPOE00225801 deri në
10 SPOE00225801. Ju lutem, vendoseni në ekran edhe anglishten
11 edhe shqipen. Faleminderit.

12 Dokumenti thotë kështu:

13 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës

14 "Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit

15 "Vendi Dukagjin

16 "Data: 2 korrik 1998

17 "Drejtuar: Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

18 "Shtabit të Përgjithshëm."

19 Pika e parë thotë kështu:

20 "Sipas shkresës që na është dorëzuar nga Agroni, me
21 vendimin e datës 1 korrik 1998, në Prishtinë, Lahi Ibrahim i u
22 emëruar Koordinator i Shtabit të Përgjithshëm për Nënzonën
23 Operative të Dukagjinit - 14-05.

24 Ju lutem, shkojmë më poshtë në tekst. Dhe shohim
25 nënshkrimin dhe emrin Ramush Haradinaj.

1 Të njëjtën pyetje kam: A e keni parë ndonjëherë më
2 përpara këtë dokument?

3 PË. Jo, z. Gjykatës.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse u emërua
5 vërtet Lahi Ibrahim si koordinator i Shtabit të Përgjithshëm
6 për nënzonën operative të Dukagjinit në korrik të '98-s? U
7 operua - më fal - u emërua ai vërtet?

8 PË. Nuk kam njohuri, z. Gjykatës.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A e dini kush
10 është personi me emrin Agron që përmendet në paragrafin e parë
11 të dokumentit?

12 PË. Jo, z. Gjykatës.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mund të nxjerrim në ekran
14 dokumentin tjetër atëherë U001-0482 - më falni - 4802 [Sipas
15 përkthimit] në anglisht edhe në shqip deri në U001 - 4803.
16 Faleminderit. Shohim paragrafin e parë, dy fjalitë e para.

17 "Shtabi i Dukagjinit me komandant Ramush Haradinaj, i
18 quajtur Smajli u formua më 22 qershor 1998 në fshatin
19 Jabllanicë, në njërin nga fshatrat e parë që filloi
20 rezistencën e armatosur në territorin e Kosovës. Lahiu nga
21 Jabllania - nga Jabllanica - më falni, u emërua zëvendës i
22 Smajlit. Në këtë mbledhje merrnin pjesë përfaqësuesit e
23 shtabeve dhe nënshtabeve të Rrafshit të Dukagjinit."

24 Paragrafi i dytë, fjalia e parë:

25 "Përfaqësuesi i Klinës dhe përfaqësuesi i Shtabit qendror

1 të UÇK-së të Kosovës - Agroni - i cili merrte pjesë në
2 cilësinë e vëzhguesit, foli rreth disa problemeve, duke
3 insistuar në zgjidhjen e Lahisë për komandant të Shtabit
4 Operativ të Rrafshit të Dukagjinit."

5 Fillimisht, z. Maloku, a është e vërtetë që shtabi i
6 Dukagjinit me në krye Ramush Haradinaj u formua më 22 qershor
7 '98 në fshatin Jabllanicë, siç thuhet në këtë dokument?
8 PË. Jo, z. Gjykatës.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pse jo? Pse nuk është e
10 vërtetë kjo që thuhet këtu?

11 PË. Jo, nuk po them që nuk është e vërtetë, por nuk i kam pa
12 këto dokumente, unë edhe nuk di që është kriju më 22 qershor.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na ndihmoni dot me
14 emrin që përmendet në paragrafin e dytë si përfaqësues i
15 Shtabit Qendror të UÇK-së me nofkën Agroni? Na ndihmoni kush,
16 si e ka emrin ky person? Kush është, kush mund të ketë qenë ky
17 person?

18 PË. Jo, z. Gjykatës. Unë vetëm njoh do emra të tjerë këtu,
19 Rrustem Tetaj, Sali Veseli, Shemsedin Cekaj, për shkak që kanë
20 qenë ushtarakë profesionit. Nuk njoh të tjerë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk jeni takuar me
22 një person që vepronte si përfaqësues apo mbase edhe si
23 anëtarë i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që ta ketë pasur
24 nofkën Agroni gjatë luftës?

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Më falni. Nuk e dimë a ka nofkë.

1 Thotë thjesht "Agroni."

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ma merr mendja mua që është
3 nofkë, por mbase dëshmitari mund të na ndihmojë më shumë,
4 mbase njeh ndonjë person me emrin Agroni atëherë.

5 PË. Z. Gjykatës, në brigadën në të cilën unë isha
6 zëvendëskomandant Agroni ishte Rifat Sulejmani, komandant i
7 Batalionit të 2-të; ndërsa edhe Agroni emri i vërtetë ishte
8 Agron Rama i Smolicës që pastaj u bë komandant i Brigadës 134
9 edhe u vra në fund të janarit '99. Unë për këta dy Agrona kam
10 dëgjuar gjatë tonë luftës. Njëri nofkë, komandanti i
11 batalionit, Rifat Sylejmani, ndërsa njëri Agron Rama me emër
12 të saktë.

13 Nuk njoh të tjerë, z. Gjykatës.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dy personat që përmende,
15 këto dy emrat, të dy Agronët, i njihni që në atë kohë kur keni
16 qenë edhe ju në Shtabin e Përgjithshëm apo ju e dinit që këta
17 kanë vepruar e kanë qenë përfaqësues të Shtabit të
18 Përgjithshëm të UÇK-së, dhe këtë e keni mësuar në takimin e z.
19 operative të Dukagjinit?

20 PË. Jo, z. Gjykatës. Rifat Sylejmani me pseudonimin Agroni ka
21 ardh në fund të majit me Sali Veselin në Junik. Ndërsa Agron
22 Rama ka qenë në Smolicë kur unë kam shku, kam hy në Kosovë më
23 22 ose 23 prill '98. Edhe në këtë kohë më 22 qershor kur
24 flitet për këtë dokument ata të dy kanë qenë në kuadër të
25 brigadës në të cilën unë isha zëvendëskomandant në atë kohë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë kam një pyetje
2 tjetër, shkurtimisht. Ju sot paradite, kur ju bënë pyetje
3 Avokatët Mbrojtës, ju folët për personat me emrin apo nofkën
4 Luli. Të kujtohet kjo pjesë?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A njihni ndonjë person, apo
7 ndonjë anëtar apo përfaqësues, apo ndonjë person që kishte
8 lidhje me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së që të ketë pasur
9 nofkën apo emrin Luli?

10 PË. Po, por atë unë e kam taku ose njoh në dhjetor të '98, në
11 Shtab të Përgjithshëm. Diku para Shtabit të Përgjithshëm,
12 thonin Komandant Luli. Ndërsa ky i Dukagjinit ishte Lulzim
13 Morina që i thonim Luli. Ishte komandant Brigade. Pra, këta të
14 dy unë i njoh. I kam njohur.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini kush ishte ky
16 person që sapo thatë ju ishte Komandant Luli. Kush ishte ky
17 person?

18 PË. Lulëzim Morina.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, Luli tjetër. Luli që
20 sapo përmende që the ishte afër Shtabit të Përgjithshëm. Kush
21 ishte ky tjetri?

22 PË. Po, një herë e kam pa sa isha në Shtab të Përgjithshëm,
23 pas lufte kam kuptu që është Veseli.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na jepni edhe
25 emrin, si e kishte emrin personi me mbiemrin Veseli, për

1 procesverbal, ju lutem? Mos - të shmangim keqkuptimet. Na
2 jepni edhe emrin e personit me mbiemrin Veseli.
3 PË. Po nalu se -- Kadri Veseli. Më falni, më falni, ju lutem
4 se në situata të ndryshme nganjëherë edhe emri i djalit tim më
5 humbet, a kupton. E din Prokurori që i kam do, i kam këto
6 probleme. Nuk është që nuk dashta të them menjëherë. Ju kërkoj
7 ndjesë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka problem, nuk është
9 aspak problem. Dokumenti i fundit U001-4078 U001-4078. Dhe
10 versioni në shqip është - gjendet në materialin me numrat e
11 përgjithshëm U001-4078 U001-4080. Është një dokument që ka pas
12 numër provizor. Mund të gjendet me numrin provizor 1D00188 për
13 palët kjo. Nëse nuk e kam gabim, dokumenti është ende me numër
14 provizor dhe është kërkuar të pranohet nga Prokuroria përmes
15 një mocioni për pranimin e dëshmive jогоjore dhe lidhet me
16 zonën operative të Dukagjinit.

17 Z. Maloku, në këtë dokument thuhet:

18 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës

19 "Shtabi Rajonal i Dukagjinit - Shtabit Rajonal të
20 Dukagjinit

21 "Më 23 qershor 1998

22 "Jabllanicë."

23 Edhe thotë:

24 "Vendimet të mbledhjes së Shtabit të Rajonit të
25 Dukagjinit të mbajtur më 23 qershor 1998."

1 S'po e lexoj pjesën tjetër, por po shkoj te paragrafi i
2 fundit i këtij dokumenti që thotë:

3 "Pasi u vu në pah nga të pranishmit të gjitha përparësitë
4 e bashkimit të forcave koordinimit të tyre, u vendos
5 unanimisht, u shpall unanimisht themelimi i Shtabit të Rajonit
6 të Dukagjinit me këtë përbërje."

7 Pastaj thotë: "Shtabi Rajonal -- i Rajonit të
8 Dukagjinit," fillon me komandantin Ramush Haradinaj.

9 Lexojeni, ju lutem, shihini emrat e tjerë, hidhini një sy
10 deri në fund.

11 PË. Po. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Deri ku shohim të fundit,
13 emrin e fundit përgjegjës për mbrojtje kimike-biologjike
14 Muhamet Berisha. Pyetje ime e fundit, me sa dini ju, me sa ju
15 kujtohet ju, a ka ndonjë gjë që nuk shkon me këta personat që
16 përmenden këtu, si anëtar të Shtabit të Rajonit të Dukagjinit,
17 ka diçka që të bie në sy si e pazakontë, qoftë kjo për emrat
18 apo për pozitat që janë caktuar këtyre personave?

19 PË. Po, z. Gjykatës. Është përgjegjës për logjistikë, thuhet
20 Besniku, në kllapa NM. Ky jam unë, Naim Maloku. Këtu jam
21 parapa unë, do të thotë është parapa që unë të marr këtë
22 përgjegjësi për shkak se profesioni im ka qenë i tillë,
23 shkollimi në akademi ushtarake ka qenë për oficer të
24 prapavijës. Dhe kjo pozitë përshtatej me shkollimin tim.

25 Pra, ky është një dokument për të cilin unë kam pas

1 njohuri që jo që ekziston por kam pas njohuri që unë jam i
2 parapamë me zënë një vend të tillë, një pozitë të tillë. Nuk
3 më kanë lënë rrethanat e luftës në brigadën time në Junik që
4 unë të lëshoj atë pozitë dhe të marr përgjegjësitë për
5 logjistikë në shtabin e Zonës Operative të Dukagjinit
6 përkundër fakti që - Me Tahir Zemën erdhën tre oficerë dhe u
7 ndalën në brigadën time. Tash po e them brigadën time,
8 brigadën që unë isha zëvendëskomandant. Ishin Rrustem Berisha,
9 Agim Ramadani edhe Sefedin Kuqi.

10 Erdh edhe komandanti i brigadës se duhej të merrte
11 pozitën, por veprimet luftarake mbi brigadën në cilën unë isha
12 zëvendëskomandant, po erdh Aziz Hyseni u bo komandant brigade.
13 U krijunë parakushtet që unë të tërhiqem nga brigada, por
14 veprimet luftarake që ndodhën mbi brigadën time, ma
15 pamundësuan që unë të tërhiqem nga lufta dhe të marr këtë
16 pozitë këtu. Kjo ishte ajo.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj unë këtë z. Maloku.
18 Po personi Togeri e njhni kush është? Si e ka emrin e vërtetë,
19 e shihni?

20 PË. Po, ishte Idriz Bala ky. Unë këtë e kam njohur prej vitit
21 1991 në Gospiq, kur e kam pas brigadën vullnetare të
22 shqiptarëve atje, ky ka ardh vullnetar aty. Dhe prej atëherë
23 unë e kam njoft Togerin, Idriz Bala, Idriz Balaj.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit,
25 unë nuk kam më pyetje për ju.

1 PË. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani e ka
3 fjalën Gjykatësi Mettraux.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, z. Maloku.

5 PY. Mirëdita.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam dhe unë disa pyetje
7 për ju, dhe do të filloj me pyetjet që lidhen me disa persona
8 që i keni përmendur në dëshminë tuaj. Më nevojitet më shumë
9 informacion për këta persona.

10 I pari është Xheladin Gashi. Edhe shkurtimisht do të them
11 çfarë ke thënë ti në lidhje me këtë person. Ju na thatë se e
12 keni njohur, se nofkën e kishte Plaku dhe na thatë se e keni
13 njohur si anëtar të UÇK-së që merrej me çështjet e
14 logjistikës. A e kemi kuptuar saktë?

15 PË. Vetëm një përmirësim. Kam pas dijeni, se unë kurrë nuk e
16 kam pa Xheladin Gashin. Pra, njohuri kam pas që Plaku është
17 përgjegjës për logjistikë në Shqipëri. Pas lufte unë e kam dit
18 që është Xheladin Gashi. Pra, këtë njohuri kam pas. Se
19 gjithmonë përmendej Plaku, "Me shku te Plaku, me shku njësia
20 te Plaku", kur shkonin për të marrë armë. Plaku i ka siguru
21 dhe kjo ishte, pra, përmendej shpesh nofka Plaku.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin.
23 Ju po ashtu thatë që ai vdiq nga -- për vdekje, për shkaqe
24 natyrore pas luftës. Kështu?

25 PË. Sa e di une, po. Po. Por nuk e di në cilin vit.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni nëse ka
2 vdekur, për shembull, pesë, gjashtë vjet pas lufte? Domethënë
3 jo shumë vonë pas konfliktit, me përafërsi do të ishte kjo një
4 përshkrim i saktë?

5 PË. Nuk kisha mujt, më besoni, me e dit saktë kur.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ka problem.

7 Personi i dytë është -- që të sigurohem për të cilin po
8 flisni ju, përmendet në Shënimin Përgatitor numër 1, në faqen
9 4, me ERN 126644, paragrafi 10. Ju keni përmendur këtu dy
10 persona kur jeni takuar me Prokurorin javën e kaluar, një
11 Nazer Idrizi dhe Jashar Salihi. Të kujtohet t'i kesh përmendur
12 këta persona?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur përmende emrin e
15 Jasharit, që të paktën sipas shënimit është Jashar Salihi, e
16 keni dasht të thoni -- mos e keni pas fjalën Jashar Salihun që
17 punonte për fondin Mëmëdheu Thërre, Vendlindja Thërret? Më
18 falni.

19 PË. po, i njëjti, në Zvicër, në Zvicër ka qenë ai.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ai vdiq një a dy vjet
21 pas luftë, apo jo?

22 PË. Dikund jashtë, më duket, ka vdek në Francë në spital. Nuk
23 di. E di që dikund jashtë ka vdek nga tumori në tru.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Personi i tretë është një
25 person me emrin Xhemail Fetahu. Fillimisht, mund të na thoni

1 nëse e njihni këtë person, Xhemali Fetahu, ose Xhemajl Fetahu.
2 PË. E kam njohur z. Gjykatës. Jam takuar me të herën e parë
3 në janar 1998 në Pragë. Ka ardh me Fehmi Lladrovcin. Jam shku
4 nga Lubjana me Xhevdet Hazirin dhe atje jemi taku në Pragë.
5 Pastaj Xhemajl Fetahin e kam taku në Brigadën 138, Agim
6 Ramadani, në Koshare. Xhemal Fetahaj ka vdek o vra në Koshare
7 ditën e fundit të luftimeve kur u arrit Marrëveshja e
8 Kumanovës dhe u ndërpre në të gjitha aktivitetet tona
9 luftarake, ai o vra në Kosharë. Kjo është e tëra që e di unë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, maj i '99-s, do të
11 ishte periudhë e saktë?

12 PË. Jo, qershor 1999, se me 9 qershor është bo Marrëveshja e
13 Kumanovës.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Qershor, okej.
15 Faleminderit për sqarimin.

16 A e dini çfarë roli kishte ai në UÇK gjatë konfliktit,
17 rol apo pozitë?

18 PË. Xhemajl Fetahaj me Fehmi Lladrovcin erdhën në Pragë. U
19 takuam. Ata kishin rolin e mbledhjes së fondeve për UÇK-në,
20 Xhemajl Fetahaj, mirëpo, edhe u takuam ishin aty edhe Fatmir
21 Demiri dhe do oficerë të tjerë, për t'u koordinu për
22 angazhimet tona në luftë, se unë besoj që ju e dini, Jashar
23 Salihi me Naser Idrizin më kanë angazhu në shtator '97. Kanë
24 ardh në banesën time në Lubjanë dhe prej atij momenti unë jam
25 vu në dispozicion të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe prej

1 shtatorit '97, pra, kemi pas -- kam pas aktivitetet të
2 ndryshme në Gjermani, Çeki, Kroaci për t'u organizu për
3 konfliktin, luftën që mendonim që do të fillonim. Më fal, edhe
4 një herë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

6 Personi i radhës për të cilin dua t'ju pyes është një
7 person që po ashtu e keni përmendur ju. Bëhet fjalë për Shaban
8 Shalën. Fillimisht a mund të na e konfirmoni nëse e njihni
9 kush ishte ky person.

10 PË. E kam njohur Shaban Shalën. Nëse është fjala për Shaban
11 Shalën nga fshati Negrovci ose Gjergjicë, Gjergjicë më duket.
12 Po, fshati Gjergjicë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Negrovci, më duket sikur
14 keni thënë në deklaratë. Megjithatë, pak rëndësi ka.

15 PË. Afër janë ato dy fshatra. Afër janë. Shaban Shala ka ra
16 të njëjtin grup si une në burg në vitin 1985. Për herë të parë
17 e kam njohur nga aktakuza ime, kur e kam marrë aktakuzën.
18 Atëherë e kam njohur që kishte qenë edhe ai në q'atë rrjet dhe
19 kishim pas lidhje të tërthorta, ku di unë çfarë, se ato kanë
20 qenë --

21 Pastaj Shaban Shalën e kam taku gjatë luftës në Kosovë.
22 Ka ardh më ka taku në fshatin Sedllarë kur isha i plagosur se
23 vëllau i tij, Bedri Shala është vra në Junik. Ka ardh, do të
24 thotë, të lufton në Junik, ndihmë nga Zona Operative e
25 Drenicës me Bekim Berishëm. Dhe kur jam plagos unë dhe më kanë

1 tërheq nga Juniku, mbas dy javëve ka ra vëllau i tij, Bedri
2 Shala, dëshmor. Kjo është e tëra që unë e di për atë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini mbase në cilën
4 zonë operative të UÇK-së ishte ai gjatë luftës veprimtar?
5 PË. Unë sa e di ka qenë në Zonë Operative të Drenicës, dhe
6 angazhimi i tij luftarak ka dërgua deri aty që ai është gradu
7 me gradën gjeneral para se të vdiste, do të thotë, ka pas
8 gradën e gjeneralit.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e di çfarë funksioni
10 kishte ai gjatë luftës në Zonën Operative të Drenicës? Çfarë
11 pozite, çfarë funksioni kishte ai?
12 PË. Jo, nuk e di.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sapo thatë se u vra ose
14 vdiq. Me përafërsi ju kujtohet kur ka ndodhur kur vdiq?

15 PË. Ka vdek dikund katër, pesë vite mbas lufte. Nuk jam i
16 sigurt edhe këtu. Kërkoj ndjesë që me data dhe me vite kam
17 probleme.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe unë vetë kam probleme
19 me data, kështu që mos u anko fare për këtë. S'ka problem.

20 Do t'ju pyes për një person tjetër dhe më shumë më duket
21 sikur po ju bë në pikëpyetje kujtesën historike në fakt. Esat
22 Gash Toptani --

23 PËRKTHYESJA: Sipas shqiptimit të Gjykatësit.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- kush është? Esat Pashë
25 Toptani. A e dini kush është?

1 PË. Nga historia është një pashë, ka qenë. Është vra për
2 tradhti në Vjenë edhe e njeh historia e popullit shqiptar si
3 tradhëtar. Nëse është fjalë për atë, Esat Pashë Toptanin,
4 q'ashtu, po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani kam nevojë të bëj
6 disa sqarime lidhur me dëshminë tuaj që lidhet me udhëtimin që
7 keni bërë ju në Bellanicë. Sipas jush ka ndodhur në dhjetor të
8 '98-s.

9 Fillimisht, disa pyetje lidhur me gjeografinë. A është e
10 vërtetë që Bellanica është në komunën e Malishevës, është
11 pjesë e komunës së Malishevës?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e vërtetë që sa i
14 përket zonave të UÇK-së i takon që të ketë qenë në zonën e
15 përgjegjësisë së Pashtrikut, Zonës Operative të Pashtrikut?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe prapë pyetje
18 gjeografike, më të përgjithshme. A mund ta përshkruajmë
19 Bellanicën si një fshat që gjendet në regjonin apo në Rrafshin
20 e Dukagjinit, e kam saktë?

21 PË. Jo, nuk është. Është -- e i thomi Llapusha, i thomi ne
22 asaj, atij regjioni. Nuk është Dukagjin. Dukagjini janë,
23 Dukagjini është regjioni që përfshin komunat Gjakovë, Pejë,
24 Deçan, Istok, Klinë. Pra ky është Dukagjini. Ai është në
25 tjetër. Malisheva është --

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

2 PË. Malisheva është pjesa qendrore e Kosovës.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e vërtetë që
4 asokohe, pra në kohën kur vizituat Bellanicën, UÇK-ja kishte
5 një pikë, një pozicion në Bellanicë në atë kohë. Saktë?

6 PË. Ka qenë njësit i Bellanicës i cili ka vepru tanë kohën.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky njësit a kishte dhe
8 anëtarë të policisë ushtarake nëse kenë dijeni për këtë?

9 PË. Jo, nuk kam dijeni. Ishte në kuadër të Brigadës 121.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet kush ka qenë
11 shefi i policisë ushtarake të Brigadës 121 në fillimet e
12 tetorit 1998?

13 PË. Jo, z. Gjykatës.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thatë që ju dërguan në
15 Bellanicë, pra ju dërgoi Jakup Krasniqi në Bellanicë, edhe na
16 shpjeguat se kishit dhe familjarë në atë zonë, të afërm. Çfarë
17 ju tha z. Krasniqi për misionin tuaj. Cili ishte misioni juaj,
18 pse shkua ju në këtë fshat?

19 PË. Z. Gjykatës, ka një dallim një fjalë. Nuk më ka dërgu z.
20 Krasniqi. Z. Krasniqi më ka thanë, "A po kishte qenë mirë me i
21 shoqëru komandantin e brigadës edhe shefin e shtabit, se
22 mbahet një tubim me qytetarë në Bellanicë". Se unë jam
23 ushtarak, në hierarkinë ushtarake, kur dikush dërgohet atëherë
24 duhet me i dhënë raport atijna me shkrim. Unë kam shoqëru
25 komandantin e brigadës edhe shefin e shtabit në takimin me

1 qytetarë që ata e kanë organizu.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po merrem me
3 formulimin tani, por në deklaratën e qershorit të 2016-s që i
4 keni dhënë Prokurorisë së Kosovës, ju keni thënë:

5 "Më dërgoi Shtabi i Përgjithshëm."

6 Megjithatë e lemë mënjane këtë. Z. Krasniqi ju tha që do
7 të ketë një takim me popullatën, me popullsinë lokale atje. A
8 ju tha për çfarë ishte ky takim?

9 PË. Ishte -- jo, nuk tha për çfarë ishte, por që komandanti i
10 brigadës ka takim atje, se ishte rregull kur ndërrohej
11 komandanti i brigadës atëherë komandanti i ri i brigadës i
12 sapoemëruar ai bënte takime me qytetarë me njësitet e UÇK-së
13 në krejt zonën e përgjegjësisë së brigadës. Aty ishte një
14 takim pak ma i madh se merrshin pjesë edhe disa fshatra rreth
15 Bellanicës.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Krasniqi a ju kërkoi të
17 shkonit në ndonjë takim tjetër të ngjashëm në ndonjë vend
18 tjetër, mesa të kujtohet?

19 PË. Krasniqi, jo, nuk -- unë i kam thënë ZPS-së, keni dëshmi
20 që prej 18 nëntor deri me 27 nëntor kam qenë në një pjesë
21 tjetër të komunës së Malishevës [E padëgjueshme] Brigada 122.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të ndalojmë këtu një çast,
23 të lutem. Ky është i vetmi rast, pra, që ju dërgoi diku, apo
24 ju kërkoi të shkonit diku siç thatë ju.

25 Sa i takon temave që diskutuat me banorët kur shkuat

1 atje, ju keni thënë në deklaratat të mëpasshme se keni
2 diskutuar me popullatën atje për vrasjen e z. Beniçi [Sipas
3 përkthimit] dhe Hoxha, saktë?
4 PË. Po është në mesin e të gjitha çështjeve të cilat janë
5 diskutu aty që komandanti brigadës e ka fillu. Në mesin e të
6 gjithave atyne çështjeve që për një orë e gjysmë, dy, ose sa
7 ka zgjat ai tubim, një banor i aty kur unë kam thënë që duhet
8 me ndihmu UÇK-në, që ne kemi me u çliru, që sa ma shumë të
9 tjerë, është çu një, ka ngrit dorën një prej të pranishmëve
10 edhe ka thënë "Ne dyshojmë se na i ka vra UÇK-ja dy
11 bashkëfshatarë tanë".

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ti çfarë ju the kur ta
13 tha ky person këtë?

14 PË. E kam thënë edhe në Gjykatë në Gjykovë, e ka pranë edhe
15 vëllau i Ramiz Hoxhës që është ashtu. Unë ju kam thënë që
16 "Kosova ka me u çliru, që ne kemi me kriju shtetin dhe që nuk
17 ka me mbet asgjë e paditur se ç'ka ka ndodhur dhe çka po ndodh
18 gjatë luftës". E kam marrë edhe një shembull, "edhe nga lufta
19 e dytë botërore sot mbahen procese në botë. Pra, të keni
20 parasysh të gjithë, edhe ushtarët që janë këtu edhe ju civilët
21 se ne kemi me bo shtetin dhe ka me u sqaru dhe me zgjedh çdo
22 gjë. Ishte tre muaj që kishte ndodh ai rast".

23 Kjo ka qenë thirrja ime për ata banorë. Edhe mas luftës
24 z. Gjykatës, në vitin 2000 ka ardh vëllau i Ramiz Hoxhës te
25 unë në Prishtinë --

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, zotëri, një moment. Të
2 qëndrojmë te lufta. Çfarë keni bërë ju nëse keni bërë ndonjë
3 gjë për të siguruar që ajo që ju kishit thënë që ky person do
4 të ndodhte -- që në këtë rast, domethënë, çfarë bëtë ju dhe
5 ata bashkë me ju, Haxhi Shala dhe z. Dragaj, çfarë hapash ose
6 çfarë hapi morët ju për të siguruar që do të ndodhte kështu,
7 do të bëhej kjo gjë?

8 PË. Ata nuk e di çfarë hapa ndërmorën, në vitin 2000 erdh
9 vëllau i Ramiz Hoxhës te unë edhe ma përkujtoi takimin në
10 Ballanicë edhe tha, "Dua të më zgjidhet, të më zbardhet
11 rasti". Unë i thashë që, "Kosova ende nuk ka institucione të
12 drejtësisë, sundimin e ligjit e ka EULEX-i, merre një avokat
13 dhe rastin mundet me e zbardh dhe me e hetu vetëm Gjykata".

14 Prej atij momenti, do të thotë, rastin ai e ka paraqit në
15 Gjykatë edhe janë zhvillu atëherë procedurat. Të njëjtën
16 dëshmi e kam dhënë edhe në Gjykatë në Gjakovë. Ramiz Hoxhën,
17 z. Gjykatës, unë e kam njoft nga Sllovenia. Djali i Ramiz
18 Hoxhës, kur iu ka vra baba ka qenë ushtar i UÇK-së --

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një moment. Po ju ndaloj
20 këtu. Pyetja ime ishte edhe më e thjeshtë, po mbase dhe aq e
21 qartë. Pyetja është kjo: Gjatë luftës pas këtij takimi ku ju i
22 treguat këtij personit se do ndërmerreshin hapa për të hedhur
23 dritë mbi këtë rast, gjatë luftës çfarë hapash keni bërë ju,
24 nëse keni bërë hapa të tillë, për të siguruar që do të hidhej
25 dritë mbi atë gjë?

1 PË. Jo, unë nuk kam bërë, z. Gjykatës, se ishin aty ata që
2 komandanti i brigadës edhe shefi i shtabit që e kishin
3 organizu mbledhjen. Unë nuk kam ditë çfarë hapa me marrë në
4 luftë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E dini nëse z. Haxhi
6 Shala, apo nëse z. Dragaj kanë bërë ndonjë hap gjatë luftës?
7 PË. Jo, z. Gjykatës.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Këto ishin
9 pyetjet e mia.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
11 Gaynor.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
13 Smith.

14 Mirëdita, z. Maloku. Kam edhe unë disa pyetje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Siç e shihni
16 e kemi kaluar orën 3.30. Po shpresoj që të vazhdojmë, po nëse
17 keni nevojë për pushim, na thoni.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Disa prej nesh duhet të
19 konsultohen me klientët për të parë nëse do të bëjmë ne
20 kundërpjetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po do jetë
22 pas orës 4.30 që do mbarojmë atëherë sot. Në rregull.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase s'do kemi pyetje, por do të
24 konsultohemi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë atëherë.

1 Do bëjmë pushim tani 10 minuta. Dëshmitar do bëjmë pushim tani
2 dhe do kthehemi dhe do përpiqemi ta përfundojmë sot dëshminë
3 tuaj.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
6 ndërprerjen e seancës për 10 minuta.

7 --- Seanca ndërpritet në orën 15.39

8 --- Seanca rifillon në orën 15.48

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E morëm
10 mesazhin tuaj. Por në fillim do përfundojmë këtë. Pastaj mund
11 të japim një kovë e një shtupë për të rregulluar gjërat.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
14 Gaynor, i ulur këtu në fund të bankës, ka disa pyetje për ju.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
16 Smith.

17 Z. Maloku, desha shkurtimisht të përqendrohemi në
18 shpërndarjen e telefonave satelitor. Dje na thatë se telefonat
19 satelitor filluan që të vinin në qershor të 1998-s, na thatë.
20 Dhe pastaj thatë se "Gradualisht filluam të pajisemi me to".
21 Dhe thoni.

22 "Që mesa di unë ia dolëm të t'ua shpërndajmë në nivel
23 brigade jo më herët se nëntori."

24 Ju kujtohet që thatë kështu?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju kujtohet, pak a shumë, sa
2 telefona satelitor janë ardh?

3 PË. Jo, z. Gjykatës. Vetëm e di që çdo brigadë kemi arrit me
4 e pajisë me telefona satelitorë. Nuk kemi mujt me i pajisë
5 njësitë në nivel brigade, pra, brigadat edhe zonat operative
6 edhe Shtabi i Përgjithshëm tash. Nuk e di, sa numra të
7 telefonave nuk e di.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur filluan që të vinin në
9 qershor të 1998-s kujt ia dhatë fillimisht?

10 PË. Fillimisht më erdhi mua telefoni satelitor në territorin
11 tim, deri atëherë nuk kishim. Ma ka sjellë Muhamet Kelmendi me
12 Naser Idrizin telefonin. Pastaj ku u ndërtu brigada, ai mbet
13 telefoni i brigadës. Kur unë u plagosa telefoni mbeti në
14 brigadë, unë u tërhoqa për shërim.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju kujtohet kur e keni marrë
16 ju vetë atë telefon?

17 PË. Po më kujtohet që e kam thirr ma së pari familjen time.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, me ç' datë?

19 PË. Nuk muj me thënë saktë datën, z. Gjykatës. Është dikun --

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga qershori deri në nëntor,
21 po bëhej procesi i shpërndarjes telefonave, atëherë a mund të
22 themi që deri në nëntor telefonat ishin shpërndarë brigadave
23 dhe të gjithë komandantëve të zonave dhe anëtarëve të Shtabit
24 të Përgjithshëm?

25 PË. Unë e besoj që në dhjetor kur ka fillu linja, kur ka

1 fillu komunikimi me zona operative, drejtoria operative kanë
2 pas telefona satelitor.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe është dhjetori i vitit
4 1998, sigurisht?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit. Dua të kaloj
7 tani në drejtorinë operative në rolin që e kishte. I keni
8 thënë Gazetës së Re Shqiptare në një intervistë të marsit të
9 vitit 1999, 2 mars 1999 - në faqen 126682 - dhe ju keni thënë
10 që:

11 "Nuk jam komandant i asnjë prej zonave operative, por jam
12 në drejtorinë operative të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së
13 që është në një nivel më të lartë sesa komandanti i zonës
14 operative."

15 Ju kujtohet që e keni thënë kështu?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju kujtohet. A mund të na
18 shpjegoni diçka më shumë si e kuptonit ju faktin që drejtoria
19 operative ishte më lart se komandantët e zonave?

20 PË. Po kjo ishte intervistë për një gazetë, z. Gjykatës. Jam
21 munduar me e prezantu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës
22 profesionale, me e bind opinionin shqiptar kosovar që shpresa
23 për liri është në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ka qenë,
24 do të thotë. Unë e kam mbajtur atë pozicion ose si oficer i
25 drejtorisë operative deri në fund të luftës. Kam qenë vetëm

1 ndihmë.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E mendonit se drejtori i
3 drejtorisë operative ishte në gjendje t'ju jepte urdhra
4 komandantëve të zonave?

5 PË. Jo, nuk jep drejtori i drejtorisë operative urdhra, shefi
6 i shtabit. Por pozita, rangu ishte më i lartë në tana
7 ushtritë, ishte më i lartë sesa zona operative. Kemi shku,
8 jemi mundu me kriju pasqyrë që para misionit vëzhgues, para
9 botës që respektohen, kemi hierarki të respektuar, hierarki.
10 Gjithmonë kur vinte ndonjë përfaqësues i vëzhguesve te
11 komandanti i zonës i thonte, "Ky është ma lart se unë". Më
12 prezantojke ashtu do të thotë. Kështu ishte. Po. Kemi pas
13 vizita të shpeshta të vëzhguesve nëpër zona, brigada,
14 fshatrat.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po e kam kuptuar qartë që
16 drejtori i drejtorisë operative ishte në gjendje që t'u jepte
17 urdhra komandantëve të zonave? Kështu e kam kuptuar qartë?

18 PË. Jo. Shefi i shtabit ka mujt me dhënë urdhra. Drejtori i
19 drejtorisë operative është marrë me përgatit, me informacione
20 operative në terren, përgatitjen e dhomës operative edhe
21 informacionet çka po ndodhë në terren për luftën, luftarake.
22 Dhe shefi i shtabit pastaj i ka pas ato informacione.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur shefi i shtabit i
24 drejtorisë informative u jepte urdhra komandantëve të zonave
25 këtë e bënte në emër të Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

1 PË. Po në çdo -- unë nuk kam pa urdhra të tillë, për shkak se
2 nuk pas qasje në ato dokumente. Por unë flas nga logjika. Nuk
3 i kam pa ato urdhra. Më besoni po.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po kjo është struktura siç e
5 keni kuptuar ju vetë, apo jo?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E keni kuptuar që shefi i
8 shtabit i drejtorisë operative mund t'u jepte urdhra dhe
9 njësive të ZKZ-së?

10 PË. Nuk e besoj. Ku ka tash, çfarë lidhje ka ZKZ-ja? ZKZ-ja
11 është një sektor i cili mbledhë informacione, i analizon ato
12 edhe i vlerëson ato dhe ia jep, do të thotë, ia përcjellë
13 shefit të shtabit. Nuk ka aty njësi ose nuk ka kompetenca
14 tjera.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do ta them ndryshe. Besoj se
16 na folët për drejtorinë, për sallën operative dhe në
17 drejtorinë operative kishte një hartë, kishte harta
18 topografike aty dhe ju keni thënë:

19 "Të gjitha informacionet që merrni për lëvizjen e forcave
20 serbe, zgjerimin apo tkurrjen e territoreve vendoseshin në
21 këtë hartë topografike. Kishim një tabelë në mur ku shkruanim
22 humbjet e përditshme, raportet e përditshme të humbjeve të
23 menduara të armikut të cilat i merrnim nga zonat operative."

24 Ju kujtohet që e keni dhënë këtë dëshmi, këtu para dy
25 ditësh?

1 PË. Po. Kjo ishte puna e drejtorisë operative.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Informacioni i
3 zbulim kundërzbulimit që, të nevojitet sigurisht, për ta
4 kuptuar ku po lëviznin forcat serbe vinte në drejtorinë tuaj
5 përmes linjave të komunikimit, apo jo. Besoj se ju na e thatë
6 që ka pasur një vendim për të pasur komunikim të përditshëm
7 mes zonave operative dhe drejtorisë operative të Shtabit të
8 Përgjithshëm dhe ky vendim është marrë që në mbledhjen e parë
9 të dhjetorit me komandantët e zonave operative.

10 Pra, ka qenë detyrë e drejtorisë operative të komunikonte
11 me zonat operative. Këtë e keni thënë në transkriptin
12 përkatës. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani unë dua të kuptoj hapat
15 sesi kalonte informacioni për të garantuar ju që hartat
16 topografike dhe humbjet ditore t'i kishit të sakta. Unë dua të
17 kuptoj këtë. Pra, si garantoni ju që informacioni që merrnit
18 prej zonave ishte i saktë, i besueshëm dhe i rregullt?

19 PË. Unë ju thashë që nuk kishim mundësi me e verifiku, me i
20 verifiku informacionet. E thashë edhe sot. Por ne ju besonim
21 atyne. Edhe më besoni që unë, na shpesh herë i krahasonim edhe
22 me lajme, edhe me gazeta, edhe me radio. *Deutsche Welle* kishte
23 një rrjet të madh të gazetarëve nëpër terrene. Dhe shpeshherë
24 e krahasonim. Krahasonim ato informacione që vinin, i
25 krahasonim me informacionet që i gjenim nëpër mjetet e

1 informimit.

2 Situata, Kosova ishte tërësisht e okupime. Brigadat ishin
3 shumica të izoluara. Nuk kishin lidhje direkte njëna me
4 tjetrën as me territor. I vetmi komunikim ka mbet, ishte edhe
5 mes brigadave dhe zonës operative, telefonat. Pra, nuk kishte
6 kontakte fizike as zona me zonë se duhej kalu nëpër territore
7 të kontrolluara nga forcat kundërshtarë.

8 Çdo brigadë e ka pasur edhe një sektor të ZKZ-së ose
9 mbledhjes së informacioneve. Ata prezantojshin brigadën, e
10 informojshin. Brigada prej orës 6.00 deri në ora 8.00 duhej me
11 dhënë informacione në zonë operative. Zonat operative kishin
12 kryesisht nga një vajzë ushtarë të punësuar, të angazhuar, e
13 cila me telefon i jepke q'ato informacione bazike për lëvizjet
14 e trupave, të policisë, të kapaciteteve të njësive që
15 lëviznin, në cilat drejtime shkonin edhe për përplasje
16 luftarake që kishim ditore në atë kohë. Ne çdo ditë humbshim
17 ushtarë edhe civilë. Pra, që na lajmëronim pastaj në
18 drejtorinë operative. Drejtoria operative nuk kishte lidhje me
19 ZKZ-në.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju lutem të sqaroni një
21 pikë. Ju thatë që nga 6 tek 8 ia kalonin këtë informacion
22 zonave operative. Çfarë deshët të thonit me këtë nga 6 tek 8?
23 PË. Nga ora 6.00 deri në ora 8.00 në mëngjes. Për 24 orët e
24 fundit. A jam i qartë? Nga ora 6.00 deri në ora 8.00.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, secila dhomë kishte

1 udhëzim që t'i dërgonte raport drejtorisë operative çdo 24
2 orë?

3 PË. Sa kam qenë në Dukagjin, kështu e kemi bë. Do të thotë,
4 prej orës 6.00 deri në ora 8.00 të gjitha brigadat njoftonin
5 zonën operative, do të thotë, komandën e zonës operative për
6 çka ka ndodhë në 24 orët e fundit në territorin e brigadës.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe më pas komanda e zonës
8 ia përcillte menjëherë informacionin drejtorisë operative,
9 kështu?

10 PË. Po, drejtorisë operative nga ora 8.00 deri në ora 10.00
11 në q'atë interval.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga ora 8.00 e mëngjesit
13 deri në 10.00 të darkës?

14 PË. Jo, 10.00 të mëngjesit. Po.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] E kuptova. Dua të fokusohem
16 në këtë takim që është mbajtur në fillim të dhjetorit të 1998
17 ku morën pjesë të gjithë komandantët e zonave edhe sipas jush
18 ky ka qenë fillimi i raportimeve mujore me komandantët e
19 zonave --

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] -- dhe drejtorët e drejtorisë së
22 Shtabit të Përgjithshëm.

23 A ju kujtohet që dhatë dëshmi për këtë?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Besoj se ju e kishit për

1 këtë takim, ju thatë për këtë takim dhe thatë:

2 "... procesverbali i takimit, temat, raportet që vinin
3 nga komandantët e zonave vinin në drejtorinë operative të
4 Shtabit të Përgjithshëm dhe këto materiale më pas hidheshin në
5 raporte nga takimet e Shtabit të Përgjithshëm, pastaj
6 ktheheshin në raporte."

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të na e sqaroni diçka
9 më shumë këtë, ju lutem? A e kam kuptuar unë drejt që pasi
10 bëhej raportimi mujor përgatitej procesverbal i takimit,
11 kështu, në takim mujor përgatitej procesverbali, kështu?

12 PË. Procesverbali mbahej në takim si duket, po q'ato kërkesat
13 e raportimet apo njoftimet e zonave operative bëheshin pastaj
14 me një raport për t'u përmbledhë të gjitha për krejt
15 territorin, për krejt Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës çfarë
16 mungesave ka, çfarë kërkesave ka. Dhe me ato pastaj
17 mundoheshim me ato kapacitetet mundësitë tona me plotësu. Po
18 kurrë s'mujshim me i realizu ato në plotni.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe në këtë takim e fillim
20 dhjetorit 1998, kush ishte përfaqësi i policisë ushtarake --
21 drejtorisë së policisë ushtarake - më falni?

22 PË. Më duket që aty është vendos që Fatmir Limaj të jetë nga,
23 do të thotë, është avancu nga komandanti i Brigadës 121 në
24 drejtor të drejtorisë së policisë ushtarake. Edhe është
25 vendosë ndërtesa në një fshat krejt tjetër në Lladrovç. E di

1 veç ku ka qenë ajo ndërtesë. Ka kam kalu asaj rrugës, në anë
2 të majtë. Po nuk kam hy mbrenda, nuk e kam dit mbrenda ça ka
3 aty. Aty ka qenë e vendosun se s'kishte hapsina më në ato
4 ndërtesa e asaj ferme ku ishim atij fshatarit edhe --

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në këtë takimin e dhjetorit
6 të 1998, kush e përfaqësonte drejtorinë informative apo
7 zbulimin kundërzbulimin?

8 PË. Nuk e di.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Një pikë tjetër të fundit
10 edhe do të përfundoj. Ju thatë që keni qenë këshilltar i z.
11 Thaçi në shtator të 1999. Për sa kohë keni qenë këshilltar për
12 z. Thaçi se nuk e kam të qartë?

13 PË. Dëgjoni, a ka qenë shtator apo diku në gusht, se unë më 8
14 gusht jam kthyer nga trajtimi në spitalin ortopedisë, sektori i
15 ortopedisë në Mainz afër Frankfurtit. A ka qenë gusht apo
16 fillim shtatori nuk e di. Ai angazhim i imi ka vazhdu deri në
17 transformimin, në datën e transformimit të UÇK-së në TMK. Pra,
18 keni parasysh tash. Nuk më kujtohet data cila, por deri në atë
19 datë unë kam qenë këshilltar i z. Thaçi për siguri.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në këtë periudhë kohore a
21 është bërë ndonjëherë ndonjë diskutim me z. Thaçi lidhur me
22 personat e zhdukur, personat që ishin zhdukur pasi ishin marrë
23 në ndalim nga UÇK-ja, pasi i kishte ndaluar UÇK-ja?

24 PË. Jo, nuk kemi pas. Unë kam pas të mirrem vetëm me çështjet
25 rreth transformimit të UÇK-së në TMK. Faktori ndërkombëtar

1 prej Kouchner, Holbrooke takimet kur i bënte me shefin e
2 shtabit e të tjetër që unë disa u prezantojshin, disa jo. Do
3 të thotë, ishte kjo problematikë, do të thotë, me bë
4 transformimin e UÇK-së, sipas marrëveshjeve që ishin bë me
5 ndërkombëtarët, në TMK. Kjo ishte ajo fusha e veprimit tim.

6 Pra, sa i përket sektorëve tjerë siguria publike e të
7 tjera, sundimi i ligjit ishte në duar e UNMIK-ut edhe EULEX-
8 it. Nuk kishim na kurrfarë kompetenca qeveria me u marrë,
9 Qeveria e Përkohshme me u marrë me gjëra të tilla përveç
10 thirrjeve publike, ku di unë, deklaratave që duhet misioni i
11 ligjit të mirret me këto. Kosova nuk kishte as polici as
12 kurrgjë s'kishte, do të thotë, të vetën.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ju kujtohet të keni
14 dëgjuar që të ketë pas ankesa nga të afërm të personave që
15 janë parë për herë të fundit në ndalimin e UÇK-së, pra, nga të
16 afërm që përpigeshin të zbulonin çfarë u kishte ndodhur këtyre
17 personave të zhdukur? Keni dëgjuar diçka në lidhje me këtë?
18 PË. Ka pas nëpër gazeta edhe në shtyp, po ata duhej, ata
19 drejtoheshin në policinë e UNMIK-ut edhe të EULEX-it. Ata
20 ishin. Ishin policia e UNMIK-ut në Kosovë. Ishte sundimi i
21 ligjit, sundimin e ligjit e kishte EULEX-i, hetues, gjyqtarë,
22 të gjitha ato. Kosova nuk kishte asnjë kapacitet, asnjë
23 kapacitet zyrtar që guxon me ndërmarrë diçka në atë drejtim.
24 Ishin tuj u ndërtu policia dhe ato.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ju kujtohet që z. Thaçi të

1 ketë shfaqur ndonjë interes për këtë çështje gjatë kohës që
2 keni qenë ju këshilltar i tij, pra, a ka shfaqur ndonjë
3 interes për këtë çështje?
4 PË. Edhe z. Thaçi, edhe z. Rugova, edhe të gjithë
5 përfaqësuesit politikë të Kosovës kërkonin nga sundimi i
6 ligjit që të zbardhen rastet, pra, që të ndërmerret çdo gjë.
7 Ne kishim edhe shumë njerëz të zhdukur që s'i dijshim a i ka
8 marrë Serbia apo ishin në burgjet serbe apo ku ishin. Pra,
9 ishte një situatë e pas luftës shumë e rëndë në atë kohë. Pra,
10 ishte -- ishin 45.000 trupa të KFOR-it, ishin punktet. Kosova
11 nuk kishte asnjë kapacitet për të ndërmarrë diçka përveç
12 deklarimeve politike publike. Po.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

14 Kaq pyetje kisha për ju, z. Maloku.

15 PY. Faleminderit, z. Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje nga
17 Prokuroria?

18 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokati i z.
20 Thaçi?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Misetic e kam emrin unë. Po.

22 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, kam vetëm një pyetje që lidhet me një pyetje
25 të Gjykatësit Gaynor, kjo është e reflektuar në transkriptin

1 provizor. Kur ai ju pyeti:

2 "Kur shefi i shtabit i drejtorisë operative lëshonte
3 urdhra për komandantët e zonave, ai e bënte këtë në emër të
4 Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

5 Dhe ju i jeni përgjigjur:

6 "Nuk kam parë ndonjë urdhër të tillë se s'kam pas qasje
7 në dokumente të tilla."

8 Pastaj pyetje:

9 "Po kjo ka qenë struktura siç e keni kuptuar ju, apo jo?"

10 Dhe ju i jeni përgjigjur:

11 "Po."

12 Pyetja ime është kjo: Mesa kuptoj unë nga përgjigja juaj,
13 ju nuk keni njohuri të drejtpërdrejtë për ndonjë komunikim mes
14 Bizlim Zyrapit dhe Azem Sylës, saktë?

15 PË. E saktë është.

16 PY. Ju thatë që urdhrat s'i keni parë. A e dini ju që Bislim
17 Zyrapit ka lëshuar urdhra dhe i ka nënshkruar në cilësinë e tij
18 si shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe jo si shef i shtabit? A
19 e dini ju këtë?

20 PË. Jo, përveç atyne që janë prezantu këtu, që e kam përcjell
21 dëshminë e z. Zyrapit. Deri atë ditë unë nuk kam dit për ato
22 dokumente që ekzistojnë dikun.

23 PY. Ju keni qenë pjesë e forcave të armatosura kroate. A e
24 dini ju që në Kroaci, grada më e lartë ushtarake quhet, është
25 shefi i Shtabit të Përgjithshëm, është rangu më i lartë

1 ushtarak, a e dini ju këtë, është e saktë?

2 PË. Te gjitha ushtritë është ashtu.

3 PY. Pra, shefi i Shtabit të Përgjithshëm në vetvete është
4 komandanti dhe nuk vepron për llogari të një grupi, saktë?

5 PË. Z. Avokat, vetëm dy minuta kohën e juaj t'ia marr?

6 PY. Nuk e di a i kemi dy minutat në fakt. Për 30 sekonda, të
7 lutem.

8 PË. Brigadën vullnetare timen në Gospiç ende nuk e ka pranuar
9 presidenti i Kroacisë që është brigadë e ushtrisë kroate që 30
10 vjet. Dy dëshmorë, dy që janë vra, ua ka pranuar statusin e
11 dëshmorëve, tetë të plagosur të invalidëve, ndërsa brigada
12 vullnetare më ka mbetur e papranuar.

13 Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë ushtri vullnetare.
14 Kuptoni?

15 PY. Po. Po ju pyes kështu, titulli, titulli, emërtimi,
16 titulli shef shtabi, krahasuar me shefin e shtabit, pra, unë
17 po them shefi i Shtabit të Përgjithshëm është pozicion
18 komandues, ai është komandanti i një ushtrie, a pajtoheni me
19 propozimin tim?

20 PË. Shefi i shtabit në çdo ushtri është, por brigadën tonë
21 s'e ka komanduar Kroacia, po, kur kemi shkuar në aksione kanë
22 ardhur na kanë pyetur "A po vini edhe sa po vini? Se kemi qenë
23 vullnetarë.

24 PY. Në rregull.

25 PË. Jo, duhet me e kuptuar linjën. Duhet me kuptuar që nuk është

1 një --

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

3 Dëshmitar.

4 DËSHMITARI: Po. Në rregull.

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Ju lutem, vetëm -- nuk po ju pyes për Kroacinë.

7 PË. Po, po. Jo -- po, në rregull

8 PY. E lamë Kroacinë.

9 PË. Në rregull.

10 PY. E lëmë Kroacinë. Iku Kroacia.

11 PË. Në rregull. Në rregull.

12 PY. Po përpiqem të bëj dallimin mes shefit të shtabit dhe
13 shefin e Shtabit të Përgjithshëm. A e bën dot dallimin, a e
14 kupton dot dallimin mes shefit të shtabit dhe shefit të një
15 Shtabi të Përgjithshëm.

16 PË. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është mbi shefin e
17 shtabit.

18 PY. Po. Dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm është komandant,
19 është komandant.

20 PË. Po.

21 PY. A pajtoheni?

22 PË. Ashtu është.

23 PY. Faleminderit. Kaq kisha.

24 PË. Dhe atë unë e kam njoft tek mbas lufte. Po.

25 PY. Faleminderit. Faleminderit shumë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
2 unë ju kërkoja përkthyesve që të qëndrojnë më gjatë. Kështu që
3 nuk dua t'ju heq të tjerëve mundësinë për të bërë pyetje që ju
4 i gjykoni që janë të rëndësishme. Mund t'i bëni.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, unë kaq pyetje kisha. Ka dhe
6 z. Dixon pyetje.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

8 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon.

9 Z. DIXON: [Përkthim]

10 PY. Z. Maloku, kam edhe unë disa pyetje plotësuese. Pikë së
11 pari Gjykatësi Barthe u ju tregoi një dokument.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Dhe do kërkoja që të shfaqej në
13 ekran në fakt dokumenti. Është 0021395. Dokumenti është dhe në
14 shqip dhe në anglisht.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Më jepni ERN-në e
16 plotë, ju lutem.

17 Z. DIXON: [Përkthim] 0021395. Duhet të jetë në listën e
18 materialeve të Gjykatësve.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Është po dokumenti që
20 shoh unë është me numër U002-1395-U002-1395. Për këtë dokument
21 e keni fjalën?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po, për këtë dokument. Faleminderit.

23 PY. Dëshmitar, ju thatë që nuk dinit gjë për këtë dokument se
24 nuk e kishit parë ndonjëherë më përpara. Megjithatë unë dua
25 t'ju pyes për diçka, shihe dokumentin në shqip, në krye në të

1 majtë, thotë "SHIKI" ka I në fund pastaj "UÇK-Dukagjin". A e
2 dini ç'a është "SHIKI", pse është kjo I-ja në fund,
3 ç' domethënë?

4 PË. Kjo domethënë që është një shkrim i një njeriu që e ka
5 ndoshta një shkollë fillore të kryme edhe që s'e ka idenë çka
6 është SHIKI e as SHIK-u. Po.

7 PY. Domethënë, nuk ka ekzistuar ndonjë organ me emrin SHIKI?
8 Sepse gjendet dhe në tekst gjendet SHIKI, shihet si SHIKI, nuk
9 ka pas ndonjë organ me emërtimin SHIKI?

10 PË. Jo. Sa di unë jo.

11 PY. Pas fjalën SHIKI është UÇK. Shohim anglishten, nuk besoj,
12 nuk e di a lexoni anglisht, po thuhet: "Agjencia Informative e
13 Kosovës".

14 A mund të na e konfirmoni që në shqip nuk ekziston kjo që
15 gjendet në anglisht. Në anglisht është "Shërbimi Informativ i
16 Kosovës", në anglisht. Por tek shqipja a e shikojmë ne një
17 fjalë të tillë, e shikoni gjëkund?

18 PË. Jo.

19 PY. A mund të konfirmojmë nëse ky dokument flet inaugurimin e
20 një objekti të SHIK-ut në zonën e Dukagjinit. A është e
21 vërtetë që s'ka pas asnjëherë ndonjë ndërtesë të SHIKI-t apo
22 të SHIK-ut në zonën e Dukagjinit? S'ka ekzistuar ndonjëherë
23 një ndërtesë apostafat për SHIK-un?

24 PË. Nuk kam pa që ka pas ndërtesë të tillë në këtë fshat. Dhe
25 unë më 28 të këtij muaji kur është ky farë dokumenti veç kam

1 qenë i plagosun keq, po në spital kam qenë në Isniq.

2 PY. Pra, ju nuk e keni parë ndonjëherë këtë ndërtesë në këtë
3 fshat? Po a keni parë ndonjë ndërtesë të SHIKI-t ose SHIK-ut
4 në ndonjë vend tjetër në zonën e Dukagjinit?

5 PË. Jo, z. Avokat.

6 PY. Mirë.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.
8 Dhe të lutem të vendosni në ekran dokumentin U001-3408 deri në
9 U001-3409. Këto janë shënime të cilat ua tregoi dhe Gjykatësi
10 Barthe.

11 PY. Ju thatë që këtë dokument nuk e keni parë ndonjëherë dhe
12 nuk dini asgjë lidhur me përmbajtjen e këtij dokumenti. A
13 është e vërtetë që ju nuk e dini kush e ka shkruar këtë
14 dokument, kush është autori?

15 PË. Është e vërtetë.

16 PY. Ka disa shënime në dy faqe të këtij dokumenti. Dokument
17 për të cilin nuk dimë asgjë. Unë desha t'ju pyes a keni parë
18 ndonjëherë dokumente të ngjashme në kohën që keni qenë në
19 Dukagjin? Ju thatë që keni marrë shumë raporte dhe i keni
20 shpërndarë, po ndonjë gjë të këtij lloji, ndonjë dokument të
21 ngjashëm, raport të ngjashëm a keni parë ndonjëherë në kohën
22 që keni qenë atje?

23 PË. Jo, z. Avokat. Këtu është disa gjëra krejt tjera këtu që
24 s'kanë të bëjnë me punën time në Dukagjin, as në Kosovë.

25 PY. Po e kuptoj unë këtë. Keni dhënë dëshmi për përmbajtjen.

1 Po a keni parë ndonjë dokument të këtij formati më saktë,
2 ndonjë shabllon të tillë që t'ua ketë dhënë ndonjë persona,
3 diçka të ngjashme me këtë dokument?

4 PË. Jo. Jo, z. Avokat.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin dhe të
6 nxjerrim një dokument tjetër U001-4082 deri në U001-4083.

7 PY. Edhe një herë, këto janë disa shënime, ka data,
8 informacione që jua treguan ju. Këtu dokument nuk e keni parë
9 më përpara. Po a është e vërtetë që dhe në këtë rast ju nuk e
10 keni idenë kush e ka përgatitor këtë dokument?

11 PË. Jo, z. Avokat. Nuk e kam idenë kush ka përgatit raportime
12 të tilla, dokumente të tilla.

13 PY. Ju nuk keni parë ndonjë dokument të ngjashëm me këtë
14 gjatë kohës që keni punuar në Dukagjin, apo jo, gjatë kohës që
15 keni qëndruar atje kur vetë keni hartuar raporte dhe keni
16 mbledhur informacione nuk keni parë ndonjë raport të ngjashëm
17 me këtë, apo jo?

18 PË. Jo, z. Avokat.

19 PY. Faleminderit.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Mund t'i heqim nga ekrani.

21 PY. Kam disa pyetje të tjera, z. Maloku. Gjykatësi Barthe ju
22 pyeti për z. Faton Mehmetaj dhe ju u përgjigjët e thatë se
23 keni mësuar për faktin që ka qenë në sektorin informativ në
24 janar të 1999 kur u kthyet në Zonën Operative të Dukagjinit.

25 Kur thoni e keni mësuar këtë në janar, ju e keni mësuar

1 këtë nga persona të tjerë? Nuk e keni mësuar nga z. Mehmetaj,
2 pra, ua kanë thënë persona të tjerë?

3 PË. Është shumë interesante. Kurrë s'kam fol me z. Mehmetaj.
4 Por shihja e disa, e dija që është z. Mehmetaj dhe thonin që
5 është përgjegjësi për zbulim-kundërzbulim. Tash këtu po del do
6 SHIKI, janë dokumente të cilat nuk po muj shpjegoj as vetë. A
7 më kupton? Nuk po i kuptoj as vetë.

8 PY. Po. Ju treguan disa dokumente të vitit 1998. A është e
9 vërtetë që ju keni dëgjuar se në 1998-n ai ka qenë në sektorin
10 e zbulimit në atë kohë? Ne kemi parë disa nga dokumentet që ua
11 treguan, nuk po them që ju keni njohuri të drejtpërdrejta, por
12 a është e vërtetë që e keni dëgjuar që ai ka qenë në këtë
13 sektor në 1998-n?

14 PË. Jo.

15 PY. Pra, ju po thoni se ju keni dëgjuar që ka qenë në
16 shërbimin informativ në janar të 1999, por ju personalisht nuk
17 mund ta verifikonit këtë? Ju nuk e keni konfirmuar ndonjëherë
18 këtë informacion?

19 PË. Jo.

20 PY. Kam dhe një aspekt tjetër lidhur me pyetjet që ju bëri
21 Gjykatësi Barthe për komandant Lulin. Në dëshminë tuaj ju
22 thatë se zbuluat pas luftës se komandant Luli ishte një
23 komandant Luli që keni takuar një herë në Shtabin e
24 Përgjithshëm dhe ky personi ishte Kadri Veseli dhe ju thatë
25 kjo ka ndodhur në dhjetor të 1998, jeni takuar vetëm një herë

1 me të.

2 PË. Vetëm --

3 PY. Më lejoni ta mbaroj, përfundoj, ta përfundoj, të lutem.

4 Dua të shohim dëshminë që keni thënë në Shënimin Përgatitor
5 numër 1, paragrafi 15. Do t'ju lexoj diçka dhe do t'ju bëj një
6 pyetje sqaruese lidhur me këtë takim dhe periudhën kohore.

7 Ju thatë se nuk e kishit parë këtë person në Shqipëri më
8 parë, por në zyrën e Bislim Zyrapit, kur kaloi dikush aty,
9 kaloi dikush aty dhe z. Zyrapit të tha që ky është komandant
10 Luli, dhe pas luftës ke mësuar që ky person ishte Kadri
11 Veseli. Ju thatë që nuk keni biseduar me të në këtë rast,
12 s'keni folur.

13 Më pas - në paragrafin 15 - ju shtuat se asnjëherë s'keni
14 komunikuar me z. Veseli pasi e patë në këtë rast dhe "Nuk keni
15 biseduar asnjëherë dhe as nuk keni qenë ndonjëherë në të
16 njëjtën dhomë".

17 Kjo është dëshmia juaj, a ju kujtohet, domethënë, e keni
18 parë shkarazi atë?

19 PË. E kam parë nga brenda jashtë. Po. Dhe nuk janë në
20 kujtesën time, nuk e gjej që ndonjëherë në luftë kam qenë në
21 një dhomë me të ose që kam komunikuar me të.

22 PY. Pra, gjatë gjithë kohës kur ju keni qenë në Dukagjin para
23 se të shkonit në Shtabin e Përgjithshëm dhe edhe kur ishit në
24 Shtabin e Përgjithshëm edhe më pas kur jeni kthyer në
25 Dukagjin, nuk keni pasur asnjë takim apo bisedë me atë, z.

1 Veseli, apo jo?

2 PË. E saktë.

3 PY. Dhe sa i takon këtij takimi shkarazi ju keni thënë në
4 paragrafin 15 të Shënimit Përgatitor 1, e thatë që ju e keni
5 parë z. Veseli pas datës 28 nëntor kur jeni kthyer në Shtabin
6 e Përgjithshëm nga terreni dhe thoni kështu:

7 "Mund të ketë qenë në dhjetor të 1998-s ose në janar të
8 1999-s."

9 Kështu keni thënë, apo jo? Kjo është ajo që po thoni që
10 mund të ketë qenë në çfarëdo lloj momenti në këtë periudhë?

11 PË. Po.

12 PY. Por puna është që nuk jeni i sigurtë se kur ka qenë me
13 saktësi ky takim shkarazi i vetëm?

14 PË. Jo. Ju thashë kam probleme me data, jo, po e di që një
15 herë e kam pa.

16 PY. Faleminderit, z. Maloku. Këto ishin pyetjet e mia.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
18 z. Dixon.

19 Z. Roberts?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

22 Alagendra

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
25 besoj do të kënaqeni po të merrni vesh tani që mbaroi dëshmia

1 juaj këtu. Ishin tri ditë të gjata, ju falënderojmë për
2 praninë tuaj këtu. Tani mund të dilni nga salla, do t'ju
3 shoqërojë Asistentja e sallës, ju falënderojmë dhe ju urojmë
4 një mbrëmje të mirë.

5 [Dëshmitari largohet]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të jetë
7 dëshmitari gati në orën 9.00 nesër, z. Pace?

8 Z. PACE: [Përkthim] Mesa di, po. Por nëse do të mësojmë
9 diçka, mbas seancës sot do të dërgoj një email.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një moment.
11 Po. Po kishim ato rregullimet, sistemimet.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Gjykatësi Barthe përmendi një
13 provë materiale që është me numër 1D00188. E verifikova dhe
14 ishte shënuar faktikisht për identifikim për një problem në
15 përkthim. Është zgjidhur kjo tashmë. Kështu që është edhe në
16 kërkesën për pranimin e provave jo gojore për Dukagjinin nga
17 ZPS-ja.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se kjo
19 është e saktë.

20 Z. PACE: [Përkthim] Po. Nëse është e saktë, pajtohem që
21 të pranohet.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
23 pranohet versioni i përditësuar duke hequr numrin për
24 identifikim.

25 Avokati Roberts ka diçka për të thënë.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ka një kërkesë, z. Selimi do të
2 ndjekë nga objekti i paraburgimit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mjafton që të
4 jetë vendosur njoftimi për heqje dorë nga prania këtu.

5 Faleminderit atëherë. Ju falënderojmë për qëndrimin gjatë
6 edhe ju urojmë mbrëmje të këndshme. Shihemi nesër në orën
7 9.00.

8 Këtu bëhet ndërprerja e seancës.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.35

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25